

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28.1 të Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

### Ju fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **30 mars 2023 (e enjte) me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtrri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:


### **R E N D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 23 shkurt 2023;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2022;
3. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2022/2023;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë;
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për korrigjimin e vendimit të kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me nr. 01.49/20 i datës 27.2.2020;
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2022 në vitin 2023;
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit i vlerësimit të dëmeve nga shiu, era dhe zjarri;
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit të komisionit për përzgjedhjen e Këshillave Lokale;
9. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale për vitin 2022;
10. Shqyrtimi i propozimit për ofrimin e ndihmës financiare për Komunën e Mitrovicës dhe Skënderajt si rezultat i dëmeve nga vërshimet, si dhe ofrimin e ndihmës financiare për Shtetin e Turqisë dhe Sirisë si pasojë e tërmetit;
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për caktim të kahjeve të lëvizjes në disa rrugë të qytetit;
12. Të ndryshme.

**Melihate Basholli-Latifi**



**Kryesuese e Kuvendit të Komunës**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUČITRN

<b>PËR:</b>	Kuvendin e komunës
<b>NGA:</b>	Melihate Basholli Latifi Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
<b>TEMA:</b>	Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 15.3.2023

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **15 mars 2023** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

- Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2022;  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
- Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2022/2023;  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
- Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë;  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të bëhet përmirësimi i preambulës së këtij propozim-vendimi, ashtu që baza juridike të jetë në Statutin e ri të Komunës së Vushtrrisë.*
- Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për korrigjimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me nr. 01.49/20 i datës 27.2.2020;  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
- Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2022 në vitin 2023;  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që në kuadër të buxhetit të komunës në kodin ekonomik të kuvendit, të parashihen mjetet financiare për blerjen e lap-topëve për anëtarët e kuvendit, po ashtu të përfshihen mjetet*

*financiare për instalimin e pajisjeve për votim elektronik dhe të bëhet rikonstruktimi i sallës së kuvendit.*

**6.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit i vlerësimit të dëmeve nga shiu, era dhe zjarri;

*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*

*Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

**7.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit të komisionit për përzgjedhjen e Këshillave Lokale;

*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*

*Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

**8.** Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale për vitin 2022;

*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*

*Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

**9.** Shqyrtimi i propozimit për ofrimin e ndihmës financiare për Komunën e Mitrovicës dhe Skënderajt si rezultat i dëmeve nga vërshimet, si dhe ofrimin e ndihmës financiare për Shtetin e Turqisë dhe Sirisë si pasojë e tërmetit;

*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*

*Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

***Me respekt!***



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E -II- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË**  
**VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 23 shkurt 2023**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën 10:15. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:*

Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fakte Dushi, Fatmire Cecelia, Faton Hyseni, Galip Audiu, Gresa Muli, Gentiana Rama, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Nurie Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Refik Maloku, Shkelzen Xhaferi, Spasoje Stefanoviq, Sylejman Meholli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 35 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe e autorizuar e Kryetarit të komunës, znj.Hava Rruka-Mlinaku, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

**Hava Rruka- Mlinaku, drejtoreshë e DA-së-njoftoj** se kryetari dhe nënkryetari i komunës gjenden në vizitë jashtë vendit, andaj ajo është e autorizuar të ushtroj kompetencat e kryetari gjatë qëndrimit të tyre jashtë vendit.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - e nderuar ushtruese e detyrës se kryetarit zonja Hava Mlinaku, të nderuar koleg deputet, qeveri komunale ju të pranishëm. Një Përshëndetje të veçantë i drejtoj drejtorit të ri të Drejtorisë së Arsimit z.Abazi dhe me këtë rast dua te uroi në këtë detyrë. Zotin Abazi e njoh kaherë, unë dhe shumica e qytetarëve të Vushtrrisë, e njohim si qytetar modest, fqinjë i mirë, familje patriotike dhe mbi të gjitha e njoh dhe çmoj si personalitet i shquar dhe intelektual i vërtet. Drejtor ne si deputet pothuajse të gjithë po edhe qytetarët dhe stafi arsimor kemi pasur shumë brenga lidhur me organizimin e drejtorisë e cila mbeti bosh pa drejtor mbi se 2 muaj dhe emërimi Juaj në këtë pozitë na ka gëzuar shumë, bile kam menduar se ndoshta u kanë e rrugës sot në këtë seancë me ju prit me buqeta lulesh por prapë kam thanë jo tash sepse jemi të përkushtuar të ju përkrahmi në këtë mision që keni marr mbi supe unë dhe besoj të gjithë deputetet dhe lulet dhasht zoti të mos kemi zhgënjime dhe ti dhurojmë në fund të mandatit. Unë ndaj bindjen se nëse punon drejtë dhe në respektim të ligjit, nëse bashkëpunon me zyrtarët e mrekullueshëm që janë aset i çmuar i drejtorisë që drejtoni dhe nuk i nënshtroresh diktatit e asnjë veprimi jo profesional

e jo human do të dilni faqebardhë, në të kundërtën kështu si po ju ndaj lëvdata do keni reagimin tim pa hezituat fare.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** –tha se lajmi për emërimin e z.Dardan Abazi në udhëheqjen e Drejtorisë së Arsimit atë dhe LVV-në në Vushtrri e ka befasuar tej mase sepse në bazë të informatave që posedojnë ky person nuk ka përvojë në fushën e arsimit. Andaj në këtë rast ai kërkoj informata nga drejtori i arsimit në pyetjet me sa vijon: cila është përvoja e tij në fushën e arsimit?, gjatë muajit të parë të punës a ka bërë ndonjë analizë se cila është gjendja e arsimit në Komunën e Vushtrrisë?, a keni mbajtur takime të përbashkëta me drejtorët e shkollave fillore, të mese dhe të mesme të larta për të dëgjuar nga afër se cilat janë brengat vështirësitë dhe problemet me të cilat ata ballafaqohen çdo ditë?, a jeni takuar me përfaqësuesit e SBASHK-ut të Komunës së Vushtrrisë për të dëgjuar kërkesat e mësimdhënësve dhe punëtorëve tjerë të arsimit dhe cila do të jetë përgjigja e juaj rreth zbatimit të kontratës kolektive ku përfshihen e drejta e shujtës, pagës jubilarë, shpenzimet e udhëtimit e çështje të ngjashme?. Dhe në fund cilët hapa do ti merrni si drejtori për përmirësimin e gjendjes në arsim në komunën tonë gjatë periudhës së ardhshme tri vjeçare të mandati tuaj.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit** –tha se e di që gjendje e arsimit në Vushtrri nuk është ajo e duhura, dhe kjo është rënduar edhe me shumë me skandalet që kanë ndodhur sidomos në tri raste me konkurse ajo në lëndën e kimisë, konkursi me rekrutim në çerdhen e qytetit të cilat janë dërguar në prokurorinë e shtetit. Kjo ka ndodhur me dijeninë e kryetarit të komunës, i cili gjatë fushatës e ka pasur gojën plotë arsim, dhe i cili e bie gjendjen e arsimit në Komunën e Vushtrrisë në nivel të një OJQ-je, faktikisht emëron drejtor të arsimit një personi i cili të vetmen punë në jetën e tij ka bërë punën në një Organizatë Joqeveritare. Kjo gjendje është për keqardhje edhe për PDK-në në Vushtrri sepse kjo parti ka kudër ku punëtorët në DKA janë nga PDK, drejtorët e shkollave janë me shumicë nga PDK dhe ka edhe kuadër tjetër dhe ta biesh një drejtor nga OJQ-të, është për të ardhur keq.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit** - fillimisht drejtorit të ri të arsimit u uroj punë të mbarë, dhe shtoi se nëse ishte marr me mendimi i tij personal ky njeri nuk do ishte emëruar drejtor i arsimit. Kjo për faktin se është rregull që për emërim në krye të një shkolle si drejtor duhet të kesh minimum tri vitet përvojë pune në arsim dhe kështu të emërosh në krye të DKA-së një person që nuk ka asnjë ditë përvojë pune në arsim nuk është në rregull. Një gjë të tillë një emërim të tillë kryetarit ia mundëson ligji sepse është post politik, por ai foli për çështje profesionale. Duke ju referuar parafolësit të tij për rekrutim në lëndën e kimisë vlerësoi se për zëvendësimin e një mësimdhënësi nevojiten të paktën 60 ditë, kjo si rezultat i udhëzimeve administrative që janë nxjerr nga MASH në mënyrë të mbrapsht, dhe këtë të fundit e udhëheqë LVV-ja në nivel qendror dhe për këtë pse nuk e ngritin fjalën. Mandej shtoi se përse nuk po ngritët zëri për lëndët deficitare si kimi, fizik, matematikë dhe informatikë ku kemi shumë mungesa. Në fund ai kërkoj që komuna të ketë një strategji për simulimin e lëndëve dhe drejttimeve deficitare, sepse në të kundërtën rrezikojmë të mbetemi pa kudër në drejtimet natyrore.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** –në fillim i uroj sukses Drejtorit të ri të DKA-së, dhe shtoi se në konkursin në lëndën e kimisë ka pasur shkelje ligjore dhe se kjo është e provuar. Fatkeqësisht shkeljet po vazhdojnë dhe ato janë bërë publike edhe në mediat publike.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit** –sqaroi se konkursi është shpallur me kohë, po ka pasur gabime sa i përket procedurës së përzgjedhjes të kandidatëve dhe për këtë është anuluar konkursi andaj kështu ka pasur edhe vonesa në rekrutim me muaj të tërë.

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit**–kërkoj të futet në rend të ditës pika pyetje dhe përgjigje ashtu si parashihet me rregulloren e punës të kuvendit.

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit-** e përgëzoj kryetarin e komunës, për emërimin e drejtorit të DKA-së, për të cilin ndan mendimin se është një person i përgatitur dhe punëtor, andaj nuk duhet paragjykuar sepse ai nuk i takon subjektit politikë që po qeverisë komunën. Pastaj shtoi se kritikën duhet të adresohen në formë të duhur dhe atje ku duhet tek dikasteret që kanë dështuar në kryerjen e funksioneve të tyre. Më tej ceku se ish drejtori i arsimit në mandatin e kaluar kishte dështuar në detyrën e tij, madje kur i ishte kërkuar që në shkollë të ketë sapun dhe gjëra higjienike për nxënësit ai ishte tallur me këtë kërkesë.

**Zojë Hajrizi, anëtare e kuvendit-** në adresimin e saj para kuvendit parashtrij disa kërkesa për infrastrukturë publike deklaroi me sa vijon: I nderuar drejtor z. Shala 1) Banoret e fshatit Strofc, Beçuk, Zhilivodë, Bivolak, Gillovin, banoret e lagjes së Nemozheve në fshatin Mihaliq, po ashtu edhe një pjesë e fshatit Druar që është afër Qyqavices, pyesin se kur do ta sillni pompën me të cilën do të furnizoni me ujë të pijes këto fshatra? 2) Në fshatin Strofc në rrugën Zymer Hajrizi, kompania e cila e ka bërë shtrirjen e kanalizimit nuk e ka përfunduar punën e tyre, gypat i kanë vendosur mirëpo gjatë vendosjes së gypave kanë lenë pengesa në rrugë, banoret po ankohen se veturat po dëmtohen kur kalojnë në atë pjesë, mbase është një rrugë e cila i lidhë dy fshatrat. Kërkoj nga drejtoria që të shkoni dhe të shikoni nga afër se si është gjendja e kësaj rruge, dhe të ndërmerri masa. Ndërsa: 3) Në fshatin Gillovin, në rrugën “Driton Islam Hasani”, është bërë bllokimi i një kanalizimi banoret ankohen nga kundërmimi i ujerave të zeza që kanë dale mbi sipërfaqe, banoret thonë se kemi bërë kërkesa edhe më herët por ende nuk është bërë zgjidhja e këtij problemi, \* kur do të filloni me zgjidhjen e këtij problemi drejtor? 4) Po ashtu kemi edhe një kërkesë, nga banoret e lagjes së Nemozheve në fshatin Mihaliq, banoret kërkojnë nga ju ta din se kur do të filloj shtrirja e kanalizimit në këtë lagje?

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-**ngriti çështjen adresuar Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për vend-parkingjet për personat me aftësi të kufizuar, andaj kërkoi që kjo kërkesë të realizohet për këtë kategori, ashtu që të kenë mundësi më të mirë në qasjen në shërbime komunale dhe publike. Po ashtu kërkoj nga DSHP-ja të ndërmarr veprim për sa i përket shkarkimit të mallrave në dy marketet afër komunës Viva dhe Interex të cilat gjatë asaj periudhe po shkaktojnë pengesa dhe tollovi në qarkullim. Kjo do të mund të zgjidhje duke u shkarkuar malli në një interval kohor kur ka pak qarkullim sidomos në orët e hershme të mëngjesit. Pastaj lidhur me çështjen e krenimit të festës së Pavarësisë, paraqiti vërejtjet e saj sepse për anëtarët e kuvendit nuk ishin rezervuar vendet dhe kjo ishte një ofendim për ta. Komuna për këtë çështje paguna një person për ta mbajtur protokollin.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit-**ngriti dhe përsëriti problemin e kamotshëm për eksploatimin e një guri gëlqeror në fshatin Pasomë-lagja Dautja, ku në anë sipërfaqe më vonë është hedhur një mbeturina helmuese andaj si rezultat i kësaj është duke u kontaminuar edhe uji i pijes dhe askush nuk guxon të furnizohet me ata ujë. Kërkoj nga Drejtoria e Inspektiveve që të ndërmarrin veprimet e duhur për rregullimin e kësaj problematike. Kjo çështje ka mbetur e parregulluar me vitet të tëra dhe asnjë qeveri nuk ka punuar diçka në këtë drejtim. Në fund tha se në atë pjesë mungon infrastruktura rrugore dhe ajo kanalizimit dhe ujësjellësit.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-**pyeti drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike se a janë të vërteta pretendimet e një zyrtari të kësaj drejtorie i cili publikisht nëpërmes rrjeteve sociale ka akuzuar se në qeverisjen e kaluar në DSHP është keqpërdorur një gyp me gjatësi 1600 metra fi 700 në vlerë mbi 1 milion euro, personi në fjalë ngriti shqetësimin se a është vendosur apo jo ky gyp në rrugën magjistrale që është në kompetencën e ministrisë. Lidhur me këtë kërkoj nga DSHP-ja informatë të hollësishme dhe nëse kjo është e vërtet atëherë çfarë masa janë ndërmarr.

**Dardan Abazi, drejtor i DKA-së-falënderoj** të gjithë anëtarët e kuvendit për lëvdatat dhe kritikën e bërë dhe ceku se shpreson se nuk do të zhgënjë në punën e tij. Ai paraqiti sqarime në temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

**Benjamin Shala, drejtor i DSHP-së-paraqiti** sqarime duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

**Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-propozoi** që të futet në rend dite propozim-vendimi për formimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores të punës së kuvendit.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** –kërkoj që pika 13 e rendit të ditës Propozim – vendimi për caktim të kahjeve të lëvizjes në disa rrugë të qytetit të hiqet nga rendi i ditës duke u shtyrë për një seancë tjetër, këtë e bazon me faktin se ka pasur ankesa nga qytetarët, në këtë kontekst duhet të ketë një debat me qytetarë për të gjetur një zgjidhje të arsyeshme.

**Nurie Halili, anëtare e kuvendit-propozoi** të futet në rend dite një pikë e veçantë propozim-vendim për lirimin nga pagesa e taksës komunale për ndërrimin e destinimit të pronës nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore si dhe lirimin nga pagesa e të gjitha taksave për pajisje me leje ndërtimore për të gjithë fermerët dhe bizneset përfituese të granteve qeveritare. Tutje propozimin e arsyetoj me faktin se ka një numër të fermerëve dhe bizneseve individuale që kanë përfituar grante dhe të njëjtit kanë hasur në problem financiarë në realizimin e projektit, por këtë vendim e kanë marrë edhe disa komuna tjera të Republikës së Kosovës.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** –lidhur me pikën e 13 të rendit të ditës vlerësoi se ka pasur ankesa nga qytetarët lidhur me kahjet e lëvizjes së mjeteve motorike në komunikacion, dhe për këtë çështje duhet të bëhen analizat e nevojshme duke organizuar edhe ndonjë debat publik me qytetarë para se të merret vendimi nga kuvendi.

**Benjamin Shala, drejtor i DSHP-së-tha** se lidhur me çështje e Propozim – vendimi për caktim të kahjeve të lëvizjes në disa rrugë të qytetit, është mbajtur një diskutim publik me akteret që i afekton kjo çështje, ku kanë qenë prezent edhe bizneset e qytet që shtrihen përgjatë këtyre rrugëve që mendohet të bëhen ndryshime. Andaj kërkoj që kjo temë të futet në rend dite për shqyrtim dhe të analizohet e në fund të merret një vendim.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** –pas sqarimeve të bëra nga drejtori i DSHP-së, grupi kuvendar i LDK-së është i pajtimit që Propozim – vendimi për caktim të kahjeve të lëvizjes në disa rrugë të qytetit, të shqyrtohet në rend të ditës dhe më tej të bëhen ndryshimet e nevojshme.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** –deklaroi se grupi kuvendar i LVV-së mbetet prapa propozimit që pika e 13 e rendit të ditës të shtyhet.

Në vazhdim kuvendi pas votimit me 21 vota “për” 1 votë “kundër” 1 votë “abstenim” vendosi që Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq, të inkorporohet në rendin e ditës për shqyrtim.

Kuvendi pas votimit me 21 vota “për” 1 votë “abstenim” vendosi që pika pyetje dhe përgjigje nga anëtarët e kuvendit të bëhet pjesë e rendit të ditës.

**Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore-tha** se kuvendi i komunës nuk ka të drejtë të heqë taksat të cilat janë të parapara me ligj, tarifën për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore është e rregulluar me udhëzimin administrativ të Ministrisë së Bujqësisë dhe Kësisoj komuna nuk e ka atë mandat të heq këto taksa, njëkohësisht edhe për ndërtim të objekteve komuna mund të zbris taksat por jo të heq ato

Kuvendi pas votimit me 21 vota “për” 13 vota “kundër” nuk e aprovoj për shqyrtim në rendin e ditës propozim-vendim për lirim nga pagesa e taksës komunale për ndërrimin e destinimit të pronës nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore si dhe lirim nga pagesa e të gjitha taksave për pajisje me leje ndërtimore për të gjithë fermerët dhe bizneset përfituese të granteve qeveritare.

Pas votimit kuvendi me vota “unanime” vendosi për shqyrtim në rendin e ditës Propozim-vendimin për formimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores të punës së kuvendit.

**Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi këtë:**

## **R E N D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 31 janar 2023;
2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Rregullores për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ dhe Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Rregullores për Ndarjen e Bursave për Nxënës/Studentë dhe Shpërblimeve për Nxënës/Studentë të Komunës së Vushtrrisë;
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Rregullores për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Veprimtarive Afariste – Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë;
6. Shqyrtimi i Raportit periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit
7. Shqyrtimi i Informatës për shërbimet shëndetësore për vitin 2022 në Komunën e Vushtrrisë;
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2022;
9. Shqyrtimi i Informatës për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022;
10. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për emërim të komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në Komunën e Vushtrrisë;
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për lirim nga pagesa e taksës për shfrytëzimin e hapësirave publike si dhe kiosqeve nga druri për më pak se një vit;
12. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit lidhur me themelimin e Këshillit për Siguri në Bashkësi;
13. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq;
14. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për ndryshim-plotësimin e rregullores për punën e kuvendit dhe organeve të tij;
15. Pyetje dhe përgjigje nga anëtarët e kuvendit;
16. Të ndryshme.

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 31 janar 2023;**

**Fortuna Krasniqi, drejtoreshë e DUMM-së-kërkoj që në procesverbal të pasqyrohet i gjithë diskutimi i saj.**

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota “unanime”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 31 janar 2023, me vërejtjen e paraqitur më lartë.**



## 2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022;

**Reshat Kovaçi, Komandat i Stacionit Policor në Vushtrri**-paraqiti sqarime lidhur me informatën në fjalë duke prezantuar statistika për veprat penale dhe gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit** –tha se komuna jonë ka gjithsej 12.796 nxënës të sistemuar në 38 institucione para universitare, andaj në kuadër të angazhimeve rreth shkollave policia ka zbatuar një plan kontrolli në shkolla në muajin maj, që ka pasur për qëllim eliminimin e gjitha formave të dukurive negative tek nxënësit sidomos përdorimit të narkotikëve dhe armëve. Pyeta e tij është a kishe me qenë më mirë që plani i kontrollit të shtrihet gjatë gjithë vitit, shembull çdo muaj të kontrollohen nga 3 apo 4 shkolla kjo do të kishte ndikim pozitiv në sigurinë e nxënësve.

**Reshat Kovaçi, Komandat i Stacionit Policor në Vushtrri**-sqaroi se kontrolli nëpër shkolla bëhet me kërkesën e DKA-së dhe pas marrjes së një urdhërese prej gjykatës, përsëritja e shpeshtë e këtyre kontrolleve për pos që është e panevojshme mund të jetë edhe kundër drejtave të njeriut (fëmijëve).

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** –duke ju referuar informatës në fjalë ku ceket se gjendje e sigurisë në komunën tonë ka qenë e qetë dhe stabile më tej thuhet se kemi pasur rritje të rasteve të veprave penale nga 1126 raste në vitin 2021 në 1168 raste në vitin 2023. Më pas thuhet se te veprat penale ka pasur një rritje nga 754 në 853 vepra penale në përqindje prej 8%. Në këtë rast kërkoj të sqarohet se cila informatë është e saktë. Mandej tek rastet e veprave penale dhunë në familje kemi rritje duke krahasuar me vitin e kaluar ku kemi pasur 59 Raste në 2021 e në vitin 2022 kemi 108 raste apo thënë në përqindje një rritje prej 83.1% dhe kjo është shqetësuese. Po ashtu Kanosjet janë veprat që kanë shënuar rritje konsiderueshme në këtë vit kanë ndodhur 90 nga 56 që kanë ndodhur në vitin e kaluar. Në informatë është cekur se siguria në shkolla ka qenë në nivel të mirë të sigurisë edhe në vitin 2022 , kemi punuar në bazë të planit Operativ Siguria në shkolla ku zyrtarët e angazhuar rreth shkollave kanë bërë një punë të mirë në ofrimin e një ambienti sa me të sigurt për nxënësit dhe personelin e shkollave. Puna e zyrtarëve të angazhuar ka pasur në fokus parandalimin e incidenteve në shkolla dhe rreth tyre. Në kuadër të angazhimeve rreth shkollave kemi zbatuar edhe një plan kontrolli në shkolla në muajin maj që ka pasur për qëllim eliminimin e çdo dukurie negative tek nxënësit sidomos , përdorimit të narkotikëve dhe bartjeve të armëve .Gjatë vitit kemi zhvilluar ligjëratat vetëdijesimi në shumë shkolla për ndërgjegjësimin e tyre rreth dukurive negative në shoqëri . Besoj se bashkëpunimi i mirë me drejtorët dhe mësuesit do vazhdojë dhe gjendja e sigurisë do jetë gjithnjë më e mirë. Në informatë nuk janë paraqitur rastet e dhunës nëpër shkolla dhe cilët do të jenë mekanizmat që do ta luftojnë përdorimin e narkotikëve nga nxënësit. Një tjetër brengë tek prindërit e fëmijëve është se në disa lokale nga nxënësit luhen lojëra të rrezikshme kompjuterike fëmijë të moshës 10-15 vjet, ku në këto lojëra vriten personalitete të ndryshme, dhe kjo po ndikon që fëmijët të bëhen arrogant, agresiv dhe të pa interesuar për mësim dhe krijojnë sjellje të pahijshme ndaj prindërve dhe bashkëmoshatarëve të tyre. Në fund tha se është mirë të kemi një mekanizëm koordinues me policës, shkollës, dhe prindërve për luftimin e kësaj dukurie.

**3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Rregullores për Përcaktimin e Kriterëve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ dhe Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim;**

**Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit**-propozoi që në kuadër të kësaj rregullore të futet një nenë i posaçëm që i lihen kompetencat kuvendit që të ndaj mjetet mbi 2000 €, kjo do të mund të inkorporohej tek neni 5 subvencionimi pa thirrje publike.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit**-tha se e përgëzon hartimin e kësaj rregulloreje e sidomos është për vlerësim që është marr për bazë propozimi i tij për rritjen e vlerës së qirasë për përfituesi e kësaj ndihme. Tek neni 19 propozoi përbërja e komisionit për ndarjen e subvencioneve kërkoj që të jetë edhe një zyrtar nga Drejtoria e Shëndetësisë, pasi që kjo ne fundit si organizatë buxhetore posedon një vlerë të konsiderueshme të subvencioneve. Ky anëtar mund të merret nga pika 2.3 d.th. m të hiqet nga Drejtoria e Financave ku janë paraparë 2 anëtar nga kjo e fundit.

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit**-propozoi që tek neni 6 të shtohet një paragraf i ri me tekstin si në vijim: certifikatën që dëshmon përmbushjen e obligimeve financiare ndaj ATK-së, kur bëhet fjalë për përfitim të subvencionit nga personi juridik. Tek neni 7 të shtohet nënparagrafi 3.7. shmangia e subvencionimit të aktiviteteve të subjekteve politike.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** –tha se në gjitha këto propozim-rregullore shihet vetëm nënshkrimi i kryetarit të komunës, andaj pyeti se komisionet që janë formuar a e kanë kryer punën e tyre.

**Nexhmedin Rashica, Drejtor i DSHPS-së**-tha se e mbështet propozimin një anëtarët e komisionit për ndarjen e subvencioneve të jetët nga Drejtori e Shëndetësisë.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** –tha se rastet e ndarjes së mjeteve nga kuvendi në vlerë mbi 2000 € janë bërë pa thirrje publike edhe në të kaluarën duke u shmangur rregullorja, andaj kërkoj që kjo dispozitë të futet në rregullore që kuvendi ta ketë këtë të drejtë për kërkesat që arsyetohen para kuvendit.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** –tha se asnjëherë nuk ka ndodhur që në kuvend të trajtohen çështjet me kaq pasiguri, dhe shtoj se propozuesit e akteve fillimisht para procedimit të materialit duhet të sigurohen se kanë plotësuar konditat ligjore. Drejtoret e drejtorive duhet të arsyetojnë para kuvendit se pse një pikë duhet të aprovohet apo jo dhe jo të shkohet në diskutime të pa fundme dhe të cilat nuk kanë ndonjë produktivitet. Më tej shtoj se zyra ligjore nuk ka kompetencë të jap opinione para kuvendit dhe drejtoret e drejtorive nuk mund t'i bazojnë pritjet e tyre vetëm tek zyra ligjore se a do të aprovohet një pikë e rendit të ditës apo jo.

**Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore**-tha se është e vërtet se në asnjë ligj nuk shkruan se zyra ligjore ka obligim të jetë e pranishme në seancat e kuvendit, ndërsa lidhur me çështjen e propozimit për lirimin nga taksa për lejet ndërtimore dhe ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore ceku se ajo çështje është e rregulluar dhe për të njëjtën kuvendi nuk ka të drejtë ti heq ato taksa.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me vota “unanime” Rregulloren për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ dhe Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim;**

**4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Rregullores për Ndarjen e Bursave për Nxënës/Studentë dhe Shpërblimeve për Nxënës/Studentë të Komunës së Vushtrrisë;**

**Galip Audiu, anëtar i kuvendit** –tha se të gjitha propozimet që i ka dhënë në mbledhjet e kaluara lidhur me këtë rregullore janë përshirë dhe kjo është shumë mirë. Pastaj shtoi se e përgëzon ekzekutivin komunal për këtë rregullore e cila do të jetë një mekanizëm i përshtatshëm për ngritjen

e numrit të bursave dhe do të ketë ipakt pozitiv në ngritjen e ofrimit të përkrahjes për nxënësit dhe studentes e komunës sonë.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit** –paraqiti vërejtjet e tij tek neni 4 i kësaj draft-rregulloreje ku thuhet se: Drejtoria përkatëse i propozon Kryetarit të komunës numrin e bursave për nxënës/studentë, shumën e parave për një bursë, profilet arsimore dhe fushat e studimit për të cilat ndahen bursat, sipas planifikimit buxhetor. Në këtë rast këta parametra nuk janë përcaktuar. Tek pika 5 kërkoj tek këtë një riformulohet më eksplicit të dispozitës. Tek neni 6 propozoi që të ketë ndarje të kritereve të përfituesve të bursës në dy kategori. Atyre meritore dhe studentët që kanë nevojë për ndihmë. Tek neni 8 nuk ceket kohëzgjatja e mandati të komisionit për ndarjen e bursave. Tek neni 10 Kryetari i komunës nxjerr vendim për emërimin e komisionit ad-hoc treanëtarësh me mandat njëvjeçar (për vitin shkollor/akademik) për shqyrtimin e ankesave.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit** –tha se me këtë rregullore duhet tu jepet përparësi përfituesve të bursave për drejtimet deficitare si: Matematikë, Fizik, Kimi Informatikë e të ngjashme.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** –tha se kriteret e përgjithshme në rregullore janë të parashtruar drejtë, ndërsa për drejtimet deficitare mund të parashihej një nenë i veçantë ku do të parashihej që 30% e bursave të dedikohet për drejtimet deficitare si: Matematikë, Fizik, Kimi Informatikë e të ngjashme.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** –tha se vërejt teknike dhe në riformulim të tekstit duhet të inkorporohen në këtë rregullore. Tutje shtoj se nëse tentohet të bëhet ndarja e kritereve në dy kategori atëherë kjo është gabim pasi që bursa merret për angazhim dhe rezultatet e treguara në studime e jo si çështje ndihme humanitare. Ndërsa lidhur me drejtimet deficitare propozoi të futet një nenë që përcakton se në kushtet e konkursit do të sigurohet përqindja e caktuara për këto drejtime që vlerësohet se janë deficitare

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit**-tha se është tepër me rëndës të kemi një rregullore të qartë dhe cila normon gati çdo çështje sepse kjo krijon objektivitet dhe drejtshmëri në ndarjen e bursave. Mandej ceku se kjo rregullore është punuar mirë ku ceku se kriteret janë përcaktuar në formë të saktë. Tek neni 7 propozoi të shtohet paragrafi 2.7. fëmijë pa njërin, apo të dy prindërit, që në kushte të barabarta do të jepej përparësi.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit**-vlerësoi se kishte me qenë mirë që me rregullore të përcaktohet që studentët përfitues të bursës universitare a kanë të drejtë të përfitojnë burës komunale, dhe për këtë mendon se një përjashtim i tillë nuk do të ishte i drejtë. Po ashtu vlerësoi se mirë kishte me qenë të futet edhe një nenë për ofrimin e burës për nxënës apo studentë me aftësi të jashtëzakonshme apo supertalente.

**Hava Rruka- Mlinaku, drejtoreshë e DA-së**-njoftoj se kjo rregullore është hartuar nga kryetari i komunës i cili është njohës i mirë i arsimit, ajo sqaroi se shumica e vlerës së bursës do të përcaktohet konfoma buxhetit. Ndërsa lidhur me drejtimet deficitare mendon se ato mund tu jepet prioritet me konkurs.

**Dardan Abazi, drejtor i DKA-së**-tha se porritet i Drejtorisë së Arsimit janë drejtimet deficitare dhe se synimi i tyre është që 100% e bursave të jetë e orientuar në këto drejtime, ai ceku se nuk do të ishte mirë të kufizohemi me përqindje por le të aprovohet rregullorja ashtu siç është. Më tej tek neni 6 i rregullores është vendosur kriteri kompetitiv pasi që vetë bursa ka karakter për të arriturat në studime.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 14 vota “për” 15 “kundër” nuk e aprovoi propozimin e proceduar me shkrim nga kryetari i komunës**

## **të Draft – Rregullores për Ndarjen e Bursave për Nxënës/Studentë dhe Shpërblimeve për Nxënës/Studentë të Komunës së Vushtrrisë.**

**Hava Rruka- Mlinaku, drejtoreshë e DA-së-në** emër të kryetarit të komunën kërkoj që kjo që draft-rregullorja për bursat të tërhiqet nga rendi i ditës.

**Imi Azemi, anëtar i kuvendit** –tha se nuk është qëllimi që të pengohet procesi i aprovimit të kësaj rregulloreje, por vetëm u dhanë disa propozime për kompletimin e këtij akti. Propozimin që e dha më herët për 30 % të bursave për drejtimet deficitare, por edhe nëse nuk ceket kjo përqindje nuk do të ketë ndonjë problem, pasi që ky obligim rezervohet për drejtorinë dhe komisionin.

**Dardan Abazi, drejtor i DKA-së-në** rekapitullimin e debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës shtoj se çështja e studentëve me aftësi të lartë mund të subvencionohet me vendime të veçanta por jo të futet në këtë rregullore. Mandej tek neni 4 të shtohet pika 5 Drejtoria e Arsimit ju jep përparësi drejtimeve deficitare, në profilet arsimore që përfitojnë bursë. Pastaj pika 6 më radhë riformulohet sipas një versioni të drejt sintaksor. Tek neni 7 shtohet pika 2.7 fëmijë pa njërin, apo të dy prindërit. Tek neni 8 duhet të shtohet mandati i komisionit dhe atë në tekstin si në vijim: Kryetari i komunës nxjerr vendim për emërimin e komisionit treanëtarësh (3) me mandat njëvjeçar (për vitin shkollor/akademik) për ndarje të bursave.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit** –tha se më herët doli në votimi propozimi i kryetarit të komunës dhe ai nuk i mori votat e mjaftueshme, për shkak se nuk u pranuan propozimet nga anëtarët e kuvendit. Andaj kësajvoj që çështje është përfunduar dhe si e tillë nuk mund të të votohet sërish në këtë mbledhje.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** –tha se propozimi i kryetarit të komunës nuk kaloi, por tani duhet të qitet në votim propozimi i anëtarëve të kuvendit për ta përfunduar procesin e votimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

**Pas konsultave dhe sqarimeve të nevojshme kryesuesja e kuvendit e hodhi në votim draft rregulloren e bursave me plotësimet e propozuara nga anëtarët e kuvendit, pas votimit kuvendi me 19 vota “për” aprovoj Draft – Rregulloren për Ndarjen e Bursave për Nxënës/Studentë dhe Shpërblimeve për Nxënës/Studentë të Komunës së Vushtrrisë, me propozimet e anëtarëve të kuvendit.**

**5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Rregullores për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Veprimtarive Afariste – Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë;**

**Alban Bajrami, anëtar i kuvendit** –kërkoj të përcaktohet saktë se cila ditë do të jetë pushime për sallonet e ondulimit, dita martë apo dita e diele. Mendon dhe konsideron se dita e diele do të jetë më në rregull të jetë ditë pushimi jashtë sezonit për këto kategori.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-** përsërit propozimin e tij se zgjidhja e kësaj çështje do të mund të gjendje më së mirë përmes Asociacionit të Komunave të Kosovës, me një rregullore unike. Tutje shtoi se tek neni 12 orari i punës për barnatore, ordinanca dhe klinika private, ku thuhet se: Ordinancat dhe klinikat private punojnë për të dy sezonat prej orës 07:00 - 22:00, mirëpo në bazë të ligjit për shëndetësinë thuhet se ordinancat duhet të punojnë me orar 7/24 në tërë vitin, për shkak të urgjencave shëndetësore. Nëse këto institucione kanë kërkuar të kenë një ditë pushim atëherë edhe këto është dashur të futen në një orar të kujdestarive sikurse tek rasti i barnatoreve. Po ashtu edhe neni 14 i kësaj rregulloreje duhet të rishikohet për sa i përket orarit të punës për barnaret bujqësore për ditët e diela sepse Vushtria është vend bujqësor dhe gjatë vikendeve qytetarët

kryesisht punojnë në të mbjellat bujqësore e që kanë nevoja për furnizim nga këto barnatore. Andaj në këtë rast duhet të aplikohet orari me kujdestari apo të hiqen nga kjo kategori këto subjekte. Tek neni 10.3 tregu i kafshëve punon vetëm ditën e premte, prej orës 07:00 - 15:00, të shtohet fjalia përjashtimisht javës së Kurban Bajramit Në fund ngriti dilema dhe kërkoj të rishikohet neni 22 sa i përket pezullimit të kësaj rregulloreje nga ana e kryetarit të komunës, sepse kjo e drejt nuk i takon kryetari por është në kompetencën e kuvendit.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit**-paraqiti vërejtjet e tij për sa i përket nenit 22 pezullimi i përkohshëm i dispozitave të kësaj rregulloreje, ku thuhet se: në rrethana të caktuara sipas vlerësimit të Kryetarit të komunës dhe rekomandimit nga faktorë tjerë institucionalë dhe qytetar, Kryetari i komunës mund të pezullojë përkohësisht zbatimin e dispozitave të caktuara të kësaj rregulloreje dhe të përcaktojë me vendim orarin e përkohshëm brenda vitit kalendarik për veprimtari të caktuara biznesore. Duke u bazuar në dispozitat e LVL-së konstaton se neni 22 i kësaj rregulloreje është në kundërshtim të plotë me nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ku thuhet: s 40.2 Kuvendi i komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për: a) statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre. Në këtë rast propozoi dhe kërkoj që të hiqet neni 22 nga kjo rregullore.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** –tha se përkundër shumë dilemave dhe vështirësive që do të dalin është mirë që kjo rregullore të aprovohet sot. Çështja e nenit për pezullimin e këtij akti nga kryetari i komunës, vlerëson se duhet të mbetet kjo për arsye praktike pasi që kuvendi nuk mund të mbledhjet në kohët të shpejt dhe delegimi i një autorizim për kryetarin e komunës i shërben funksionimit më të mirë administratës së komunës. Tek neni 7.5 taksa prej 30 € për orar të zgjatur të disa lokaleve afariste, duhet të shikohet sepse taksat vendosen konform ofrimit apo marrjes së një shërbimi të caktuar. Tek neni 14 propozoi të shtohet se barnatoret bujqësore do të punojnë sipas një orari kujdestari për ditëve të diela sipas orarit të përcaktuar nga Drejtoria e Bujqësisë.

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit** –paraqiti vërejtjet tek neni 11 orari i punës për pikat e shitjes së karburanteve, pikat e shitjes së karburanteve punojnë për të dy sezonat 24 orë non-stop. Ndërsa propozoi që metrazha për Restorantet dhe marketet e vogla si dhe veprimtaritë tjera afariste të cilat janë të ngjitura me pika të shitjes së karburanteve të jetë deri 100 m2, e të cilat kanë të drejtë të dhe mund të punojnë për të dy sezonat 24 orë non – stop.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** –tha se grupi kuvendar i LDK-së e përkrah këtë rregullore me ndryshimet e propozuara nga anëtarët e kuvend duke e hequr nenin 22 të saj.

**Bujar Pllana, drejtor i Drejtorisë së Inspektimeve**-tha se lidhur me çështjen e pushimit për sallonet e ondulimit do mbetet në dispozicionin e këtyre të vendosin a dëshirojnë të martën apo të dielën ta bëjnë ditë pushimi. Mandej tek ordinancat private që ofrojnë shërbime shëndetësore propozoi që të punojnë edhe të dielave, gjithashtu njëjtë të veprohet edhe me barnatoret bujqësore.

**Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore**-deklaroi se pavarësisht së është inkorporuar neni 22 i kësaj rregullore i cili fletë për suspendimin e fuqisë së saj nga kryetari i komunës, prapëseprapë është e drejtë ekskluzive e kuvendit ta votoj këtë rregullore me këtë dispozitë. Lidhur me atë se kjo depozitë a është në harmoni me ligjin nuk e ka një mendim të qartë në këtë moment.

**Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit**-propozoi që tek neni 5 Orari i punës i qendrave tregtare, marketeve, dyqaneve tregtare ushqimore, pijeve, duhanit, si dhe tregtia e çdo veprimtarie tjetër të artikujve joushqimor të shtohet pika 5.4. në tekstin si në vijim: Ditën e vikendit (e diel) dhe festave zyrtare, bizneset nga neni 5 nuk punojnë, përveç dyqaneve tregtare ushqimore në fshatra, të cilat do të punojnë deri në orën 12:00.

**Bujar Pllana, drejtor i Drejtorisë së Inspektimeve**-kërkoj nga kuvendi që barnatoret bujqësore dhe ordinancat veterinare të punojnë edhe ditëve të diela pa aplikuar rotacion.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 11 vota “për” 10 “kundër” 1 votë “abstenim” aprovoj Rregulloren për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Veprimtarive Afariste – Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë, me propozimet e anëtarëve të kuvendi të rikapituluara nga drejtori i Drejtorisë së Inspektimeve.**

Në vazhdim kuvendi me vota “unanime” vendosi që bëjë një zhvendosje të shqyrtimit të pikës së 13 të rendit të ditës dhe atë:

**13. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq;**

**Feride Hyseni, kryetare e Kryqit të Kuq të Kosovës-** në adresimin e saj paraqiti para kuvendit një ekspozitë të shkurtër për punën dhe veprimtarinë e Kryqit të Kuq dhe kërkoj mbështetje nga kuvendi për votimin e kësaj pike të rendit të ditës në ç’ rast i falënderoj të gjithë anëtarët e kuvendit për mbështetjen.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** –tha se përgjigje e kuvendit në kërkesën e Kryqit të Kuq do të jetë pozitive për në ndarjen e asaj prone për Kryqin e Kuq, duke mundësuar kështu krijimin e kushteve më të mira për punën e kësaj organizate në ofrimin e shërbimeve për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë. Kërkoj nga të gjithë anëtarët e kuvendi që unanimisht ta përkrahin këtë pikë të rendit të ditës.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** –deklaroi se grupi kuvendar i LDK-së e mbështet këtë propozim-vendim dhe vlerëson se ndërtimi i këtij objektit do të ndikoj në ngritjen e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë.

**Alban Bajrami, anëtar i kuvendit** –tha se e mbështet këtë pikë të rendit të ditës dhe shtoj se ndërtimi i këtyre zyrave për Kryqin e Kuq do të ndikoj në ngritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë.

**Sylejman Meholl, anëtar i kuvendit-** deklaroi se grupi kuvendar i LVV-së e mbështet kërkesën e kryqit të kuq për ndarjen e kësaj parcele për ndërtimin e zyrës së ardhshme për këtë organizatë. Po ashtu ai falënderoj kryqin e kuq për gjithë kontributin e dhënë në të gjitha etapat e historikut të Kosovës.

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit** –tha se Drejtoria për Gjeodezi e ka bërë parcializimin e kësaj prone në sipërfaqe prej 5 ari, dhe në këtë rast është kompletuar dokumentacioni ashtu që janë plotësuar të gjitha konditat ligjore për aprovimin e këtij vendimi.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq - Dega në Vushtri, në pjesë të parcelës kadastrale P-70202016-02253-11, në sipërfaqe prej 500 m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 4300 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Vushtri, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

**2.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Mjedisit.

**3.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit

6. Shqyrtimi i Raportit periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoj Raportin periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.**

7. Shqyrtimi i Informatës për shërbimet shëndetësore për vitin 2022 në Komunën e Vushtrrisë;

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit**-Të dashur qytetarë të Komunës së Vushtrrisë, para nesh kemi informatën e Drejtorisë së Shëndetësisë lidhur me shërbimet shëndetësore për vitin 2022.

Para se të prezantoj para jush raportin analitik dhe krahasues me vitet paraprake për shërbimet shëndetësore më lejoni të ritheksoj parimin e parë historik të mjekësisë që kur ajo ekziston e që kurrë nuk bëhet i vjetër e që është parimi **“Primum non nocere” që në gjuhën tonë të bukur shqipe përkthehet si “Së pari mos dëmto”.**

Të dashur qytetarë të Komunës së Vushtrrisë po e nisi analizën time për këtë lami kaq me peshë pikërisht me këtë postulatë sepse është pikërisht e kundërta e këtij parimi ajo qfarë ka bërë Qeverisja e Ferit Idrizit me shëndetësinë e Vushtrrisë në vitin e parë të mandatit të saj. Pra ajo ka dëmtuar rëndë shërbimet shëndetësore me performancën e vet në vitin e parë të qeverisjes.

E vërteta e shëndetësisë dhe shërbimeve shëndetësore të një vendi janë të matshme. Ato matën me indikatorë apo tregues shëndetësor, prandaj për t’i ikur çfarëdo tendence që analizës time të provohet ti jepet kahje politike unë do të paraqes para jush në formë krahasuese disa nga indikatorët më të rëndësishëm që flasin të vërtetën e dëmtimit të shërbimeve shëndetësore të komunës sonë gjatë vitit 2022. Le ti marrim një nga një këta indikator:

### **I. Indikator i parë: Numri i institucioneve shëndetësore funksionale:**

Nga 20 institucione shëndetësore funksionale sa i ka pasur komuna e Vushtrrisë tash e disa vite, në vitin 2022 nën Qeverisjen Idrizi ky numër ka rënë në 18. Pra në heshtje dhe pa transparencë janë mbyllur Ambulancat e Mjekësisë Familjare në fshatrat Zhilivodë dhe Skromë të cilat në këtë vit raportues as që figurojnë në tabelën e shërbimeve. Pra, në vitin 2022 kemi 2 institucione më pak që kanë ofruar shërbime shëndetësore.

### **II. Indikator i dytë: Numri i pacientëve dhe shërbimeve në sektorin e diagnostikës:**

Thuajse nuk ka indikator tjetër që është dëmtuar në cilësi, shërbime dhe parametra në vitin e parë të qeverisjes Idrizi aq sa sektori i diagnostikës. Në Laborator përveç rënjes së numrit të analizave që punohen në raport me vitet paraprake ka rënë ndjeshëm edhe numri i pacientëve dhe shërbimeve. Le ti krahasojmë më shifrat zyrtare të dy viteve të fundit:

Nga 20 482 pacientë sa morën shërbime në vitin 2021, në vitin 2022 ky numër ka rënë në 15 333 apo hiq më pak se 5149 pacientë, kurse numri i shërbimeve në laborator nga 228 338 sa ishte në vitin 2021, në vitin 2022 ra në 150 531 apo hiq më pak se 77 807 shërbime më pak!! Për me keq ka 8 muaj që laboratori kundërligjshëm punon pa shef të diagnostikës dhe specialist të biokimisë dhe mbi 2 muaj edhe pa kryetëknik të shërbimit laboratorik.

Aspak më mirë nuk ishte edhe në shërbimin tjetër diagnostik atë të rentgenit stomatologjik i cili thuajse gjithë vitin ishte jashtë funksionit. Le ti krahasojmë me shifra: nga 838 pacientë sa morën

shërbim në vitin 2021, ku numër ra në vetëm 31 pacientë në vitin 2022 apo shprehur në numra plotë 807 pacientë më pak!! Kurse shërbimet në këtë sektor ranë nga 1779 sa ishin në vitin 2021, në vetëm 45 sosh në vitin 2022, pra hiq më pak se 1734 shërbime më pak se viti paraparak. Kjo nuk do koment ma tepër.

### **III. Indikatori i tretë: Shkalla e vaksinimit me vaksinat obligative**

Një nga indikatorët më krenar që e ka pas Vushtrri në shëndetësi pa dyshim ndër vite ka qenë shkalla e përfshirjes së fëmijëve në vaksinim por që as ky tregues nuk i shpëtoj dëmtimit, që në vitin e parë të qeverisjes Idrizi. Dikur ishim komuna e parë në nivel Republike tani jemi komuna e fundit në nivel regjioni për sa i takon përfshirjes së fëmijëve në vaksinim. Bazuar në raportin e monitorimit të imunizimit nga QRSHP Mitrovicë, komuna e Vushtrrisë me vetëm 87% të përfshirjes së fëmijëve në imunizim ka mbetur mbrapa komunës së Mitrovicës e cila ka arritur përfshirjen në 89.2% dhe komunës së Skenderajt që ka arritur shkallën e përfshirjes në 92.2%. Përkundër kësaj nuk kemi parë as një organizim senzibilizimi apo përpjekje nga Komuna e Vushtrrisë për ta përmisuar situatën. Si rezultat i kësaj vetëm gjatë vitit 2022 kemi hiq më pak se 284 fëmijë nga komuna jonë të cilët nuk janë vaksinuar me vaksinat obligative duke rrezikuar seriozisht të kemi shpërthim të ndonjë epidemie të sëmundjeve vaksinë preventabile.

### **IV. Indikatori i katërt: Funkcionaliteti i pajisjeve dhe mjeteve motorike**

Funksionaliteti i pajisjeve mjekësore sikurse edhe mjeteve motorike është parakusht për shërbime cilësore. Por, viti 2022 ishte vit në të cilin në shumicën e kohës ambulancat dhe shumë pajisje mjekësore ishin jashtë funksionit duke dëmtuar rëndë cilësinë e shërbimeve shëndetësore. Mjafton të specifikojmë faktin se ka disa muaj që pacientët në dializë barten në shërbimin e dializës me kamioneten me rimorkio duke harruar ndjenjën e përgjegjësisë nëse ky transport i papërshtatshëm përkeqëson shëndetin e ndonjërit nga pacientët apo mundëson përhapjen e ndonjë infeksioni si hepatiti B që është mjaftë prevalentë tek këto raste të sëmundjes.

### **V. Indikatori i pestë: Realizimi i buxhetit vjetor të planifikuar**

E kam paraqitur edhe në seancën e kaluar e kaluar e kanë konfirmuar edhe përfaqësuesit e subjektit politik në pushtet se shkalla totale e realizimit buxhetor të planifikuar në Drejtorinë e Shëndetësisë së Komunës së Vushtrrisë për vitin 2022 ishte i tmerrshëm. Pacientët, shëndetësia dhe qytetarët e Vushtrrisë në përgjithësi, humben duke mos realizuar nga buxheti i planifikuar hiq më pak se: 794 007.56 Euro të cilat shkuan në suficit.

*Të dashur qytetarë unë do ta përmbyll me kaq analizën dhe fjalimin tim duke mos dashur të shtoj as edhe një koment politik përtej shifrave të vërteta indikative dhe zyrtare të paraqitura nga raportet zyrtare të dy viteve të fundit. Ndoshta për shumë kënd është e dhimbshme t'i dëgjoj këto të dhëna por që misioni i një kuvendarit është e vërteta e sidomos kur ajo paraqitet me fakte.*

**Nexhmedin Rashica, drejtor i DSHP-së**-tha ajo se çfarë deklaroi parafolësi i tij është e pa vërtetë dhe po përdoret për marketing politikë. Më tej sqaroi se Skrom dhe Zhilivoda, janë fshatra gati të zbrazura tërësisht dhe kjo bërë që mos të ketë ndonjë leverdi ekonomike për t'i dërguar mjek atje. Lidhur me laboratorin njoftoi se në fillim ka pasur problem, ndërsa tani gjithçka është në rregull dhe realizohen afër 18 lloje të analizave. Lidhur me shpenzimin e buxhetit njoftoi se po keq informohet publiku sepse buxheti është realizuar në manën prej 73% në Drejtorinë e Shëndetësisë.



8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2022;

**Pas shqyrtimi të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoj Raportin vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2022.**

9. Shqyrtimi i Informatës për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022;

10. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për emërim të komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në Komunën e Vushtrrisë;

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** –tha se ky komision ka kryer një punë të jashtëzakonshme profesionale, andaj kërkoj nga anëtarët e kuvendit të votojnë këtë propozim-vendim në mënyrë unanime.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit** –tha se edhe më herët e kishte kundërshtuar përbërjen e këtij komisioni dhe e kundërshton edhe tani. Kjo për faktin se ky komision ka qenë dhe është jo profesional dhe politikisht i anshëm, andaj kjo ka bërë të anulohem shumë konkurse për shkeljet që i kanë bërë.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** –tha se para disa dite kryetari i komunës ka bërë akuza të rënda në drejtim të këtij komisioni, dhe tani në mënyrë paradoksale sillet i njëjti komision për votim në kuvend, nëse ky komision ka bërë shkelje atëherë si ka logjik që prapë i njëjti të votohet.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit** –tha se komision në vitin e kaluar, ka punuar në mënyrë profesionale dhe e edhe kjo përbërje e komisionit është profesionale, andaj kërkoj që ky propozim-vendim të aprovohet.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** –tha se neni 3 i këtij vendim bie ndesh me udhëzimin administrativ sepse thuhet që mandati i këtij komisioni është për një vit shkollor ndërsa tani jemi në gjysmën e vitit shkollor kjo duhet të ndryshohet sepse udhëzimi përcakton se komisioni formohet vetëm për një procedurë të rekrutimit apo konkurs. Tutje shtoi se procesi i zgjedhjes së drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave në Komunën e Vushtrrisë, duhet të bëhet sipas legjislacionit në fuqi Ligjit për arsimin Parauniversitarë dhe Udhëzimin Administrativ Nr.151/2020 për Detyrat, Përgjegjësitë, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendës drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar, ku përcaktohen edhe parimet bazë siç janë: parimi i ligjshmërisë dhe depolitizimit, parimi i meritokracisë dhe kompetencës profesionale, parimi i transparencës dhe bashkëpunimit institucional, parimi i paanësisë mundësive të barabarta dhe mos diskriminimit dhe parimi i barazisë gjinore. Andaj në start po del se kemi shkelje të këtyre parimeve sidomos ai i barazisë gjinore. Tek pika 1.7 thuhet se: kandidati duhet të sjellë dëshmi dhe dokumente si në vijim: dhe aty në mënyrë taksative përshkruhen një mori e kushteve dhe dokumenteve që duhet ti posedoj kandidati pjesëmarrës në konkurs, ndërsa tek pika 1.7.7. thuhet se: kandidati duhet ta nënshkruaj deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike. Dy anëtarë të komunës të cilët propozohen nga DKA, dhe miratohen nga kuvendi i komunës .Anëtar i parë duhet të jetë i punësuar në DKA dhe duhet të jetë kryesuese i komisionit, anëtar i dytë po ashtu i propozuar nga DKA mund të jetë ekspert i pavarur i arsimit, drejtor i institucionit arsimor me performancë të lartë, përfaqësuese nga këshilli i prindërve me kualifikim të lartë dhe ekspertizë në fushën e edukimit po ashtu pjesëmarrës gjatë këtij procesi duhet të jenë dy përfaqësues nga Këshilli Drejtues në cilësinë e vëzhguesve një prind

dhe një mësimdhënës. Në fund shtoi se duke marr për bazë gjithë këto dilema nuk është e drejt që kjo pikë në këtë përbërje të votohet sot.

**Në vazhdim kryesuesja e kuvendit duke marr për bazë mungesën e kuorumit në sallën e mbledhjes, i ndërpreu punimet e mbledhjes, dhe njoftoj se mbledhje do të vazhdoj ditën e nesërm nga ora 10:00, me pikat e mbetura të pashqyrtuar të rendit të ditës.**

Ora e ndërprerjes së mbledhjes 17:25.

**Më datën 24 shkurt 2023 ditë e premte ora 10:50 kryesuesja e kuvendit hapi punimet e mbledhjes së ndërprerë të datës 23 shkurt 2023, konstatoj se në sallë janë të pranishëm 18 anëtarë të kuvendit kuorum i mjaftueshëm për marrjen e vendimeve të plotfuqishme me pika e rendit të ditës në renditje numërore pikat 10,11,12,14,15 dhe 16 të mbetura nga mbledhja e ndërprerë.**

**Hava Rruka- Mlinaku, drejtoreshë e DA-së-tha se çështja e Propozim – vendimit për emërim të komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në Komunën e Vushtrrisë, është e rregulluar me udhëzim administrativë**

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 18 vota “për” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim formohet Komisioni për përzgjedhje për vendet e punës, drejtor dhe zëvendësdrejtor, në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta në Komunën e Vushtrrisë, me këtë përbërje:

- 1.1. Hashim Hajrizi, zyrtar ligjor dhe i personelit në DKA;
- 1.2. Burim Gjaka, drejtor i SHFMU ”Mustafë Shyti” Oshlan;
- 1.3 \_\_\_\_\_, përfaqësues i MASHT-it.

2. Komisioni do t’i zhvillojë të gjitha procedurat për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në Komunën e Vushtrrisë, konform Udhëzimit Administrativ nr.151/2020 për Detyrat, Përgjegjësitë, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar.

3. Komisioni i cekur si në pikën 1 të këtij vendimi ka mandat për një vit shkollor.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria Komunale e Arsimit dhe komisioni i lartcekur.

11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për lirim nga pagesa e taksës për shfrytëzimin e hapësirave publike si dhe kiosqeve nga druri për më pak se një vit;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 18 vota “për” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim lirohen nga pagesa e taksës komunale, shfrytëzimi i hapësirave publike para lokaleve, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e gastronomisë për më pak se një vit, si dhe kioskat nga druri që jepen në shfrytëzim më pak se një vit nga data 3.1.2023 deri më 22.12.2023.

2. Qëllimi i këtij vendimi është përkrahja e këtyre veprimtarive, të cilat operojnë në gjendje jo të mirë ekonomike, vlera e përgjithshme e këtyre masave përlllogaritet të jetë 10000.00€, për kioskat nga druri, ndërsa për shfrytëzimin e hapësirave publike para lokaleve, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e gastronomisë, shuma përlllogaritet të jetë 4300.00€, për periudhën e cekur si në pikën e parë të këtij vendimi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, si dhe Drejtoria për Inspektive.

12. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit lidhur me themelimin e Këshillit për Siguri në Bashkësi;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 18 vota “për” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim ndryshohet vendimi 01-Nr. 24/22 i datës 31.1.2022 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, si në vijim:

1.1 Në pikën 1.14 Sedat Durmishi, përfaqësues i komunitetit ashkali, shkarkohet nga pozita e anëtarit të KKSB-së;

1.2 Në pikën 1.15 Brendon Shaqiri, përfaqësues i komunitetit rom, shkarkohet nga pozita e anëtarit të KKSB-së;

1.3 Në paragrafin 1, pika 1.3 Miradije Maloku, ish - Drejtore e Drejtorisë për Arsim, pushon të jetë anëtare e KKSB-së;

1.4 Në pikën 1.10 Simo Çimburoviç, përfaqësues i kishës ortodokse serbe, pushon të jetë anëtar i KKSB-së.

14. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për ndryshim-plotësimin e rregullores për punën e kuvendit dhe organeve të tij;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 18 vota “për” vendosi që kjo pikë të shtyhet për mbledhje e radhës.**

**Mbledhja përfundoi në ora: 11:00.**

**Bastri Duraku**

**Melihate Basholli-Latifi**

---

Procesmbajtës

---

Kryesuese e Kuvendit



**REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI**  
**Kryetari**

---



## **R A P O R T**

**PËR SITUATËN EKONOMIKE FINANCIARE DHE ZBATIMIN E  
PLANEVE INVESTUESE PËR VITIN 2022**

**Mars 2023**

## Hyrje

Në Raportin për situatën ekonomike financiare dhe realizimin e planeve investuese për vitin 2022 është paraqitë puna dhe aktivitetet e Kryetarit të komunës përkatësisht Ekzekutivit të komunës, në përmbushjen e detyrave si dhe përgjegjësisve të tyre të përcaktuara me ligj, akte nënligjore, Statutin e komunës si dhe planin punës së kryetarit – ekzekutivit të komunës për vitin 2022.

Aktivitetet kryesore të Kryetarit të Komunës - Ekzekutivit të Komunës gjatë v. 2022:

- Angazhimet ditore – koordinimi i punëve me drejtor të drejtorive me qëllim të përmbushjes së objektivave të përcaktuara me planet e punës,
- Mbajtja e takimeve javore me drejtor të drejtorive, përcaktimi i detyrave javore dhe raportimi për punët e kryera në baza javore,
- Angazhimet e vazhdueshme për realizimin e të hyrave të planifikuara buxhetore dhe shfrytëzimi sa më racional i mjeteve buxhetore përkatësisht shpenzimeve buxhetore,
- Mbikëqyrja e realizimit të buxhetit të komunës për vitin fiskal dhe realizimit të të hyrave vetanake,
- Mbikëqyrja e realizimit të projekteve kapitale të komunës,
- Raportimi i rregullt në kuvendin e komunës – çdo tre muaj për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore si dhe për situatën ekonomike financiare dhe realizimin e planeve investuese në çdo 6 muaj,
- Propozim-aktet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje të kuvendit të komunës,
- Mbikëqyrja në zbatimin e rregulloreve dhe vendimeve të miratuara në Kuvendin e Komunës,
- Mbikëqyrje në ngritjen e performancës në administratën e komunës, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më cilësore për qytetarë,
- Takimet e kohëpaskoshe me palë për çështjet apo problemet me të cilat ata janë ballafaquar,
- Takimet me qytetarë në tubime të ndryshme duke përfshi dy takimet obligative të parapara me ligj (njena në 6 mujorin e parë dhe takimi tjetër në 6 mujorin e dytë),
- janë mbajtur edhe takime tjera me rastin e shqyrtimit të draft buxhetit dhe projekteve prioritare për vitin vijues në të cilat qytetarët i kanë paraqitur kërkesat dhe nevojat për prioritetet e projekteve në meset e tyre.
- Takimet me përfaqësues të organizatave qeveritare dhe joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare, përfaqësues të OSBE, KFOR-it me grupet e ndryshme të komuniteteve etj.
- Bashkëpunimin me institucionet qendrore për realizim të projekteve me interes për komunën dhe qytetarët,

- Bashkëpunimin me organizatat e ndryshme humanitare me të cilat kemi realizuar projekte të përbashkëta me bashkëfinancim duke iu ofruar mbështetje me donacione të ndryshme si në fushën e bujqësisë, blegtorisë, etj.
- Bashkëpunim me shoqatat e dala nga lufta, Shoqatën e të burgosurve politikë dhe shoqata tjera.

Brenda vitit raportues, Kryetari i komunës ka nxjerrë 1117 vendime, 7 urdhëresa, 61 autorizime; ka nënshkruar 56 marrëveshje mirëkuptimi, ka dërgura 17 shkresa dhe kërkesa të ndryshme për ministri, ka pranuar 382 kërkesa të ndryshme të cilave iu është dhënë përgjigje brenda afatit ligjor, 8 raporte, propozim vendime dhe propoziti rregullorë për KPF dhe kuvend si dhe 178 shkresa tjera të natyrave të ndryshme.

Në vijim të këtij raporti do të paraqitet relizimi i punëve dhe aktiviteteve brenda vitit 2020, përkatësisht planeVE investuese të komunës sipas drejtorive.

## **BUXHET DHE FINANCA**

### **Planifikimi i buxhetit për vitin 2022 është si në vijim**

- Paga dhe mëditje..... 10,892,106.55€
- Mallra dhe shërbime..... 3,955,236.98€
- Shpenzime Komunale..... 442,504.93€
- Subvencione dhe transfero..... 1,365,940.00€
- Investime kapitale..... 6,042,316.42€
- Rezervat .....5,000.00€

**Totali i planifikimit të buxhetit për vitin 2022 është..... 22,703,104.88€**

### **Realizimi i buxhetit për periudhën Janar – Dhjetor 2022**

- Paga dhe mëditje ..... 10,100,513.53€
- Mallra dhe shërbime..... 3,317,493.01€
- Shpenzime Komunale..... 381,074.87€
- Subvencione dhe transfero..... 1,183,529.05€
- Investime kapitale..... 3,356,006.92€

**Totali i shpenzimeve..... 18,338,617.38€**

Realizimi i shpenzimeve në të gjitha fondet është ..... 81 %

Realizimi i shpenzimeve i fondit 10 Grnti Qeveritar është ..... 87 %

**PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS DREJTORIVE**

PËRSHKRIMI	KODI	PERIUDHA RAPORTUESE			VJETORE				Viti i kaluar
		BUXHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR	Përqindja e nuxhetit të alokuar	Buxheti I planifikuar për 2022	Buxheti I mbetur për 2022	Plani I reviduar 2022	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	Shpenzimi I realizuar për periudhën e njëjtë 2021
		€	€	%	€	€	€	€	€
Zyra e Kryetarit	160	457,218.00	370,896.13	81%	457,218.00	86,321.87	0.00	457,218.00	429,092.
Administrata dhe personeli	163	779,758.00	561,569.19	72%	779,758.00	218,188.81	0.00	779,758.00	347,928.
Inspektimet	166	142,815.00	90,006.24	63%	142,815.00	52,808.76	0.00	142,815.00	112,198.
Prokurimi	167	55,918.00	31,985.72	57%	55,918.00	23,932.28	0.00	55,918.00	31,663.
Zyra e Kuvendit Komunal	169	143,451.00	136,726.56	95%	143,451.00	6,724.44	0.00	143,451.00	135,142.
Buxheti dhe financat Shërbimet publike,	175	210,676.00	168,331.28	80%	210,676.00	42,344.72	0.00	210,676.00	156,479.
Mbrojtja civile dhe emergjenca	180	3,732,956.60	3,106,846.73	83%	3,732,956.60	626,109.87	0.00	3,732,956.60	3,509,000.
Zyra lokale e komuniteteve	195	81,871.00	55,279.92	68%	81,871.00	26,591.08	0.00	81,871.00	41,408.
Bujqësi, pylltari, zhvillimi rural	470	1,113,299.67	543,019.14	49%	1,113,299.67	570,280.53	0.00	1,113,299.67	474,938.
Gjeodezi dhe Kadastër	650	105,497.00	75,274.48	71%	105,497.00	30,222.52	0.00	105,497.00	77,598.
Planifikimi urban dhe mjedisi	660	1,680,389.49	986,703.83	59%	1,680,389.49	693,685.66	0.00	1,680,389.49	1,059,664.
Shëndetësia primare	730	3,277,487.14	2,483,479.58	76%	3,277,487.14	794,007.56	0.00	3,277,487.14	2,398,442.
Shërbimet sociale rezidenciale		339,459.00	217,759.93	64%	339,459.00	121,699.07	0.00		204,562.
Kulturë, rini, sport	850	819,893.46	515,729.78	63%	819,893.46	304,163.68	0.00	819,893.46	335,420.
Arsimi	920	9,762,415.52	8,995,008.87	92%	9,762,415.52	767,406.65	0.00	9,762,415.52	8,984,684.
<b>TOTALI</b>		<b>22,703,104.88</b>	<b>18,338,617.38</b>	<b>81%</b>	<b>22,703,104.88</b>	<b>4,364,487.50</b>	<b>0.00</b>	<b>22,703,104.88</b>	<b>18,298,225.</b>

Sqarim:

Përmbledhja e shpenzimeve sipas drejtorive është si vijon:

Buxheti I planifikuar është 22,703,104.88euro, buxheti I realizuar është 18,338,617.38euro shprehur nëpërqindje realizimi është 81% në total.

TE HYRAT VETANAKE (THV) SIPAS DREJTORIVE DHE KODIT EKONOMIK

Përshkrimi	Kod	Periudha raportuese			Vjetore				Viti i kaluar
		Buxheti I planifikuar për PR	Të hyrat e realizuar në PR	Përqindja e buxhet të realizuar për PR	Buxheti I planifikuar për 2022	Buxheti I mbetur për 2022	Plan I reviduar	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	
		4	5	6 = 5/4*100	7	8 = 7-5	9	10 = 7-9	11
Administrata dhe personell	163	€	€	%	€	€	€	€	€
Taksa administrative		70,000.00	76,279.00	109%	70,000.00	-6,279.00	0.00	70,000.00	75,211.00
<b>TOTAL</b>		<b>70,000.00</b>	<b>76,279.00</b>	<b>109%</b>	<b>70,000.00</b>	<b>-6,279.00</b>	<b>0.00</b>	<b>70,000.00</b>	<b>75,211.00</b>
<b>Inspeksioni</b>	<b>166</b>	€	€	%	€	€	€	€	€
Pranime teknike		5,000.00	7,035.00	141%	5,000.00	-2,035.00	0.00	5,000.00	3,358.00
Pelqimet sanitare		6,000.00		0%	6,000.00	6,000.00	0.00	6,000.00	16,527.49
Gjobat e inspeksionit		1,000.00	2,200.00	220%	1,000.00	-1,200.00	0.00	1,000.00	8,287.16
<b>TOTAL</b>		<b>12,000.00</b>	<b>9,235.00</b>	<b>77%</b>	<b>12,000.00</b>	<b>2,765.00</b>	<b>0.00</b>	<b>12,000.00</b>	<b>28,172.65</b>
<b>Buxhet dhe Financa</b>	<b>175</b>	€	€	%	€	€	€	€	€
Taksat e firmave		10,000.00	18,750.00	188%	10,000.00	-8,750.00	0.00	10,000.00	15,590.00
Tatimi në pronë		1,059,669.00	969,622.63	92%	1,059,669.00	90,046.37	0.00	1,059,669.00	895,449.83
<b>TOTAL</b>		<b>1,069,669.00</b>	<b>988,372.63</b>	<b>92%</b>	<b>1,069,669.00</b>	<b>81,296.37</b>	<b>0.00</b>	<b>1,069,669.00</b>	<b>911,039.83</b>
<b>Arsimi</b>	<b>900</b>	€	€	%	€	€	€	€	€
Shtjta e prodhimeve			578.60						839.10
Participimi në çerdhen e fëmijëve		45,000.00	41,785.00	93%	45,000.00	3,215.00	0.00	45,000.00	31,662.00
Shkolla e Mesme Teknike		15,000.00	15,073.00	100%	15,000.00	-73.00	0.00	15,000.00	12,717.00
Shkolla e Mesme Profesionale		14,000.00	17,020.00	122%	14,000.00	-3,020.00	0.00	14,000.00	17,211.00
<b>TOTAL</b>		<b>74,000.00</b>	<b>74,456.60</b>	<b>101%</b>	<b>74,000.00</b>	<b>122.00</b>	<b>0.00</b>	<b>74,000.00</b>	<b>62,429.10</b>
<b>Gjeodezi dhe Kadastër</b>	<b>650</b>	€	€	%	€	€	€	€	€
Të hyrat nga Gjeodezia dhe Kadastri		40,000.00	126,420.50	316%	23,000.00	-103,420.50	0.00	23,000.00	126,115.62
Qiraja nga objektet publike		23,000.00	14,162.00	62%	40,000.00	25,838.00	0.00	40,000.00	2,155.00
<b>TOTAL</b>		<b>63,000.00</b>	<b>140,582.50</b>	<b>223%</b>	<b>63,000.00</b>	<b>-77,582.50</b>	<b>0.00</b>	<b>63,000.00</b>	<b>128,270.62</b>
<b>Kulturë, rinj dhe sport</b>	<b>850</b>	€	€	%	€	€	€	€	€
Palestra e sportit		1,000.00	288.00	29%	1,000.00	712.00	0.00	1,000.00	636.00
Biblioteka		500.00	140.00	28%	500.00	360.00	0.00	500.00	232.00
Shtëpia e Kulturës		1,000.00	161.40	16%	1,000.00	838.60	0.00	1,000.00	335.00
<b>TOTAL</b>		<b>2,500.00</b>	<b>589.40</b>	<b>24%</b>	<b>2,500.00</b>	<b>1,910.60</b>	<b>0.00</b>	<b>2,500.00</b>	<b>1,203.00</b>
<b>Shërbime publike</b>	<b>180</b>	€	€	%	€	€	€	€	€
Parkingjet		2,000.00	5,002.00	250%	2,000.00	-3,002.00	0.00	2,000.00	1,450.00
Regjistrimi i automjeteve		83,000.00	136,402.00	164%	83,000.00	-53,402.00	0.00	83,000.00	130,700.50
Taksat e mbeturinave		613,734.00	438,997.05	72%	613,734.00	174,736.95	0.00	613,734.00	495,801.54
<b>TOTAL</b>		<b>698,734.00</b>	<b>580,401.05</b>	<b>83%</b>	<b>698,734.00</b>	<b>118,332.95</b>	<b>0.00</b>	<b>698,734.00</b>	<b>627,952.04</b>
<b>Prokurimi</b>			2,373.00						29,994.60
<b>Bujqësi</b>	<b>470</b>	€	€	%	€	€	€	€	€
Ndryshimi i destinimit të tokës		10,000.00	39,622.00	396%	10,000.00	-29,622.00	0.00	10,000.00	76,452.19
Shtjta e Drujve			945.00						30.00
Leje pune			3,820.00						
<b>TOTAL</b>		<b>10,000.00</b>	<b>44,387.00</b>	<b>444%</b>	<b>10,000.00</b>	<b>-29,622.00</b>	<b>0.00</b>	<b>10,000.00</b>	<b>76,482.19</b>
<b>Shëndetësi</b>	<b>700</b>	€	€	%	€	€	€	€	€
Participim		50,000.00	51,760.50	104%	50,000.00	-1,760.50	0.00	50,000.00	57,188.50
Participim QPS		2,000.00	3,830.00	192%	2,000.00	-1,830.00	0.00	2,000.00	4,130.00
<b>TOTAL</b>		<b>52,000.00</b>	<b>55,590.50</b>	<b>107%</b>	<b>52,000.00</b>	<b>-3,590.50</b>	<b>0.00</b>	<b>52,000.00</b>	<b>61,318.50</b>
<b>Urbanizmi</b>	<b>660</b>	€	€	%	€	€	€	€	€
Lejet e ndërtimit		205,892.00	508,826.74	247%	205,892.00	-302,934.74	0.00	205,892.00	545,111.62
Leje mjedisore			29,196.82						52,070.78
Legalizim i Objekteve			16,194.82						18,404.32
Rrenim i objekteve			2,437.68						1,025.64
Shfrytëzimi i pronës Publike		5,000.00	9,962.20	199%	5,000.00	-4,962.20	0.00	5,000.00	14,372.67
<b>TOTAL</b>		<b>210,892.00</b>	<b>566,618.26</b>	<b>269%</b>	<b>210,892.00</b>	<b>-307,896.94</b>	<b>0.00</b>	<b>210,892.00</b>	<b>630,985.03</b>
<b>Gjobat e pyjeve</b>	<b>850</b>	€	€	%	€	€	€	€	€
Të hyrat tjera			50.00						973.00
			30,465.00	#VALUE!		-30,465.00	0.00	0.00	34,035.73
<b>TOTAL</b>		<b>0.00</b>	<b>30,515.00</b>	<b>#DIV/0!</b>	<b>0.00</b>	<b>-30,465.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>35,008.73</b>
		<b>2,262,795.00</b>	<b>2,569,399.94</b>	<b>114%</b>	<b>2,262,795.00</b>	<b>-306,604.94</b>	<b>0.00</b>	<b>2,262,795.00</b>	<b>2,668,067.29</b>



Planifikimi i të Hyrave Vetanake për vitin 2022 janë 2,262,795.00 €

Realizimi i të hyrave për këtë periudhë është ..... 2,499,629.75€

Shprehur në përqindje 110.45 %,apo 10.45% inkasomi është i madhe se plani.

## EKONOMI BUJQESI PYLLTARI

### Sektori i bujqësisë

Gjatë vitit 2022 në sektorin e bujqësisë janë zhvilluar këto aktiviteteve, aktivitete të bazuara kryesisht në planin e punës për vitin 2022.

#### 1. Projekte ne bashkëfinancim me organizatën IADK

Fuqizimi i të rinjve dhe grave ne zonat rurale

Nr.	Lloji i investimit	Nr. i përfituesve	Fermerët	Komuna	IADK
1	Mekanizëm bujqësorë	8	8%	20%	72%
2	Serra	3	8%	20%	72%
3	Pajisje për bletari	1	8%	20%	72%
	<b>Totali</b>	<b>62,400.00€</b>	<b>4,800.00€</b>	<b>12,480.00€</b>	<b>45,120.00€</b>

#### Përmirësimi i punësimit dhe mundësi për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale

Nr.	Lloji i investimit	Nr. i përfituesve	Fermeri	Komuna	IADK
1	Serra	11	8%	20%	72%
2	Laktofriz, frezë dhe kosë	3	8%	20%	72%
3	Pajisje për ngritjen e njësisë për përgatitjen e ëmbëlsirave	1	8%	20%	72%
	<b>Totali</b>	<b>42,250.00€</b>	<b>3,250.00€</b>	<b>8,450.00€</b>	<b>30,550.00€</b>

2. Përkrahja në pjesëmarrje e 4 (katër) grave ne panairin AGROKOS ne Prishtinë që u ka mundësuar ekspozimin e produkteve prodhuese. Vlera e përkrahjes 2,614.88€

#### 3. Projekti Makina për shkokëlimin e misrit

Nr.	Lloji i investimit	Nr. i përfituesve	Participimi	Komuna	Shuma
1	Makina për shkokëlimin e misrit	18	18x100=1800.00€	14,220.00€	16,020.00€

#### 4. Projekti Moto kultivator me frezë

Nr.	Lloji i investimit	Nr. i përfituesve	Participimi	Komuna	Shuma
1	Moto kultivator me frezë	50	50x150=7500.00€	36,400.00€	43,900.00€

#### 5. Projekti Freza për traktorë 180cm

Nr.	Lloji i investimit	Nr. i përfituesve	Participimi	Komuna	Shuma
1	Frezë për traktorë	36	7,200.00?	26,892€	34,092€

#### 6. Subvencionimi

Nr.	Lloji i investimit	Nr. i përfituesve	Shuma
1	Subvencionimi për Litër qumësht	101	72,779.55€
2	Ujitja e kulturave bujqësore	201	41,546.95€
3	Subvencionimi për shoqëri bletësh	133	40,240.00€
4	Subvencionimi për dhi e dele	31	12,548.00€
5	Subvencionimi për buallica	2	870.00

#### 7. Projekti “ Ndërtimi i shëtitorës dhe shtegut për biçikleta bri lumit Silnica” ne bashkëfinancim me MZHR.

-Vlera e projektit 146400.00 euro MZHR- 117,106.98€ Komuna -29,293.02 €

#### 8. Rregullimi i argjinaturave te lumit Silnica. Vlera e projektit 27,612.70 €

#### 9. Vendime për shndërrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore.

Gjithsejtë vendime të lëshuara 19 me vlerë te përgjithshme 51629 €

#### Spektori i Pylltaris

Nr.	PËRMBAJTJA	SASIA	VREJTJE
1.	Kërkesa të paraqitura për leje-prerje	32	
2.	Kërkesa të kryera	9=332.93m <sup>3</sup>	
3.	Damkosje ,dru zjarri	332.93m <sup>3</sup>	
4.	Vulosje,dru zjarri	22 flp=45.50m <sup>3</sup>	
5.	Fletëpagesa p.private	9copa=615.10€	
6.	Konfiskime	31 copa= 52.20m <sup>3</sup>	
7.	Zjarre në pyje	65.70h,Prona private-shtetnore	Shkurre-Kullota-Lëndina-
8.	Fletëparaqitje kundërvajtje	99=180.73m <sup>3</sup> =26476.54€	Gjithsejtë 128copa=272.25m <sup>3</sup> =39845.53€
10.	Fletëparaqitje penale	29=91.52m <sup>3</sup> =13368.99€	
11.	Kontrolle terreneve	113	Ne te gjitha terenet

Kemi pas kontakt pune, me Komandantin e Stacionit policor si dhe bashkëpunëtorët e tij për organizimin e aksioneve, ku plani operativ është bërë nga drejtoria.

Kemi bërë regjistrimin e rregullt ne dy njësit menagjuse te Sllakocit dhe Qyqavices përkatësisht ne terrenet: Sllakoc, Bukogllav(Vesekoc), Quka e Skoqnes, Gerdeq, Qyqavica –I-II-III- dhe Oblovik te Pishat.

Sipërfaqe te pyllëzuara: Në terrenin e f.sh. Vesekoc nga DK e APKsë janë pyllëzuar 25 ha me fidanë pishë e bardhë dhe pishë e zezë.

Gjatë vitit 2022, (2) terrene janë te pa mbuluara me roje pylli.

### Sektori për biznes

Qendra Komunale e Biznesit vepron në kuadër të Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve te Kosovës - Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë që është institucion i vetëm përgjegjës për regjistrimin e bizneseve të Kosovës. Ky sektor

funksionon në bazë të një sistemi elektronik të dhënash, si një proces më i thjeshtë, më i shpejtë, pa shpenzime për regjistrimin e bizneseve fillestare, kërkesa per ndryshim si dhe shërbime te tjera. Sistemi i tanishëm ka ndikuar në rritjen e transparencës, si dhe ka një rritje të standardeve dhe përpjekjeve për të harmonizuar procedurat e regjistrimit me direktivat e Bashkimit Evropian

Në vazhdim do të japim pasqyrën tabelore të bizneseve të regjistruara gjatë periudhës 01.01. – 30.12.2022

CODE	VEPRIMTARITË EKONOMIKE	Bizneset prej 01.01-30.12.2022	%
1	Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria dhe peshkimi	17	5.29
2	Industria përpunuese	43	13.39
3	Furnizimi me energji elektrike dhe ujë Kanalizimi aktivitetet e menaxhimit dhe te trjatumit te mbeturinave	3	934
4	Ndërtimtaria	42	13.08
5	Treg.me shumicë dhe pakicë, riparimi i auto. dhe aparateve tjera të amvisërisë	69	21.49
6	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	8	2.49
7	Transporti dhe magazimi Informimi dhe komunikimi	36	11.21
8	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	16	4.98
9	Aktivitetet e patundshmërisë Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike, shërbimet administrative dhe mbështetëse	1	3.11
10	Arsimi	18	5.60
11	Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	29	9.03

12	Artet, argëtimi dhe rekreacioni, aktivitetet tjera shërbyese	36	1.25
13	Aktivitetet e ekonomive familjare	3	9.34
	<b>Gjithsej</b>	<b>321</b>	<b>100</b>

Siç shihet nga të dhënat e mësipërme, si veprimtari dominuese ekonomike është tregtia me 21.49 % apo me 69 biznese prej numrit të përgjithshëm, pastaj industria përpunuese me 43 biznese apo me 13.39%, ndërtimtaria me 13.08 % apo me 42 biznese, etj.

Në vazhdim do të japim pasqyrën tabelore të bizneseve të shuar, sipas veprimtarive ekonomike.

<b>Kodi</b>	<b>VEPRIMTARIT EKONOMIK</b>	<b>Bizneset prej 01.01-30.12.2022</b>	<b>%</b>
1	<b>Bujqësia, Gjuetia dhe pylltaria</b>	<b>6</b>	<b>8.95</b>
2	<b>Industria e Minierave dhe Ekstraktuese</b>	<b>10</b>	<b>14.91</b>
3	<b>Industria përpunuese</b>	<b>1</b>	<b>1.49</b>
4	<b>Ndërtimtaria</b>	<b>5</b>	<b>7.47</b>
5	<b>Tregtia me shumicë dhe pakice riparimi i automjeteve dhe aparateve tjera të amvisëri</b>	<b>21</b>	<b>31.34</b>
6	<b>Hotelet dhe Restorantet</b>	<b>3</b>	<b>4.47</b>
7	<b>Transporti,depot dhe telekomunikacion</b>	<b>5</b>	<b>7.47</b>
8	<b>Administrimi dhe Mbrojtja publike Mbrojtja e obligueshme sociale</b>	<b>5</b>	<b>7.47</b>
9	<b>Arsimi</b>	<b>5</b>	<b>7.47</b>
10	<b>Aktivitet tjera shoqërore dhe personale</b>	<b>6</b>	<b>8.96</b>
	<b>Totali</b>	<b>67</b>	<b>100</b>

Siç shihet nga të dhënat e tabelës edhe tek shuarjet dominon tregtia me 31.34% .

Deri më 30.12. 2019 në QKB në Vushtri janë kryer gjithsej këto shërbime:

Gjatë kësaj periudhe (01.01. – 30.12.2022 ) kemi pasur gjithsej 321 biznese të reja të regjistruara, prej të cilave 205 janë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SHPK), ndërsa pjesa tjetër biznese individuale.

Ndërsa në bazë të dhënave të siguruar nga ATK – zyra regjionale në Mitrovicë, gjithsej numri i të punësuarave në komunën tonë – sektorin privat është;

- **Të vetëpunësuar 1210**
- **Të punësuar – dallon sipas muajve por që mesatarja e të punësuarave është 4805**

## PROKURIMI PUBLIK

I tërë aktiviteti i prokurimit i realizuar është bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë, me ndryshimet dhe plotësimet e tij, Rregulloren e Prokurimit Publik, e cila ka hyrë në fuqi dhe zbatohet nga data 01. Nëntor 2022 Nisur nga dokumentet bazike të përmendura si më lartë, Drejtoria, gjatë aktivitetit të saj të punës ka pasur për bazë dhe piksynim, gjithnjë, përmbushjen dhe respektimin e parimeve bazë të LPP-së, sikurse janë: parimi i ekonomicitetit (**vlerës për paranë**), barazisë në trajtim/jo diskriminim, efikasitetit, transparencës etj. Duke zbatuar këto parime, është synuar që, në të gjitha aktivitetet e prokurimit të realizuara nga Drejtoria, të sigurohet që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën sa më ekonomike, më efikase, më transparente.

Në periudhën raportuese, Drejtoria, konform dispozitave ligjore që rregullojnë lëmin e prokurimit publik, ka iniciuar dhe realizuar 104 prokurime, për t'i realizuar dhe përmbushur kërkesat për gjitha shtyllat e buxhetit të Autoritetit Kontraktues respektivisht për gjitha Njësitë Kërkuese.

Në tabelat si më poshtë janë paraqitur të dhënat lidhur me Planifikimin e prokurimeve për vitin 2022 si dhe gjendjen respektivisht realizimin e projekteve të pasqyruara, si vijon :

### **II.1) KONTRATAT PËR FURNIZIM**

<b>Nr. Ren.</b>	<b>Përshkrimi i Kontratës</b>	<b>Aktiviteti është inicuar – Kontrata është nënshkruar PO / JO</b>
1	Furnizim me paisje të TI-së për sallën e testimit për rekrutim	Po
2	Furnizim me inventar për QKMF-të	Po
3	Furnizim me inventar për shkolla	Po
4	Furnizim me inventar	Jo – nuk është inicuar
5	Furnizimi dhe montimi i motorrit për gjenerator të administrates komunale	Po
6	Furnizimi dhe montimi i kalldave dhe paisjeve tjera për ngrohje	Po
7	Furnizimi dhe montimi i kalldave për ngrohjet SHMT Lutfi Musiqi dhe në SHMU-II	Në vlerësim
8	Furnizimi me kurora dhe lule për homazhe dhe buqeta me lule	Po
9	Furnizim me paisje për lavanteri	Në vlersim
10	Furnizim me paisje Mjekësore	Po
11	Furnizim me gjeneratorë	Në vlerësim
12	Furnizimi dhe montimi i kamerave në rr. Dëshmoret e Kombit, shkolla, SHR-le dhe QMF AMF-të në fshatra	Në vlerësim
13	Furnizimi me material shpenzues për zyre	Po
14	Furnizim me enë për kuzhinë	Po

15	Furnizimi me stufa për ngrohje	Nuk është inicuar
16	Furnizim me bombola të oksigjenit mjekësor	Po
17	Furnizim me filma të rentgenit (RTG-së)	Po
18	Furnizim me barna dhe material shpenzues shëndetësor	Po
19	Furnizimi me reagensa dhe material shpenzues për laborator	Po
20	Furnizim me material higjienik	Po
21	Furnizimi dhe montimi i kabllit optike	Nuk është inicuar
22	Furnizimi me goma për automjetin e zjarrfikës	Po
23	Furnizimi me pajisje dhe mjete për zjarrfikje	Po
24	Furnizim me pemë dhe Perime	Po
25	Furnizimi me pajisje për kabinetin e teknologjisë ushqimore	Është inicuar, nuk është përfunduar
26	Furnizimi me pajisje për kabinetin e metalurgjisë	Është inicuar, nuk është përfunduar
27	Furnizimi me pajisje për praktikë profesionale	Është inicuar, nuk është përfunduar
28	Furnizimi me pajisje për praktikë profesionale për SHMP Bahri Haxha	Është inicuar, nuk është përfunduar
29	Furnizimi me pajisje laboratorike për SHMP Bahri Haxha	Është inicuar, nuk është përfunduar
30	Furnizimi me drunjëve dekorativ për oborret e shkollave	Po
31	Furnizimi me material pedagogjik	Po
32	Furnizim me aparate kundër zjarrit	Është inicuar, nuk është përfunduar, ka Ankesë në OSHP
33	Furnizimi me makina për kositjen e barit	Po
34	Furnizimi dhe montimi i ulëseve për nxënës dhe shportave për mbeturina në oborret e shkollave	Nuk është e inicuar
35	Furnizimi me topa, rekuizita dhe mjete tjera sportive	Po
36	Furnizimi me projektor dhe mbajtëse për projektor	Në vlerësim
37	Furnizimim me TV për shkolla	Në vlerësim - anulim
38	Furnizim me gazë natyror për kuzhinë	Është inicuar disa here por nuk ka pasur O.E. të interesuar.
39	Furnizim me flamuj për nevojat e AK.- Vushtrri	Po
40	Furnizim me pajisje elektrike për amvisëri	Po
41	Furnizimi me perde dhe tepiha	Po

42	Furnizim me lodra për fëmijë	Po
43	Furnizim me produkte tekstili (Qarqaf, qebe,jastak,tepi)	Po
44	Furnizimi me mjete konkretizimi	Po
45	Furnizimi me Teknologji Informative	Po
46	Furnizimi me aparate fotokopjuese	Nuk është inicuar aktiviteti
47	Furnizimi dhe montimi i klimave	Po
48	Furnizimi dhe montimi i kalldas elektrike në QMF LumMadh	Në vlerësim
49	Furnizimi me diktafon	Është inicuar, nuk ka pasur sukses procedura
50	Furnizim me notesa me kalendar	Po
51	Furnizimi me preparate kimike	Po
52	Furnizim me veshmbathje	Po
53	Furnizim me lëndë djegëse - pelet për ngrohje	Po
54	Furnizim me materiale për festat e fundvitit	Nuk është inicuar
55	Furnizim me lëndë djegëse - dru për ngrohje	Po
56	Furnizimi me libra për bibliotekën e qytetit dhe të shkollave	Nuk është inicuar aktiviteti
57	Furnizimi dhe montimi i xhamave në objektet shkollore, shëndetësore dhe të administratës	Nuk është inicuar aktiviteti
58	Furnizim me aparatur për kinema për funksionalizim në qenden e kulturës	Po
59	Digjitalizimi i pulit dhe ndriçimit profesional për teatrin Hasan Prishtina	Po
60	Furnizim me aparat të oksigjenit për rezident	Po
61	Furnizim me kupa dhe medalje për aktivitete kulturore dhe sportive	Në procedurë
62	Furnizim me bari për oborre të shkollave	Po
63	Furnizim me paisje të TI-së për SHMP Bahri Haxha	Po
64	Inventarizimi i Qendrës së Kulturës	Po
65	Furnizimi dhe montim i kuzhinës në DBTHF	Po
66	Furnizim me material për radiologji	Po
67	Furnizim me impute dhe farëra tjera për mbyllje pranverore	Po
68	Furnizimi me paisje (materialeve) sportive për DKRS	Po
69	Furnizim me pompë uji për SHFMU Jusuf Gërvalla	Po
70	Furnizimi me dekorata për ndarjen e titullit Qytetar Nderi	Po

## II. 2) Kontratat për Shërbime

Nr. Ren.	Përshkrimi i Kontratës	Aktiviteti është inicuar – Kontrata është nënshkruar  PO / JO
1.	Shërbime të arsimit dhe trajnimit	Nuk është inicuar
2.	Servisimi dhe mirëmbajtja i ngrohjeve qendrore	Nuk është inicuar
3.	Mirëmbajtja e ndriçimit publik	Po
4.	Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal	Është inicuar, po nuk është përfunduar
5.	Mirëmbajtja e serverit të sistemit të menaxhimit të mbeturinave	Jo, nuk është inicuar
6.	Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve	Është inicuar, nuk është përfunduar
7.	Shërbime Hoteliere	Po – kontratë kornizë
8.	Sigurimi i automjeteve	Po – kontratë kornizë
9.	Kontrollimi teknik i automjeteve	Po – kontratë kornizë
10.	Servisimi dhe mirëmbajtja e gjeneratorëve	Nuk është inicuar
11.	Servisimi dhe mirëmbajtja e TI-së	Nuk është inicuar
12.	Servisimi dhe mbushja e aparateve kundër zjarrit	Nuk është inicuar
13.	Servisimi dhe Mirëmbajtja e paisjeve të komunikimit	Jo – nuk është inicuar
14.	Servisimi dhe mirëmbajtja e aparateve të rentgenit dhe paisjeve përcjellëse	Është inicuar, nuk është përfunduar
15.	Pastrimi, fshirja dhe larja e rrugëve	Nuk është inicuar
16.	Pastrimi dhe larja e tepihave dhe karrigeve	Nuk është inicuar
17.	Pastrimit dhe larja e automjeteve	Po
18.	Servisimi, mirëmbajtja dhe mbushja e klimave	Nuk është inicuar
19.	Transporti i nxënësve	Po – kontratë kornizë



20.	Shërbimet e sigurimit shëndetësor të nxënësve gjatë praktikës profesionale	Po
21.	Shërbimet e Deratizimi, Dezinfektimit dhe Dezinsektimi	Është inicuar, lënda në procedurë për shkak të Ankesës në OSHP
22.	Shërbime mediale për aktivitete të Komunës së Vushtrrisë	Po – kontratë kornizë
23.	Shërbimet për asgjësimin e mbeturinave medicinale	Nuk është inicuar
24.	Shtypja e materialeve të ndryshme zyrtare	Në vlerësim
25.	Punimit i dekoratave	Po
26.	Mirëmbajtja e nyjeve sanitare, ujësjellësit dhe rrjetit elektrik në objekte	Nuk është inicuar
27.	Servisimi dhe mirëmbajtja e ashensorëve	Nuk është inicuar
28.	Shërbime të përkthimeve	Nuk është inicuar
29.	Shërbime konsulente profesionale për persona individual për Drejtorin për Buxhet, Thesar dhe Financa	Po
30.	Shërbime konsulente profesionale për persona individual për Drejtorin e Urbanizmi dhe Mbrojtje të Mjedisist	Po
31.	Shërbime konsulente profesionale nga persona individual për Zyren e Kryetarit	Po
32.	Shërbime konsulente profesionale nga persona individual për Drejtorin e Inspeksionit	Po
33.	Shërbime konsulente profesionale nga persona individual për Drejtorin për Kadaster, Gjeodezi dhe Pronë	Po
34.	Servisimi, kontrolli dhe instalimi i programeve të paisjeve gjeodezike	Po
35.	Shërbime Juridike për përfaqësim ligjor të Komunës	Po
36.	Shërbime me tenda dhe binë me zerim për aktivitete kulturore	Po
37.	Shtypja e materialeve për aktivitetet kulturore	Nuk është inicuar
38.	Rehabilitimi i zyrës në objektin e DGJKP	Po
39.	Shtypja e posterave për promovimin e profileve të SHMP Bahri Haxha	Po
40.	Shtypja dhe botimi i monografisë së gjimnazit	Po

41.	Servisimi i gjeneratorëve në shkolla	Po
42.	Marrja me qira e tendës me 200 karrige dhe tualete mobile	Po
43.	Hartimi i tri (3) projekteve për investime kapitale	Po

### II. 3) KONTRATAT PËR PUNË

Nr. Ren.	Përshkrimi i kontratës / Karakteristikat thelbësore të secilës kontratë për punë	Aktiviteti është inicuar – Kontrata është nënshkruar  PO / JO
1.	Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni rr. Skenderbeu , Bekim Zenuni , Mursel Hyseni	Është inicuar, nuk ka pasur sukses procedura
2.	Ndërtimi i kanalizimeve Samadrexhë, Maxhunaj, Smrekonicë	Po
3.	Sinjalizimi horizontal dhe Vertikal rr. Dëshmoret e Kombit , I. Qemajli , Bekim Brisha	Po
4.	Ndërtimi i sheshit dhe parqeve në Qytet, fsh. Stroc, fsh. Smrekonicë	Nuk është inicuar
5.	Rregullimi i varrezave të qytetit - Vushtrri	Po
6.	Ndërtimi i Vigave mbi lumin Silnica, Tërstena dhe Stanoc	Po
7.	Rikonstruktimi i rrugëve të asfaltuara	Po – kontrate kornize
8.	Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në Vushtrri, Dobërllukë, Maxhunaj, Stanoc	Po
9.	Ndërtimi i urave dhe mureve mbrojtëse në Stanoc dhe Pantinë	Po
10.	Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatra	Po – në realizim
11.	Ndërtimi i parqeve	Po – në realizim
12.	Rregullimi i argjinaturave të lumit Silnica	Po
13.	Ndërtimi i aneksit në QKMF Vushtrri (depo dhe Garazhë)	Po
14.	Renovimi dhe Ngjyrosja e QMF-1 në Vushtrri	Po
15.	Rindërtimi i laboratorit në QMF-3 në Vushtrri	Po
16.	Rregullimi i oborrit të QKMF-së në Vushtrri	Po – në realizim

17.	Ndërtimi i recepcionit në QMF-3	Po
18.	Rregullimi i nyjeve sanitare në objektin e administratës Komunale	Po
19.	Ndarja fizike e objektit të në Administratën Komunale	Është inicuar, nuk është përfunduar
20.	Renovimi i Palestrës Jeton Terrstena	Në vlerësim
21.	Ndërtimi i objektit ndihmës në stadiumin	Po – në realizim
22.	Ndërtimi i depos në qendrën Rinore Naxhije dhe Fahri Buçinca	Nuk është inicuar
23.	Ndërtimi i fushës sportive dhe rrethojës në SHMU Lummadh	Po
24.	Ndërtimi i tualeteve në SHMU Emin Duraku	Po – realizimi e sipër
25.	Ndërtim i platosë me kubëza betoni në SHMU në Vushtrri	Po
26.	<b>Ndërtimi i fushës sportive në SHMU Enver Hadri</b>	Nuk është inicuar
27.	Ndërtimi i depos në Shf. Naim Frashëri në Vushtrri	Po
28.	Ndërtimi i depos në Shf. Latif Berisha në fshatin Dobërllukë	Po
29.	Ndërtimi i depos në Shf. Mustafë Shyti në fshatin Oshlan	Po
30.	Ndërtimi i rrethojës në SHMU Mustafë Shyti në Fshatin Oshlan	Po ralizim
31.	Ndërtimi i rrethojës në SHFU Rilindja në Fshatin Vilanc	Po ralizim
32.	Renovimi i objektit të SHMU Adem Voca në fshatin Pasomë	Po
33.	Renovimi i objektit të SHMU Lumni Surdulli në fshatin Samadrxhë	Po
34.	Renovimi i objektit të SHMU Enver Hadri në fshatin Smrekonicë	Po
35.	Renovimi i objektit të SHMU Rilindja në fshatin Vilanc	Po
36.	Renovimi i objektit të Shf. Ali Kelmendi në fshatinë Studime	Po
37.	Renovimi i objektit të SHFMU Mihaliqi në fshatin Mihaliq	Po
38.	Renovimi i objektit të SHFMU Rexhep Musa në fshatinë Ceceli	Po
39.	Rregullimi i SHFMU në fshatin Stanofc me infrastruktur	Po
40.	Renovimi i objektit dhe ndërtimi i tauleteve në Shf. Naim Frashëri në Vushtrri	Po
41.	Renovimi i objektit të SHFMU Azem Bejta në fshatinë Beqiq	Po

42.	Renovimi i ngrohjes qendrore në SHMP Bahri Haxha	Vlersim
43.	Ndriçimi i oborrit të shkollës	Nuk është inicuar
44.	Renovimi i qendrës rezidenciale	Po
45.	Renovimi i Objektivit të Njësisë së Zjarrfikësve	Po
46.	Ndërtimi i sallës në Objektivin e Komunës	Po
47.	Ndërtimi i Depos	Po
48.	Ndërtimi i shkollës në fshatin Gllotvinë	nuk është inicuar
49.	Asfaltimi i rrugës Vesekovc-Sllakovc	Po – në realizim
50.	Ndërtim i depos për mbeturina medicinale	Po – në realizim
51.	Ndërtimi i zyrave të administratës së QKMF-së	Po – në realizim
52.	Ndërtimi i shëtitores dhe shtegut për biçikleta Vushtrri-Nedakovc, bri lumit Sitnica	Po – në realizim

#### II. 4) KONKURS PROJEKTIMI

Nr. Ren.	Përshkrimi i kontratës / Karakteristikat thelbësore të secilës kontratë për punë	Aktiviteti është inicuar – Kontrata është nënshkruar PO / JO
1.	Rikonstrimi i Bulevardit “ Adem Jashari “ dhe lidhja me parkun e qytetit	Vlersim.

Nga pasqyra e prokurimeve të planifikuara për vitin fiskal 2022, rezulton se projektet për furnizime nga 70 aktivitete të planifikuara janë kontraktuar 44 projekte , projektet për shërbime nga 43 të planifikuara janë kontraktuar 24, ndërsa tek punët nga 52 projekte të planifikuara janë kontraktuar 45 projekte.

Nëse marrim për bazë procedimin dhe realizimin e projekteve në vitin 2022, sikurse u pasqyruan në Pasqyrën si më lartë, atëherë vijmë në përfundimin se plani i punës respektivisht procedimi, kontraktimi dhe realizimi i projekteve në vitin 2022 nuk është i kënaqshëm është përbushur në masën : 68.48% nga ajo që ishte planifikuar..

Duke zbatuar procedurë të përbashkët për disa njësi kërkuese, me theks të veçantë te Kontratat Kornizë, me qëllim të ekonomizimit dhe efikasitetit, duke pasur parasysh gjithnjë transparencën dhe trajtimin e barabartë të Operatorëve Ekonomik, është arritur në masë të kënaqshme që procedimi i projekteve të planifikuara të realizohet në kohë dhe në mënyrë të suksesshme tek kontratat kornizë.

Nga gjithë aktivitetet e prokurimit të procesuara në këtë vit, me theks të veçantë te prokurimet për punë, vetëm në 4 ( katër ) raste - aktivitete të prokurimit ka pasur punë shtesë respektivisht punë të paparapara, është fjala për projektin :

- Renovimi i stadiumit të hendbollit “ Musa Abazi “ , vlera e punëve shtesë ishte në shumë prej: 11.098,76€;
- Ndërtimi i vigave mbi lumen Silnic, Tërstena dhe fsh. Stanofc, vlera e punëve shtesë ishte në shumë prej : 1.133,80€;

- Ndërtimi i objektit ndihmës në stadiumin “ Ferki Aliu “ , vlera e punëve shtesë ishte në shumë prej : 5.031,35€, dhe

- Renovimi i objektit të sh.f. “ Naim Frashëri “ , vlera e punëve shtesë ishte në shumë prej : 6.270,70€.

Duhet theksuar po ashtu se për vonesa të paarsyeshme kemi aplikuar penale për shkak të vonesave të pajustificueshme në përfundimin e kontratës ndaj disa Operatorëve Ekonomik ( 4 Operatorve Ekonomik ). Vlera financiare e aplikimit të penaleve kap shumën prej 6.707,13€.

Në këtë drejtim, edhe në vitin 2022, një angazhim të theksuar është duke luajtur edhe Agjencioni Qendrorë i Prokurimit ( AQP ), i cili, bazuar në kompetencat dhe përgjegjësit e tija që i ka në bazë të LPP-së, në bashkëpunim dhe me Autoritetet Kontraktuese të nivelit qendrorë dhe lokal është duke ndërmarrë aktivitetet të prokurimit të përbashkëta respektivisht të centralizuara për të lidhur kontratë të përbashkët për të përmbushur nevojat e Autoriteteve Kontraktuese, e vaqanërisht në sferën e furnizimeve dhe shërbimeve.

Si edhe në vitet e mëparme, edhe në vitin 2022, personeli i drejtorisë ka ndjekur rregullisht trajnimet në lëmin e prokurimit të organizuara nga KRPP, përkatësisht Instituti i Kosovës për Administratë Publike por edhe nga USAID , konform kërkesave të LPP-së për aftësi profesionale të zyrtarëve të prokurimit dhe të njësive tjera të Autoritetit Kontraktues.

## **URBANIZEMDHE MBROJTJE TE MJEDISIT**

Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Komunën e Vushtrrisë ka vazhduar aktivitetet për udhëheqjen e procedurave administrative për trajtimin e kërkesave në kuadër të: Sektorit të Urbanizmit, Planifikimit, Legalizimit, Mjedisit dhe Zyrës së Adresave si dhe Shërbimet Juridike.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022, kryesisht janë mbajtur takime të organizuara nga sektori i planifikimit urban për çështjet e rregullimit urban, pjesëmarrja në konferenca të organizuara nga niveli qendror dhe grupe tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, takimet e rregullta me komunitetet e zonave të ndryshme, propozimet e ndryshme për rregullimin e infrastrukturës dhe është punuar në rritjen e bashkëpunimit në mes të DUMM me drejtoritë e tjera për qëllim të rritjes së profesionalizimit dhe efikasitetit për realizimin e qëllimeve të përbashkëta.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022, DUMM ka zbatuar në përpikëri Planin Zhvillimor Komunal ku zyrtaret përgjegjës gjatë çdo shqyrtimi të kërkesave të pranura që kanë të bëjnë me ndërtime dhe informime tjera rreth destinimit të parcelave kadastrale të tyre janë udhëzuar me destinimin e përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal po ashtu kërkesat e parashtruara për marrjen e Kushteve Ndërtimore, Lejeve Ndërtimore dhe Lejeve për Rrënimin e objekteve për kategorinë e parë (I) dhe të dytë (II ) janë trajtuar me përkushtim dhe në harmoni të plotë me Planin Zhvillimor Komunalë (PZHK-lë) 2016-2024.

Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka hartuar:

**-Raportin e Vlerësimit Vullnetar Lokal** në bashkëpunim me UN Habitat si dhe

**-Planin Lokal të Veprimit në Mjedisit** së bashku me ekipin komunal.

-Vendim për përcaktimin e Lokacionit të Tregut

-Vendim për lirim nga taksa administrative për shfrytëzuesit e hapësirave publike.

Buxheti i planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese:

Deri më 31.12.2022 janë realizuar të hyrat buxhetore në vlerë prej **566,618.26 Euro** apo 247.13% nga të hyrat e planifikuara.

## Sektori i Urbanizimit

### Lejet ndërtimore:

- Vendime për Leje Ndërtimore - /10
- Vendim për Leje për shtrirjen e kablove të internetit-1
- Vendim për Leje për punë të KEDS- 2
- Refuzime për Leje Ndërtimore / 5
- Leje Rrërimi / 11
- Kërkesa të ndryshme – 409

Ju janë aprovuar kërkesat kompanive si KEDS, dhe operatoreve të internetit për shtrirjen e rrjetit nëntokësor dhe vendosjen e ormanëve MDF etj

## Sektori për planifikim urban

Gjatë periudhës një vjeçare është bërë sistematizimi i lendeve të ndryshme, koordinimi profesional dhe ligjor brenda drejtorisë, zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal, kontrollimi i rregullt i projekteve kapitale, zgjidhje dhe përgjigje të kërkesave të qytetarëve, përgatitja e projekteve konkurruese ideore, vizitat e punimeve në teren-mbikëqyrja e projekteve , monitorimi dhe aprovimi për Kushte dhe leje Ndërtimore, pranime teknike të disa projekteve, mbajtja e disa seminareve të organizuara nga organizata të ndryshme, takimet me grupet punuese për Hartimin e Raportit të Vlerësimit Vullnetar Lokal.

### Kushte ndërtimore:

- Vendime për caktimin e Kushteve Ndërtimore- 3
- Në Procedurë për kushte ndërtimore / 13
- Të hedhura poshtë/ 15
- Informim nga Plani / 23

## Sektori për mbrojtje të mjedisit

Drejtoria ballafaqohet me një numër mjaft të vogël të stafit e cila e bënë të pamundur zbatimin sa më efikas të detyrave dhe përgjegjësive përkatësisht në sektorin e mbrojtjes së mjedisit ku jemi vetëm me një zyrtar të vetëm.

Në respektim të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Udhëzimit Administrativ për dhënien e Lejeve Mjedisore Komonale kemi lëshuar me kërkesën e palëve kemi shqyrtuar 5 kërkesa për Leje Mjedisore Komonale .

## Sektori i legalizimit

Procesi i legalizimit ka filluar më 15 korrik 2019, pas miratimit të pesë (5) udhëzimeve administrative të legalizimit të ndërtimeve pa leje. Me rifillimin e këtij procesi, ky sektor ka pranuar numër të madh të palëve të interesuara për vazhdimin e shqyrtimit të lëndëve, si dhe aplikimeve të reja të ndërtimeve pa leje.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë pranuar gjithsejtë **487** kërkesa, si në vijim: .

- Vendime për Legalizimin e objekteve/ 45

- **Vendim për listë të pritjes/ 3**

Sfidë kryesore mungesa e stafit në këtë sektor

#### **Sistemi i Adresave-**

Në respektim të Ligjit për sistemin e Adresave dhe Udhëzimeve Administrative të gjitha palët që kanë aplikuar për Leje Ndërtimore sipas Ligjit janë regjistruar edhe në Sistemin e Adresave ARIS.

Pas rishqyrtimit të kërkesave nga komisioni tabelat në teren janë të harmonizuar me Sistemin e Arisit.

Në Sistemin e Arisit kemi të regjistruara gjithsej: Rrugë 1420, Hyrje 19738

Gjithsej kontrata për dhënien në shfrytëzim të hapësirave publike /15

#### **ADMINISTRATA**

Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar dhe iu është dhënë përgjigje të gjitha kërkesave të palëve brenda afateve të përcaktuara.

Per herë të parë në nivel vendi është lansuar shërbimi i veçantë për bashkëatdhetarë gjatë muajve të verës, me ç'rast kemi caktuar 3 sportele të veçanta vetëm për bashkëatdhetarët me qëllim të ofrimit të shërbimit sa më cilësor dhe më të shpejtë, poashtu me vendim të kryetarit të komunës Zyra e Gjendjes Civile ka filluar që të punojë edhe të shtunave prej orës 10:00 deri në ora 14:00 .

Janë bërë dhe shumë investime kapitale të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e kushteve të punës për stafin, të cilat po i renditi më poshtë:

Rregullimi i bodrumit të objektit të komunës i cili ka qenë në gjendje të rëndë nga myky dhe lagështia, ku do ta kemi deponë dhe arkivin komunal.

Rregullimi i ngrohjes qendrore, është bërë ndërrimi i chillerëve dhe pompave, për të vazhduar me rregullimin dhe ndrrimin e fancoilëve që janë jashtë funksionit këtë vit.

Është bërë rregullimi i gjeneratorit, Ndërtimi i sallës në katin e tretë në objektin e komunës, Rregullimi i nyjeve sanitare në tualete, furnizimi me kompjuterë për sallën e intervistimit.

#### **Zyra e Gjendjes Civile**

Gjate kësaj periudhe janë shqyrtuar dhe ju është dhënë përgjigje të gjitha kërkesave të palëve për të cilat parashihet afati me i shkurtër 1-7 ditë, ndërsa për kërkesat për të cilat parashihet afat me i gjate deri 45 ditë për përgjigje në kërkesë pas shqyrtimit në komisionin përkatës dhe pas aprovimit dhe shqyrtimit nga Agjensioni i Regjistrimit Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të brendshme janë përfunduar brenda afateve që parashihen në ligjet pozitive të Republikës së Kosovës.

Kemi vazhduar bashkëpunimin me spitalin e qytetit për raportimin e të gjitha fakteve të lindjes me qëllim të regjistrimit të fëmijëve brenda afatit ligjor.

Zyra e Gjendjes Civile ka bashkëpunuar me të gjitha institucionet që kanë interes dhe nevojë për shërbime nga kjo zyrë dhe në vazhden e këtij bashkëpunimi kemi pasur shumë takime, konferenca dhe trajnime me organizatat vendore dhe ndërkombëtare.

Në vazhdimësi jemi duke bashkëpunuar ngushte me Gjykatat e Kosovës, Entin e sigurimeve pensional të Kosovës dhe të shteteve të huaja dhe në çdo kërkesë i përgjigjemi në kohe, brenda ditës ose sipas afateve që i cakton gjykata, ngase kërkesat e gjykatës janë gjithmonë me urgjencë dhe si të tilla edhe i trajtojmë.

#### **Objektivat e zyrës së gjendjes civile kanë qenë:**

1. Ngritja e efikasitetit dhe efektitetit gjatë përditësimit të shënimeve dhe të dhënave personale të qytetarëve në Regjistrin Qendror Elektronik të gjendjes Civile dhe administrimi i regjistrave themeltar fizik.
2. Shqyrtimi i kërkesave në mënyrë të drejtë dhe nxjerrja e vendimeve për korrigjimin, ndërrimin dhe regjistrimin me vonesë të fakteve të lindjes dhe fakteve të vdekjes.
3. Skanimi dhe digjitalizimi i të gjitha dosjeve me rastin e regjistrimit të fakteve të lindurve dhe të të vdekurve në regjistrat themeltar dhe në regjistrin qendror të gjendjes civile, shtypja dhe mbajtja e akteve në mënyrë korrekte dhe cilësore duke krijuar dosje për së cilën rast dhe arkivimi i tyre.
4. Skanimi dhe digjitalizimi i të gjitha dosjeve me rastin e regjistrimit të martesave brenda orarit të punës dhe regjistrimi i martesave jashtë selisë së komunës dhe jashtë orarit të punës, duke i shtypur dhe mbajtur aktet në mënyrë korrekte, cilësore dhe duke krijuar dosje për së cilën rast.
5. Azhurnimi i të gjitha kërkesave në intranet duke ju dhënë përgjigje dhe zgjidhje në mënyrë efektive dhe pa gabime.

Numri i dokumenteve të lëshuara:

<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Lëshuara</b>
1.	Ekstrakt i lindjes	33996
2.	Certifikata të lindjes	14772
3.	Certifikata të martesës	8793
4.	Certifikata të vdekjes	2966
5.	Certifikata të Statusit martesor	1137
6.	Certifikata të shtetësisë	393
7.	Certifikata familjare	9113
8.	Certifikata të vendbanimit	3661
9.	Vërtetim nga arkivi	757
10.	Dëshmi e vdekjes	259
11.	Lajmërim dhe Ç'lajmërim i Vendbanimit	235
12.	Vendime te ndryshme	79
13.	Aplikimi për humbe të shtetësisë me lirim	129
14.	Aplikimi për natyralizim	50
15.	Deklarata për mbajtje	25
16.	Vendime për ndërrimin e emrit personal	17
<b>Gjithsej</b>		<b>76382</b>



### Regjistrime në Regjistrat e Gjendjes civile

1.	Regjistrime të lindjes	269
2.	Martesa	779
3.	Regjistrime të vdekjes	353
4.	Regjistrime të Shtetësisë	9
5.	Regjistrime të lindjes jashtë shtetit	251
6.	Regjistrime të martesës jashtë shtetit	68
7.	Regjistrime të vdekjes jashtë shtetit	54
9.	Shkurorëzime	134
Gjithsejtë regjistrime të bëra		<b>1917</b>

Ne këtë periudhë janë verifikuar **800** qytetarë në sistemin e ri të gjendjes civile, ndërsa që nga fillimi i sistemit të ri janë të verifikuar apo të regjistruar në sistemin e gjendjes civile **101090** qytetar të komunës së Vushtrrisë.

#### Spektori për Punë të Përbashkëta dhe Teknologji Informative

Gjatë kësaj periudhe aktiviteti i Sektorit për punë të përbashkëta dhe teknologji informative ishte i përkushtuar në këto qëllime kryesore:

1. Funksionaliteti i tërë sistemit të teknologjisë informative të administratës së komunës
  2. Monitorimi dhe mirëmbajtja e teknologjisë për të siguruar qasje maksimale;
  3. Integriteti dhe ruajtja e të dhënave;
  4. Mbështetja lidhur me përdorimin dhe shfrytëzimin e resurseve të TI;
- Ky sektor ka nën mbikëqyrje objektet sa i përket rrjetit kompjuterik:

1. Objekti kryesor i komunës;
2. Aneks objekti (Drejtoria për kadastër)
3. Shtëpia e kulturës;
4. Qendra për punë sociale;
5. Qendrën Rinore ku është i vendosur Sektor i Rinisë;
6. Si dhe tri objektet e QKMF që janë të lidhur në rrjetin qeveritar nga objekti i Komunës.

Gjatë vitit 2022, Sektor i punë të përbashkëta dhe teknologji informative ka kryer këto punë dhe ka ofruar këto shërbime:

Formatizime, instalime të aplikacioneve apo softuerëve të ndryshëm apo zgjidhja e probleme softuerike.	171
Mbështetje për personel në shfrytëzimin e resurseve të teknologjisë informative.	177
Zgjidhja e problemeve dhe defekteve të ndryshme teknike nga fusha e TI	9
Postimi në ueb faqe dhe mirëmbajtja e ueb faqes zyrtare	28
Lëndët e proceduara nga zyrtari i pranimit (logjistikës) për pagesë për shërbime,	103

mirëmbajtje, pagesat e komunalive dhe të gjitha lëndët e prokurimit që janë për pagesë.	
Lekturimi i dokumenteve të ndryshme për të gjitha organet e komunës.	298
Shërbime përkthimi, përkthimi i dokumenteve apo përkthim simultantë sipas nevojës të organeve komunale	173
Riparim për mirëmbajtje teknike të objektit	463

#### Qendra e Shërbimeve të Qytetarëve në Komunë

Qendra e shërbimeve me qytetare në komune gjatë kësaj periudhe ka qenë në shërbim të qytetarëve të Vushtrrisë, duke iu dhënë informacionet e duhura mbi kërkesat e tyre, duke iu ndihmuar në përpilimin e kërkesave dhe duke ju percjellur përgjigjet në kërkesa nga të gjitha drejtoritë.

Përveç aktiviteteve dhe detyrave të përditshme zyrtarët e qendrës së shërbimeve të qytetarëve kanë qenë të angazhuar edhe në punë të tjera shtesë sipas kërkesës së eprorëve të tyre siç janë, menaxherë të kontratave, komisione për vlerësim, komisione për pranim dhe në komisione të tjera sipas nevojave zyrtare.

Në kuadër të organeve të administratës janë paraqitur gjithsej 65 177 kërkesa, prej të cilave janë:

<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Nr. Kërkesave</b>
1	Drejtoria për Administratë	40.795
2	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	9221
3	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	6978
4	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural	1358
5	Drejtoria për Shërbime Publike	917
6	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	1796
7	Drejtoria për Arsim	577
8	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit	1072
9	Drejtoria për Inspeksion	533
10	Personeli	1088
11	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	219
12	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	274
13	Zyra Ligjore	36
14	Kryetari i Komunës	230
15	Drejtoria e Prokurimit	26
16	Kuvendi i Komunës	41
17	Zyra Lokale e Komuniteteve	9

18	Njësia e Auditimit të Brendshëm	7
20	Zyra për Integritet Evropian	1
Totali		65 177

### Qendra e Thirrjeve

Numri i telefonatave gjatë kësaj periudhe ka qenë 363 ku qytetaret kane marre informacionet e duhura drejtëpërdrejtë nga telefonatat.

### SHERBIMET PUBLIKE

Drejtoria për Shërbime Publike ka bërë përpjekje për të ofruar shërbime sa më cilësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë.

#### Furnizimi me ujë

Gjatë vitit raportues kemi qenë të orientuar në kyçjen e të gjitha ekonomive familjare në rrjetin e ujësjellësit në të gjitha fshatrat e komunës, projekt ky i kontraktuar dhe në implementim e sipër. Në këtë projekt do të përfshihen rreth 9000 familje. Gjithashtu kemi qenë të orientuar në krijimin e TASK FORCES për eliminimin e keqpërdorimit të ujit të pijes në mënyrë që të kemi furnizim sa më të rregullt me ujë.

#### Largimi i ujërave të zeza

Në infrastrukturën e rrjetit të kanalizimit po ashtu janë bërë investime të shumta sidomos në shtrirjen e rrjetit primar kryesisht për gjatë lumenjve në një numër të konsiderueshëm të fshatrave. Gjatë vitit 2022 kanë qenë të planifikuara 3 kontrata dhe janë realizuar në tërësi projektet në gjatësinë L=9220 m prej të cilave në: fshatin Pantinë në gjatësinë L=2056 m, fsh. Gllavotin L=318 m, Shtitaricë L=980 m, Pestovë L=540 m Vërnice L=1370 m, Bivolak L=350 m, Stanoc L=330 m dhe Bukosh L=400 m. Gjithashtu është realizuar kontrata për ndërtimin e kanalizimit në fshatin Prelluzhë në gjatësinë L=855 m.

#### Largimi i ujërave atmosferike

Gjatë kësaj periudhe është bërë pastrimi i ujëmbledhëseve të prrockave dhe rrjedhave të ujit në qytet, përmes kontratës me Ndërmarrjen UNITETI.

#### Menaxhimi i Mbeturinave

Në fushën e menaxhimit të mbeturinave, Drejtoria për Shërbime Publike, me qëllim të krijimit të një ambienti të pastër, ka bërë rishikimin e planit pesëvjeçar për menaxhimin e mbeturinave brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë 2022-2026, i cili plan është miratuar në seancën e muajit shkurt të këtij viti. Si rezultat i këtyre angazhimeve, Komuna e Vushtrrisë është duke bërë ofrimin e shërbimit për të gjitha vendbanimet e komunës. Gjithashtu është duke u bërë grumbullimi i ndarë i mbeturinave të rreth 1500 ekonomive familjare, të cilat janë duke u paketuar në qendrën për paketim në Bukosh. Në garat për “Mjedis të Pastër” Komuna e Vushtrrisë nga viti 2016 i ka plotësuar kriteret e qasjes ndaj fondeve të Qeverisë Gjermane dhe Bashkimit Evropian dhe ka përfituar mjete të konsiderueshme nga GIZ-ja të cilat janë konvertuar në dy kompaktor 8 m<sup>3</sup> dhe një kompaktor 16 m<sup>3</sup> me të cilët jemi furnizuar me datën 23.06.2022. Po ashtu është bërë eliminimi i qëndrueshëm i deponive ilegale si deponia në fshatin Bajskë dhe aktualisht i kemi vetëm gjashtë deponi të tilla. Si rezultat i këtij angazhimi ndërmarrjes „UNITETI” i është siguruar një stabilitet financiar dhe kemi arritur që në masë të madhe ta përmirësojmë gjendjen e ambientit.

Tashmë shërbimet bazike të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve konsiderohen të përmbushura si rezultat i implementimit të plotë të Planit Operativ të ndërmarrjes.

Pas përmbylljes së proceseve për shërbimet bazike, janë krijuar mundësitë për fillimin e procesit të ndarjes së mbeturinave në burim.

Edhe pse jemi ballafaquar me problemet e shkaktuara nga ngritjet enorme të qmimeve, kemi arritur që të bëjmë inkasimin e mjeteve në vlerën 438,981.35 € si dhe kemi bërë filtrimin e listave duke implementuar Vendimin e Kuvendit të Komunës së Vushtrisë për lirim nga pagesa të rasteve sociale për periudhën Janar-Dhjetor 2022.

Është ky viti i dytë prej themelimit të Ndërmarrjes Lokale „Përparimi”, përmes së cilës janë ofruar shërbimet e sigurimit dhe pastrimit të objekteve si dhe është bërë mbjellja e rreth 25 000 luleve dekorative si dhe mirëmbajtja e hapësirave publike.

Gjithashtu përmes Ndërmarrjes komunale „Përparimi” është bërë mirëmbajtja e të gjitha hapësirave publike. Kjo praktikë e mirëmbajtjes së hapësirave publike në qytet është treguar mjaft e suksesshme pasi që janë kursyer mjete të konsiderueshme financiare të buxhetit të komunës si dhe është bërë punë më e madhe në terren. Gjatë kësaj periudhe është bërë hartimi dhe dorëzimi në AMM Raporti për menaxhimin e mbeturinave për vitin 2021 dhe gjithashtu është hartuar dhe dorëzuar në MAPL Raporti i Sistemit për Menaxhim të Performancës në ofrimin e shërbimeve komunale për vitin 2021.

Në fushën e **mirëmbajtjes së gjelbërimit** me sukses janë realizuar projektet e planifikuara, si:

- Furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ;
- Plani për pastrimin, mirëmbajtjen dhe kultivimin e parqeve të qytetit;
- Plani i ruajtjes dhe mirëmbajtjes së rrethojës, inventarit, gjelbërimit dhe drunjve në parqe;
- Plani i mirëmbajtjes së stazave dhe rrugicave në parqe;
- Është punuar edhe në planin e mirëmbajtjes së varrezave, në varreza të dëshmorëve, martirëve dhe atyre të qytetit.

#### Ndriçimi publik

Ka vazhduar zgjerimi i rrjetit të ndriçimit të rrugëve në qytet dhe në fshatra sipas Kontratës dy vjeçare. Kemi bërë ndriçimin e disa rrugëve në gjatësinë **6813 m** në vlerën prej **2,788.00 €**.

Po ashtu është zbatuar kontrata për mirëmbajtje të ndriçimit publik në qytet dhe fshatra për vitin 2022.

#### Komunikacion

Në fushën e trafikut, është menaxhuar kontrata për shërbimet e transportit me auto merimangë, janë nxjerrë vendime për bllokim të shiritave rrugor dhe vendime për shfrytëzim të parkingjeve nga operatorët e transportit të udhëtarëve me Radio Taksi, vendime për ndaljen e mjeteve motorike për ngarkim shkarkim.

Është bërë sinjalizimi horizontal dhe vertikal i disa rrugëve brenda territorit të komunës. Po ashtu janë menaxhuar kontratat për mirëmbajtje dhe rikonstruim të rrugëve të asfaltuara, mirëmbajtje të rrugëve të rendit të IV-të dhe kontrata për mirëmbajtje dimërore të rrugëve lokale.

Në fushën e transportit publik ka vazhduar mbajtja e rendit të udhëtimit nga Operatorët Ekonomik të cilët mbulojnë 54 vendbanime.

#### Parkingjet publike

Hapësira për parkingje brenda territorit të Komunës së Vushtrisë të cilat janë në shërbim të qytetarëve janë 29, me gjithsej 1198 vend parkingje prej të cilave 22 hapësira posedojnë vende të rezervuara për persona me nevoja të veçanta. Ndërsa lokacioni i rezervuar për parkimin e mjeteve motorike TAKSI është 59.

#### ARSIMI

DKA në Vushtri ka menaxhuar mbarëvajtjen e procesit mësimor gjithnjë sipas kalendarit të vitit shkollor. Në këtë periudhë u krijuan vështirësi për mësimin e rregullt pas gjendjes së pandemisë, megjithatë është punuar me të gjitha skenarët e MASHTI-tit, për mos ndërprerjen e mësimin. Viti shkollor 2021/22 ka filluar me 1 shtator 2021 dhe ka përfunduar me 31 gusht 2022.

Numri i nxënësve në nivele për vitin shkollor 2021/22:

Niveli 0: 1020 nx.

Niveli 1: (1-5) 5095 nx.  
Niveli 2: (6-9) 4105 nx.  
Niveli 3: ( 10-12) 2627 nx.  
Gj. 13178 nx.

Numri i nxënësve në nivele për vitin shkollor 2022/23:

Niveli 0: 1018 nx.  
Niveli 1: (1-5) 5243 nx.  
Niveli 2: (6-9) 4062 nx.  
Niveli 3: ( 10-12) 2828 nx.  
Gj; 13151 nx.

### Zhvillimet, aktivitetet dhe të arriturat

- Janë zhvilluar monitorime në të gjitha shkollat e Komunës së Vushtrrisë, e që në objektiv kryesor kishin fushën e menaxhimit dhe qeverisjes së shkollës në funksion të sigurimit të cilësisë;
- Ju është vlerësuar përforma 17 drejtorëve të shkollave;
- Shkollat kanë bërë vlerësimin e brendshëm për sigurim të cilësisë. Shkalla e performancës; performancë e mirë;
- Është hap objekti i ri i shkollës së muzikës;
- Furnizim me mjete didaktike për nxënësit e komuniteteve;
- Transporti i nxënësve, 35 relacione;
- Përkrahja e fëmijëve me nevoja të veçanta, me vlerë 18,300.00€ për 44 nxënës;
- Janë furnizuar të gjitha shkollat me material anti-covid;
- Në bashkëpunim me UN-Habitat -20 nxënës nga kl.11 dhe 12 të drejtimeve: Arkitekturë dhe Ndërtimtari dhe drejtimi Ekonomi, kanë qenë të angazhuar në projektin -Mbledhja e të dhënave në teren për Vlerësimin Vullnetar Lokal të Komunës së Vushtrrisë;
- Vizitë pune në QB "Xheladin Deda" Pejë, rreth nxënësve që i kemi në këtë qendër me dëmtime në të parë;
- ShFMU "Rilindja" Maxhunaj, fitoi projektin "Ngritja e kapacitetit për arsimin gjithëpërfshirës "INCLUDE" nga Bashkimi Evropian;
- Është përzgjedh SHFMU "Martirët" Reznik, klasa e VII për shkollën Dimërore të Skijimit e cila u realizua në bashkëpunim të MASHTI, MKRS, MSH, UP-FEFS (Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit në Universitetin e Prishtinës) dhe FSSHK (Federata e Sportit Shkollor i Kosovës);
- Gjithsej mjete të planifikuara për ndarjen e bursave për vitin akademik 2021/22, ishin: 28,000.00€ , në afatin e parë kanë përfituar bursë 44 studentë, ndërsa në afatin e dytë 22 studentë;
- Ekipi i EPRBM (Ekipi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrim të Nxënësve, ka kthyer 3 nxënës në shkollë.
- Janë përkrahur financiarisht 48 (katërdhjetë e tetë) prindër në mbulimin e shpenzimeve të transportit për fëmijët e tyre me nevoja të veçanta, të cilët i vijnë në mesimet në Qendrën Burimore "Xheladin Deda" në Pejë, Qendrën Burimor „Nëna Terezë” në Prizren, Qendrën Burimor „Nëna Terezë” në Mitrovicë, shoqatën DOËN(DAUNE) Syndrome Kosova-DSK –Mitrovicë, në shkollat e komunës sonë dhe të cilët kanë vizita të rregullta mjekësore
- Janë furnizuar me kiflet nxënësit nga klasa parafillor deri në klasën e V-të;
- Më datë: 18.11.2022 u mbajtë tryezë në diskutimi lidhur me temën "Së bashku kundër abuzimit të fëmijëve";
- Më datë: 18.11.2022, në Galerinë e Arteve u mbajtë ekspozita me vizatime të nxënësve "Së bashku kundër abuzimit të fëmijëve
- Më 29 nëntor 2022, nxënësja Albina Aliu nga Komuna e Vushtrrisë, pranoi "Diplomë Nderi" nga Ambasadori i Republikës së Çekisë në Kosovë, z.Pavel Bílek;

## Garat, aktivitetet dhe të arriturat

- ShMU 2- Vushtrri, zuri vendin e parë në nivel të Republikës së Kosovës, në garën e pikturës;
- Më datën: 8 shkurt 2022, u shënua "Dita Ndërkombëtare e Internetit të Sigurt" me karakter garues e edukues, ku morën pjesë 17 shkolla. Në këto gara u renditen: ShFMU "A.Z.Çajupi" Vushtrri, Vendi i parë, SHMU-2 – Vushtrri, Vendi i dytë, ShFMU "Liria" Stroc, Vendi i tretë. Nxënësit u shpërblyen më mirënjohje dhe usb-flash nga DKA- Vushtrri. Ndërsa, nga 50 libra për secilin vend u shpërblyen nga organizata "KEC", si dhe nga një libër u dhuruan për secilin nxënës nga Gjimnaz "Eqrem Çabej" Vushtrri;
- U zhvillua gara në shah për nxënësit e klasave 1-5 me bashkëpunim Innovation Akdemy, ku nxënësit u shpërblyen me nga një shah dhe nga DKA, medalje nga DKRS si bursa për kamp verorë nga Innovation Akademy. Tri vendet para me nx. femra i fitoi ShF."Mustafë Venhari", ndërsa tri vendet e para me nx. meshkuj fitoi ShF "Naim Frashëri";
- Më 8 mars 2022, u mbajtë gara në ese për nxënës nga klasa 6-9 në këto gara Vending e pari e zuri ShMU-1, Vending e dytë, ShFMU "Dëshmorët" Zhilivodë dhe vendin e tretë ShFMU "Hajrullah Shala" Akrashticë, nxënësit u shpërblyen me libra;
- ShMU 2- Vushtrri, më 30 prill 2022, mori pjesë në kuizin "Big Bang" ku fitoi në raundin e parë;
- ShMU-2- Vushtrri, në garën e diturisë "Gjeniu" mori vendin e parë në nivel republike; Kryetari i komunës z.Ferit Idrizi, 3 nxënës i shpërblej me nga 100 €;
- U mbajtë gara e diturisë për nivelin 1, klasa e pestë, morën pjesë të gjitha shkollat fillore të komunës sonë: Vendi i parë: ShF" Ali Kelmendi" Vushtrri; Vendi i dytë: SHF" Mustafë Venhari " Vushtrri dhe Vendi i tretë: SHFMU" 28 Nëntori" Vërnice. Me vendim të kryetarit të komunës z. Ferit Idrizi, u shpërblyen nxënësit që morën pjesë në garë,
- U mbajtë gara diturisë, për nivelin 2, klasa 9, morën pjesë të gjitha shkollat e komunës sonë : Vendi i parë: SHFMU "A.Z.Çajupi" Vushtrri, Vendi i dytë : SHFMU "Lumni Surdulli" Samadrexhë, Vendi i tretë: SHFMU " Bahri Kuqi" Vushtrri; me vendim të kryetarit të komunës z.Ferit Idrizi, u shpërblyen 4 nxënës të tri vendeve:
- U mbajtë gara diturisë, për nivelin 3, klasa 12, morën pjesë të gjitha klasat e XII-ta të drejtimit të shkencave të natyrës të Gjimnazit "Eqrem Çabej" Vushtrri, dhe me vendim të kryetarit të komunës z.Ferit Idrizi, u shpërblyen 8 të cilët arritën rezultate të larta.
- Më datë: 20.05.2022 në KLAN Arena, në Prishtinë, nxënësit e SHFMU "Liria" në Stroc, bashkë me përfaqësuesit e shkollave tjera morën pjesë në ngjarjen përmblylëse të Programit "Shkollat e Shekullit 21", organizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës dhe British Council në Kosovë. Në ngjarjen "Sfida Kombëtare e Kodimit 2022" garuan 20 shkollat finaliste nga e gjithë Kosova, ku kishin aplikuar 600 shkolla. Komuna e Vushtrrisë u përfaqësua nga nxënësit e tri shkollave: SHFMU "Liria" Stroc, SHMU-1-Vushtrri, SHFMU "Andon Z.Çajupi", Vushtrri. Në këtë sfidë vendin e parë në Republikën e Kosovës e zuri SHFMU "Liria", në Stroc; ku 2 nxënës me vendim të kryetarit të komunës z.Ferit Idrizi u shpërblyen me nga 100€;
- Nxënësja e grupit letrar "Gjimnazisti", Flutura Hyseni, ka zënë Vending e dytë në poezi, në konkursin letrar "Ditët e shqipes", organizuar nën patronatin e Presidentes së Republikës së Kosovës dhe shoqatës "Agim Ramadani";
- Është mbajtë testi PISA në Vushtrri ku morën pjesë 13 shkolla: GJIM. "Eqrem Çabej", ShFMU "Azem Bejta", ShFMU-" Hajrullah Shala", ShFMU" Liria", SHFMU"GJ.K.Skënderbeu", ShFMU"Jusuf Gërvalla",ShFMU-Lumadh, ShFMU"Rilindja",ShMP "Bahri Haxha", ShMT."Lutfi Musiqi", ShMT."Lutfi Musiqi", ShMT."Lutfi Musiqi", Vician Med, ShMU-1, ShMU-2. Gjithsej 113 nx.
- Garat e fizikës : më 12 shkurt 2022, në Gjimnazin "Eqrem Çabej"-Vushtrri, janë mbajtë garat e Fizikanëve të Rinj në nivel komune, për nx. e kl. 9,10,11 dhe 12. Drejtoria Komunale e Arsimit i ka shpërblyer nxënësit që kanë arritur rezultate më të mira, me mirënjohje dhe mjete materiale. Në nivel Republikan nxënësja Zana Ademi, nxënësja në Gjimnazit "Eqrem Çabej"-Vushtrri, ka zënë vendin e 5 (pestë), kurse nxënësja Atdhetare Kameri, nxënësja në ShFMU"Adem Voca"-Sumë/K.Vushtrri, ka zënë

vendin e 9(nëntë). Drejtoria Komunale e Arsimit për këtë garë, i ka shpërblyer të dy nxënëset, me mirënjohje dhe mjete materiale në shumën 250.00 €.

- Garat e matematikes: më 19 shkurt 2022, në SHMU-2, në Vushtrri, janë mbajtur garat e OMK në nivel komune, për nx. e kl. 9,10,11 dhe 12. Drejtoria Komunale e Arsimit i ka shpërblyer nxënësit që kanë arritur rezultate më të mira, me mirënjohje dhe mjete materiale.
  - Më 6 mars 2022, kemi marrë pjesë në garat Republikane të OMK që u mbajtën në Gjimnazin e Specializuar të Matematikës në Prishtinë. Në këtë garë kemi marrë pjesë me 5 (pesë) nxënës nga kl.9, 10, 11 dhe 12 që janë përzgjedhur nga gara komunale e mbajtur më 19.02.2022. Për këtë garë janë shpërblyer 12 nxënës në shumën prej 1,480.00 €.
- Gjithsej për garat në Fizikë dhe Matematikë, janë shpërblyer 21 nxënës në shumën 2,840.00 €.

#### Donacionet

- ShFMU “ Jusuf Gërvalla” Dumnicë e Poshtëm u rinovua komplet nga “ALBERTI” me pronar Skënder Bajrami, me vlerë 200, 000.00€;
- ShFMU “ Emin Duraku” Novolan, pranoi donacion nga bashkëvendësi i tyre z. ABDULLAH KOVAÇI me 5 TV-SMART në vlerë 3000€;
- ShFMU “ Rexhep Musa” Ceceli, ka pranuar nga IADK IADK, me seli ne Nedakoc : 4 projektorë; si dhe nga Kompania "Emona Center", në Vushtrri: 4 kompjuterë;
- ShFMU “Mustafë Shyti” Oshlan është pajisur me 10 qante për nxënës nga ETC;
- ShFMU” Rilindja ” Maxhunaj është pajisur me një projektor nga MASHTI për raportimin e rasteve të dhunës në SMIA;
- Të gjitha ShFMU janë pajisur me mikro bit;
- ShFMU “Migjeni” Stanofc është pajisur nga KEC me 50 tituj libra, për bibliotekën e shkollës;
- IP “Foleja” është pajisur më;-Smard bord për tri çerdhet me 3 projektor, 3 televizor dhe lodra për oborr,(topogan ,luhatëse, , ulëse nga druri, kali lëvizës, shtëpizë nga materiali PCV. Ky projekt është realizuar në kuadër të projektit "Sensibilizimi i mëtejme i komuniteteve pakicë dhe shumicë në Komunën e Vushtrrisë përmes mbështetjes së shtuar socio-ekonomike" dhe është realizuar përmes financimit të përbashkët nga Fondacioni për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik “PREDA PLUS “ dhe Komunës së Vushtrrisë në vlerë prej 25.999.00 €;
- Më 15.03.2022, së bashku me KK-Komunal, ishim në SHFMU “Jusuf Gërvalla” për të përcjell dorëzimin e donacioneve nga JIC-a Japoneze dhe KK i Kosovës. Donacioni përfshinte kryesisht mjete për mbrojtje dhe ndihmë në rast rreziku për komunitetin e shumë 10,000.00 €;
- ShFMU “Liria” Strofc; përfitoi donacion nga: Forumi për Integrim Social – FIS në bashkëpunim me zyren e Presidencës së Kosovës– Donacion: ngjyra, pëlhura, brusha për ekspozit, vlera 200.00 euro , KEC - Donacion: Mbjellja e 130 pemve frutore ( 30 ari), projektor, ngjyra, pëlhura, këmbalec për piukturë, brusha, promovimi i vlerave të shkollës vlera totale 950.00 €, Trajnim dhe materiale USAID – Vetëdijesimi lidhur me Bullizmin në shkollë vlera totale 500€, British Council donacion: pajisje për kodim vlera 2000 €, Trajnim nga Fatos Durmushi ( me banim në Suedi) ekspert për ligjëratën “Shëndeti mendor në jetën e përditshme” mbajtur me nxënësit e klasave të 8 dhe 9 –ta vlera e trajnimit 500.00€ . N. Përparimi donacion : Lule, vlera e tyre 200€ , Poetja vushtrriase Ermira Jusufi donacion: Libra të ndryshëm vlera e tyre 1500€;
- Gjimnazi pranoi donacion nga KEC 45 tituj librash me vlerë 135 €, 20 llaptopa në vlerë 14,000.00 €, 2 PC në vlerë 1000.00€, 10 tabletë me vlerë 2000.00 , SMART TV me vlerë 700.00 . Aset USAID ka përfituar pajisje teknologjike të përdorura në vlerë 2539.00 dollar;
- SHMU-1 pranoi donacion pajisje teknologjike nga GIZ me vlerë 2086.57 .00€;
- Më 4 tetor 2022, pranuar donacion nga Raiffeisen- bankë për shkollat : SHFMU "Adem Voca" Pasomë: 51 çanta, SHFMU "Azem Bejta" Dubofc: 65 çanta, SHFMU "Mustafë Shyti" Oshlan: 75 çanta, SHFMU "Hajruallah Shala" Akrashticë: 65 çanta, SHFMU "Dëshmorët" Zhilivodë: 30 çanta, gjithsej 259 çanta;
- Nuredin Gubetini veteran i Arsimit dha donacionin e djalit të tij Shqiptar Gubetini nga Gjermania 2 smart tv për Shkollën E Muzikes Vushtrri;

- Bashkëatdhetarët tanë në Amerikë z.Afrim Shabanin si dhe përfaqësuesin e grupit të donatorëve, Z. Muhamed Beluli; dhe, ndërmjetësues, Z. Artan Hasani dhe Znj. Arbenita , për kontributin e tyre në pasurimin e nototekës së Shkollës e Muzikës Vushtrri me literaturë të ndryshme muzikore për shkollën e muzikës.

#### Trajnimet

- SHFMU “Liria’ Strofc: Trajnim për mësimdhënëset 6-9 “ Mësimi i mendimit kritik dhe zgjedhës së problemeve” ;
- Janë trajnuar 66 mësimdhënës për KK;
- Organizimi i trajnimit për edukatore përmes UNICEFIT OJQ “Koralet” në fakultetin e Edukimit në Mitrovicë;
- Trajnime për edukatore, përgatitja e programit para fillor për përkrahjeje dhe zhvillimin e potencialit të fëmijëve përmes lojës dhe kreativitet nga CARITASI zvicran;
- Më datë: 18, 19 shtator u mbajtë, trajnimi i drejtorëve në programin "Shkollat e Shekullit 21" organizuar nga British Council lidhur me micro Trajnimi i edukatoreve të klasës përgatitore përmes projektit Shpresa të Caritasit Zvicran;
- Trajnim me dt. 11,12 dhe 13 nëntor përmes UNICEF, OJQ”Koralet;
- Në Qendrën për Ngritje Profesionale në Vushtrri, në kuadër të projektit nga Qendra për Arsim e Kosovës -KEC; "Së bashku kundër Abuzimit të Fëmijës". Gjatë dy ditëve të vikendit me 10 dhe 11 dhjetor, u mbajt trajnimi me temë: “Ndërmjetësimi mes bashkëmoshatarëve”, për dhjetë shkollat e Komunës së Vushtrrisë.
- Trajnim: Edukimi për Qytetari AKTIVE dhe të Drejtat e Njeriut dt.08-10 tetor 2022 (KEC);

#### Garat sportive - Arritje sportive jashtë vendit:

- Me datën: 15.05.2022, dy nxënës, të SHMP’’ Bahri Haxha’’ Vushtrri, kanë qëndruar në Normandi të Francës në sportin e ping-pongut ku Shkolla e Mesme Profesionale "Bahri Haxha" Vushtrri ka përfaqësuar Kosovën në konkurrencën e meshkujve. Në këto gara janë përfshirë 14 sporte ku morën pjesë rreth 4000 nxënës nga e gjithë bota;
- Më datë 12 qershor deri më 16 qershor 2022, u mbajtën garat në hendboll në nivel Ballkanik në Ohër të Maqedonisë së Veriut , ekipi vajzave të Gjimmazit “Eqrem Çabej” Vushtrri , u renditën në vendin e tretë

#### **VII.2. Arritje sportive në nivel komunal dhe në nivel vendi:**

Emri i shkollës	Sporti	Gj.	Vendi që kanë fituar	Data:	Nr. nx.	Nr. mësimdhënës. të angazhuar
ShMU 2	Basketboll	M	Vendi i parë në nivel Komunal Pjesëmarrës në nivel Republike	22.11.2021 01.12.2021	12	2
ShMU 1	Basketboll	F	Vendi i parë në nivel Komunal Pjesëmarrës në nivel Republike	22.11.2021 01.12.2021	12	2
“Lutfi Musiqi”	Basketboll	M	Vendi i parë në nivel Komunal Vendi i dytë në nivel Republike	22.11.2021 02.12.2021	12	2



“Eqrem Çabej”	Basketboll	F	Vendi i parë në nivel Komunal Vendi i dytë në nivel Republike	22.11.2021 02.12.2021	12	2
ShMU 2	Shah	F/M	Vendi i parë në nivel Komunal	08.12.2021	6	2
ShMU 2	Ping pong	M	Vendi i parë në nivel Komunal Pjesëmarrës në nivel Republike	25.01.2022 10.02.2022	5	2
ShMU 2	Ping pong	F	Vendi i parë në nivel Komunal	25.01.2022	5	2
“Bahri Haxha”	Ping pong	M	Vendi i parë në nivel Komunal Vendi i dytë në nivel Republike	25.01.2022 10.02.2022	3	2
“Bahri Haxha”	Ping pong	F	Vendi i parë në nivel Komunal	25.01.2022	3	2
ShMU 2	Hendboll	M	Vendi i parë në nivel Komunal Vendi i dytë në nivel Republike	09.03.2022 31.03.2022	12	3
“Lumni Surdulli”	Hendboll	F	Vendi i parë në nivel Komunal Vendi i parë në nivel Republike	09.03.2022 31.03.2022	12	1
“Eqrem Çabej”	Hendboll	F	Vendi i parë në nivel Komunal Vendi i parë në nivel Republike	09.03.2022 31.03.2022	12	2
Shmu “2”	Futsall	M	Vendi i parë në nivel Komunal Vendi i parë në nivel Republike	29.03.2022 29.04.2022	10	2
“Liria”	Futsall	F	Vendi i parë në nivel Komunal Pjesëmarrës në nivel Republike	29.03.2022 29.04.2022	10	1
“Eqrem Çabej”	Futsall	M	Vendi i parë në nivel Komunal Vendi i dytë në nivel Republike	29.03.2022 29.04.2022	10	2
“Eqrem Çabej”	Futsall	F	Vendi i parë në nivel Komunal	29.03.2022	10	2
“Bahri Haxha”	Volejboll	M	Vendi i parë në nivel Komunal	05.05.2022	12	2
“Eqrem	Volejboll	F	Vendi i parë në nivel	05.05.2022	12	2

Çabej”			Komunal			
“Rexhep Musa”	Volejboll	M	Vendi i parë në nivel Komunal	20.05.2022	12	1
“Rilindja”	Volejboll	F	Vendi i parë në nivel Komunal Pjesëmarrës në nivel Republike	20.05.2022 26.05.2022	12	2

Më 13 dhjetor, u mbajtën garat komunale në shah: Vendi i parë: Shmu "2" Vendi i dytë: Shfmu "Liria" Strofc, ndërsa garat regjionale u mbajtën më 16 dhjetor, në Vushtrri në Shkollën e Mesme të Ulët " 2 " Vushtrri, të organizuara nga Federata e sportit shkollor të Kosovës ku në këto gara morën pjesë shkollat nga Komuna e Mitrovicës, Skenderajt dhe të Vushtrrisë. ShMU " 2 "- Vushtrri vendi i dytë;

Ndërsa, 2 ekipe nga ShMU-2 dhe ShMU 1 janë pjesëmarrëse NBA Kosova (ligë e basketbollit) në kategorinë mix (femra dhe meshkuj) me nxënës të klasave të shtata (nën moshën 12 vjeç) me nga 12 lojtarë (gjithsej 24 nx. dhe 2 mësimitdhënës).

#### Rezultatet e testit të arritshmërisë

Viti	2019	2021	2022
%	49.43	49.78	44.59

Tri shkollat të cilat u renditën më përqindje më të lartë në testin e arritshmërisë:

ShFMU” Emin Duraku” Novolan: 60.45%

ShFMU- Nedakoc: 58.84%

ShFMU “Mustafë Shyti” Oshlan: 55.50%

#### Testi i maturës

Gjimnazi “ Eqrem Çabej” Vushtrri :

Viti	2020	2021	2022
%	99.20%	99.00%	99.60%

#### SHMP “Bahri Haxha” Vushtrri

Viti	2020	2021	2022
%	39.53%	48.38%	72,87%

#### SHMT “ Lutfi Musiqi” Vushtrri

Viti	2020	2021	2022
%	40.70%	31.00%	65.04%

Suksesi në fund të vitit shkollor 2021/22, Klasa 1-5

Periudha e njëjtë	Suksesi i fundit të vitit shkollor 2021/22 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020/21, për klasën 1-5												
	Shkëlqyeshëm	%	Sh.mirë	%	Mirë	%	Mjaftueshëm	%	Të panotuar	%	Të pamjaftueshëm	%	Gj.
2022	3301	65.34	1057	20.92	525	10.39	162	3.21	2	0.04	5	0.10	5052
2021	3507	68.04	958	18.58	537	10.41	151	2.92	0	0	1	0.01	5154
Krahasimi		-2.70		2.34		-0.02		0.29		0.04		0.09	

Shkëlqyeshëm: ka rënie të suksesit për 2.7%  
 Shumë mirë: ka ngritje të suksesit për 2.34%  
 Mirë: ka rënie të suksesit për 0.02 %  
 Mjaftueshëm: ka ngritje të suksesit për 0.29%  
 Të pamjaftueshëm: ka ngritje të pamjaftueshmërisë për 0.09%

Suksesi kl.I-V				
Fundi i vitit shkollor/ Periudha e njëjtë	Pozitiv	%	Negativ	%
2022	5047	99.90	5	0.10
2021	5153	99.98	1	0.02
Krahasimi		-0.08		0.08

Suksesi ka rënie të kalueshmërisë për 0.08%.

Klasa 6-9

Periudha e njëjtë	Suksesi i fundit të vitit shkollor 2021/22 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020/21, për klasën kl. VI-IX												
	Shkëlqyeshëm	%	Sh. Mirë	%	Mirë	%	Mjaftueshëm	%	Të pa notuar	%	Përsëritur klasën	%	GJ
2022	1172	27.99	880	21.01	1108	26.46	1002	23.9	4	0.09	21	0.5	4187
2021	1200	28.72	932	22.31	1106	26.47	789	18.9	0		19	0.45	4177
Krahasi		-0.73		-1.3		-0.01		5.05		0.09		0.05	10

Shkëlqyeshëm: ka rënie të suksesit për 0.73 %  
 Shumë mirë: ka rënie të suksesit për 1.3%  
 Mirë: ka rënie të suksesit për 0.01 %  
 Mjaftueshëm: ka ngritje të suksesit për 5.05 %  
 Përsërisin klasën: ka ngritje të pamjaftueshmërisë për 0.05%

Suksesit kl.VI-IX				
Fundi i vitit shkollor / Periudha e njëjtë	Pozitiv	%	Negativ	%
2022	4166	99.50	21	0.50
2021	4158	99.55	19	0.45
Krahasimi		-0.05		0.05

Suksesi ka rënie të kalueshmërisë për 0.05%.

Periudha e njëjtë	Suksesi i fundit të vitit shkollor 2021/22 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020/21, për klasën 10-12												
	Shkëlqyeshëm	%	Sh. Mirë	%	Mirë	%	Mjaftueshëm	%	Të pa notuar	%	Të pamjaftueshëm	%	GJ.
2022	341	13.78	500	20.20	774	31.27	813	32.8	4	0.16	43	1.74	2475
2021	314	12.22	479	18.64	794	30.9	943	36.9	1	0.04	38	1.25	2569
Krahasimi		-3.1		-2.74		-3.4		8.2		-0.1		1.14	-121

Shkëlqyeshëm: ka rënie të suksesit për 3.1 %  
 Shumë mirë: ka rënie të suksesit për 2.74%  
 Mirë: ka rënie të suksesit për 3.4 %  
 Mjaftueshëm: ka ngritje të suksesit për 8.2 %  
 Përsërisin klasën: ka ngritje të pamjaftueshmërisë për 1.14%

Suksesit kl.X-XII				
Fundi i vitit shkollor / Periudha e njëjtë	Pozitiv	%	Negativ	%
2022	2432	98.26	43	1.74
2021	2531	98.52	38	1.48
Krahasimi		-0.26		0.26

Suksesi ka rënie të kalueshmërisë për 0.05%.

## SHENDETESI DHE PERKUJDESJE SOCIALE

DSHPS dhe menaxhmenti i QKMF-së bazuar në Strategjinë Sektoriale të KPSH në Vushtrri dhe në zbatueshmëri me planin e veprimit janë përkushtuar maksimalisht që të ofrojnë shërbime shëndetësore cilësore, ku përfshihen ato promovuese, parandaluese, diagnostikuese, trajtuese dhe paliative, duke përfshirë në procesin e përkujdesjes shëndetësore për të gjitha komunitetet që jetojnë në komunën e Vushtrrisë.

Përkujdesja shëndetësore organizohet duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e popullatës, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

QKMF-ja është përgjegjës për organizimin, implementimin e konceptit të Mjekësisë Familjare si dhe sigurimin e vazhdimësisë të përkujdesjes shëndetësore për popullatën me objektivë kryesorë, përmirësimin e shëndetit të popullatës, duke ju ofruar shërbime të qasëshme, gjithëpërfshirëse si dhe shërbime të cilësisë së lartë.

### Rrjeti shëndetësor

Aktualisht kujdesi parësor shëndetësor është i organizuar përmes institucioneve shëndetësore si në vijim:

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), 10 Qendrat të Mjekësisë Familjare (QMF), 9 Ambulanta të Mjekësisë Familjare (AMF).

Gjatë këtij viti janë shqyrtuar dhe realizuar kërkesa të ndryshme, ndër to:

1. Subvencionimi për fëmijët e porsalindur 110,040€ për 917 fëmijë;
2. Subvencionimi për shërim, 94,640€ për 423 persona që kanë kërkuar ndihmë mjekësore;
3. Pagesa për qira 19,200€ për 16 familje në nevojë;
4. Subvencionimi për OJQ-të, 27,000€ për 11 OJQ;
5. Subvencionimi për të prekurit me Covid 19 të mbetura nga viti i kaluar, janë paguar 6500€ për 65 persona;

### Bashkëpunimi me donatorë

Gjatë vitit 2022 DSHPS dhe QKMF kemi arritur bashkëpunim të shkëlqyeshëm me donator për realizimin e projekteve me bashkëfinancim si:

- Bashkëpunimi me donatorin AQH e Zvicrës, është duke vazhduar në kuadër të zhvillimit të edukimit të vazhdueshëm profesional.
- DSHPS Komuna Vushtrri dhe Islamic Relief me seli në Prishtinë kemi vazhduar projektin i cili ka pasur nismën dhe funksionalizimin në vitin 2017 në bazë të nevojave dhe kërkesave të qytetarëve në fushën e shëndetësisë për projektin e vizitave shëndetësore në shtëpi, ku kemi përmisuar dhe rritur kapacitetet për funksionalizim më të mirëfillt, për përkujdesjen ndaj qytetarëve të ofrimit të shërbimeve shëndetësore në krahasim me vitet e kaluara, duke rritur numrin e stafit profesional mjekësor të angazhuar 7 ditë të javës /13 orë, me dy epike mjekësore të përbëra nga 1 mjek dhe dy infermier, me dy vetura.  
Po ashtu bazuar në marrëveshjen kemi rritur numrin e stafit profesional 7 mjek, 14 infermier, 2 teknik laborant dhe 1 asistent stomatologu.
- Në bashkëpunim me UNICEF kemi vazhduar projektin për vizitat shtëpiak për nëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare dhe me të arriturat sipas planprogramit jemi shpërblyer me një automjet terreni për realizimin e vizitave shtëpiake. Po ashtu UNICEF dhe AMC kanë dhuruar donacion Frigorifer dhe friz për shërbimin e vaksinimit: Friza 7 dhe frigorifera 12.
- Hapja e tre puseve në QMF-1, QMF-2 dhe objektin e ri të QKMF nga donator Vakëf Isa dhe Tibet Al Osmani nga Kuëaiti.
- Furnizimi me pajisje mjekësore nga Ministria e Shëndetësisë për Sektorin e Kujdesit Urgjent në vlerë totale 16.165.00 Euro.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Ju paraqesim në formë tabelare informatën për vizitat mjekësore në QKMF, QMF dhe AMF:

Nr.	Emri i shërbimit	Totali	M	F	Sherbim	Referime	Malinje	Kronike	Te vizituar me karte
1	QKMF	70604	33700	36904	216918	9391	39	3896	470
2	Urgjenca	32356	14834	17522	177833	4130	120	5729	0
3	Laboratori	15333	6054	9279	150531	0		0	0
4	Stomatologjia	9442	4267	5175	49805	265	0	0	1149
5	RTG	5525	2555	2970	14993	0	0	0	0
6	Rtg e dhembit	31	14	17	45	0	0	0	0
7	Vaksinimi	4622	2517	2105	18404	0	0	0	4622
8	QMF-1	57743	26875	30868	162479	8350	28	3432	631
9	QMF-2	5516	2456	3060	40901	274	3	370	255
10	QMF-3	7253	3384	3869	47798	25	0	637	84
11	QMF-AMF	20834	8973	11776	183110	9546	45	2483	3108
12	V.SHTEPIAKE	5575	2682	2893	51230	14			4598
13	KshillimoreAQH	1391	642	749	10310	0	0	1301	405
	<b>Gjithsejt</b>	<b>236 225</b>	<b>108 953</b>	<b>127 272</b>	<b>1 124 357</b>	<b>31 997</b>	<b>2235</b>	<b>17 848</b>	<b>15 322</b>

Paraqesim në formë tabelare rrjetet e QMF dhe AMF, 12 mujori për vizitat mjekësore dhe shërbime 2022

	Janar -Dhjetor 2022	Totali	M	F	Shërbime tjera	Referimet	S.Malinje	S.Kronike	Vizita me karte
QMF dhe AMF	QMF Lumadh	6556	2840	3716	26745	571	2	662	755
	QMF Smrekonice	2479	1110	1369	12420	1240	1	258	220
	QMF Pantine	2679	1121	1558	9503	795	38	388	1070
	QMF Druar	1401	620	781	3405	584	0	28	12
	QMF Novolan	649	269	380	4541	193	4	136	426
	QMF Maxhunaj	3149	1247	1902	11427	796	0	380	0
	QMF Dumnice	539	182	357	3192	190	0	62	387
	AMF Samadrexhe	947	419	528	5924	288	0	339	469
	AMF Strovç	736	295	441	2241	183	0	136	4
	AMF Pasome	630	277	353	3135	7	0	18	185
	AMF Oshlan	178	90	88	1898	55	0	23	107

AMF Beçiq	355	206	149	1369	73	0	8	0
Amf Dubovc	243	175	68	925	28	0	7	0
AMF Ceceli	293	122	171	2491	29	0	38	0
Gjithsej:	20834	8973	11861	89216	5032	45	2483	3635

### Sektori i Shëndetit Publik

- Sëmundjet ngjitëse sipas IKSHPK Mitrovicë

#### 1. Numri i rasteve të sëmundjeve ngjitëse sipas komunës së Vushtrrisë, tab.2

Sëmundjet ngjitëse	Totali	Sëmundjet ngjitëse	Totali
Pneumoni	28	Hepatit acut viral A	0
SARI	1	Hepatit acut viral B	2
Diarea akute	685	Hepatit chronica	1
Variçella	57	Dushim ne Parotit epidemik	1
Dyshim ne Influecen ILI	173	Rastet e reja TBC	29
Intoxicatio alimentaris	0	Erizipella	0
Meningitis acuta	2	Uroplasma ureliticum	1
Meningitis serosa	0	Condilloma anogenitalis	1
Meningitis purolenta	0	Gonorrhoea	0
Meningoencephalitis acuta	2	Brucellozis	1
Meningoencephalitis purolenta	2	Herpes zooster	3
TBC-Meningoencephalitis	0	Ictus ixodes	1
COVID-19	3064	Vullnus morsum viperi	0

### COVID-19

Bazuar në raportin e IRSHP në Mitrovicë, komuna e Vushtrrisë ka pasur të infektuar / raportuara 3064 raste të infektuara me visursin Covid -19, kurse prej tyre zyrtarisht janë të konfirmuara 4 raste të vdekjes.

Ministria e Shëndetësisë së bashku me menaxhmentin e QKMF në Vushtri kanë përcaktuar nevojat për staf profesional mjekësor me qëllim të realizimit të planit të vaksinimit për aplikimin e vaksinave të lartpërmendura. QKMF Vushtri është furnizuar edhe me teste rapid nga Ministria e Shëndetësisë dhe bëhet testimi i pacientëve për virusin Covid-19.

Në vitin 2022 janë vaksinuar me dozë të parë 840 pacient, me dozë të dytë 1253 pacient dhe me dozë të tretë janë vaksinuar 3300 pacient, dozë të katër 20 pacient, në total janë dhënë 5413 vaksina kundër virusit COVID-19.

Në total duke u bazuar në vitin 2021 dhe 2022 janë të vaksinuar me dozë të parë 36431 qytetar, me dozë të dytë janë vaksinuar 33405 qytetar, dozë të tretë 3300 qytetar dhe doza e katër 20 qytetar, në total janë dhënë 73156 doza të vaksina kundër Covid-19.

#### Sektori i Vaksinimit dhe imunizimit :

Vaksinimi i rregullt tek fëmijët dhe të moshuarit: Shërbimi i vaksinimit gjatë kësaj periudhe ka qenë i furnizuar me vaksina mjaftueshëm dhe është kryer në bazë të planit në qytet si dhe në fshatra. Në dymbëdhjetë muajor janë vaksinuar 4622 fëmijë me vaksina të rregullta, dhe janë dhënë 14819 shërbime.

Nxënësit e klasëve të para , kanë qenë të planifikuar 988 nxenes, Janë vaksinuar 906 nxënës të pa vaksinuar 82 nxënës.

Në nxënësit e klasëve të VI- të planifikuar 950 nxënës. Janë vaksinuar 901 nxenes. Të pa vaksinuar 49 nxënës. MATURENTAT- Të planifikuar janë 765 nxënës, të vaksinuar 612, ndërsa 153 kanë refuzuar vaksinimin. Po ashtu si çdo vit për shkak të mbrojtjes së popullatës me rrezikshmëri më të lart shëndetësore janë dhënë 2577 doza të vaksinave të gripit sezonal. Vaksinimi në Vushtrri është ndër më të mirët në Kosovë dhe arrin përqindje prej 95.0 %, në realizim të planit, e që është një bazë e mirë për preventivën e sëmundjeve që më herët kanë qenë të pranishme në Kosovë e rajon. Në vitin 2022 kemi kryer vizitat sistematike për nxënësë nëpër shkolla:

#### Pasqyra e përfshirjes së nxënësve në vizita sistematike:

Pasqyra e përfshirjes së nxënësve në vizita sistematike						
SHFMU	Nxënës të planifikuar		Munguar		Vizita të realizuara	
	Nr.nxënësve	%	Nr.nxënësve	%	Nr.nxënësve	%
<b>Klasa I</b>	861	100	52	6%	809	94%
<b>Klasa V</b>	727	100	28	4%	699	96%
<b>Klasa IX</b>	981	100	33	3%	948	97%
<b>Gjithësej</b>	2569	100	113	4	2456	96%

#### Të gjeturat sipas kritereve të caktuara përqindje:

Përshkrimi	Me veçori patologjike	Pa veçori patologjike	Mungojn	Referimet
Koka dhe qafa	3%	97%		
Kafazi i krahorit	3%	97%		
Boshti kurrizor	7%	93%		
Qëndrimi I trupit	2%	98%		
Mushkëritë	1%	99%		
Zemra	1%	99%		
Ekstemitett	3%	97%		
Të pamurit	29%	71%		
Mbajn syza	5%	95%		
Të dëgjuarit	2%	98%		
Lëkura dhe mukoza	4%	96%		
Statusi psikik	1.4%	98.0%		



Referimet e mjekut familjar				23%
Higjiena orale	36.5%	63%	0.5%	
Karriesu u dhëmbëve	44%	55%	1%	
Referimet e stomatologut				23%

Njësia e SISH-it, QKMF në Vushtrri është duke funksionuar me sistemin e ri i cili është me versionin e fundit. Ministria e Shëndetësisë ka bërë shtrirjen e rrjetit për të gjitha QMF dhe AMF, po ashtu ka pajisur KPSH me pajisje kompjuterike dhe pajisje tjera të TI, është duke u punuar në vazhdimësi për implementimin e të gjitha qendrave dhe shpresojmi që gjatë vitit 2023 të funksionalizohet SISH-I në të gjitha instutucionet e KPSH. Gjatë këtij viti në SISH është punuar me vizita sistematike ku janë deponuar në databazë 2456 fletëza dhe është përgatit raporti për klasat e I, V dhe IX.

Gjatë vitit 2022 është raportuar për morbiditetin, sëmundjet malinje dhe kronike, vizitat mjekësor edhe për vaksinim COVID-19.

#### Sektori i Shëndetit Oral Preventiv

Në sektorin e shëndetit oral preventiv janë vizituar gjithsejtë 9442 pacient dhe ka dhënë **49805** shërbime. Këtu përfshihet këshilla mjekësore, nxjerrja e dhëmbëve, shërimi, bllobbimi dhe pastrimi i gurëzve në dhëmbë. Punohet nga ora 07<sup>h</sup> deri në ora 20<sup>h</sup> në QKMF dhe në QMF1, ndërsa dy herë në javë në QMF2 dhe QMF3 nga ora 07<sup>h</sup> deri ne ora 14<sup>h</sup>, QMF Lumadh dhe QMF Pantinë. Kujdestaria mbahet në QMF-1 në ditën e shtunë nga ora 07<sup>h</sup> deri ne ora 19<sup>h</sup>.

#### Shërbimi i Urgjencës

Gjatë vitit 2022 ka pas gjithsejtë **32356** pacient janë dhanë **177833** shërbime shëndetësore. Në Urgjencë shërbimet janë 24<sup>h</sup> dhe punohet cdo ditë të javës. Në këtë shërbim janë të angazhuar katër ekiye që punojnë me ndërtime 12 orësh, janë të angazhuar 5 mjek dhe 17 infermier, këtu kryhen vizita mjekësore dhe shumë shërbime tjera që dalin nga këto vizita. Urgjenca transporton pacientet nga vendi i ngjarjes deri në Emergjencën e Spitalit Sheikh Zayed në Vushtrri e nëse kërkohet ndihmë nga Emergjencia e spitalit, transportoen pacientët sipas nevojë në SHSKUK Prishtinë. Në disa raste ofrojn vizita dhe shërbime shëndetësore edhe në shtëpi, kur gjendja e pacientit është e rënd, po ashtu në kuadër te departamentit të mjekësisë familjare kemi angazhuar ekipin e urgjencës me ndihmë të ekiyeve të mjekësisë familjare të cilët kanë dhënë edhe shërbime mjekësore në shtëpi tek pacientët të infektuar nga virusi Covid-19.

Rastet e konfirmuara të vdekjes sipas tabelës gjithësej, meshkuj, femra dhe mosha mesatare e vdekjeve:

Muaji	Gjithësej	Meshkuj	Mosha mesatare meshkuj	Femra	Mosha mesatare femra	Mosha mesaare e vdekjeve ne total
Janar	26	11	67.36	15	75.66	71.51
Shkurt	15	8	73.62	7	75.28	74.45
Mars	16	13	78.61	3	81	79.8
Prill	14	5	79.8	9	80.66	80.23
Maj	15	9	68.5	6	84.83	76.66
Qershor	12	6	65.6	6	70	67.8
Korrik	13	8	76.5	5	81.2	78.85
Gusht	10	6	74.6	4	78	76.3
Shtator	18	7	75.3	11	69.6	72.4
Tetor	15	11	71.54	4	78.5	75.2

Nëntor	19	14	70.92	5	75.4	73.16
Dhjetor	14	6	76.16	8	78.75	77.45
<b>Totali</b>	<b>187</b>	<b>104</b>	<b>73.2</b>	<b>83</b>	<b>77.4</b>	<b>75.3</b>

#### Sektori diagnostikues

Laboratori se bashku me Rëntgenin bëjnë pjesë në sektorin e diagnostikës.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2022 në Laborator ka pas gjithsejtë 15333 pacient dhe janë dhënë 150531 shërbime te ndryshme, është hapur laboratorin në Lumadh në bashkëfinancim me AQH të cilët kanë dhënë donacion me pajisje mjekësore për laborator por për shkak gjendjes e cila u përkeqësua nga virusi dhe në mungesë të stafit laboratorit, për kohësisht nuk është funksional.

Laboratori ka kemi pasur vonesa në furnizuar mirë me reagensë, për të cilat kemi raportuar në DSHPS dhe Drejtorinë e Prokurimit.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe me buxhet të komunës jemi furnizuar me material për kryerjen e analizave: IGG dhe IGM, D-Dimer dhe teste rapide dhe në vazhdimësi ka filluar nga Ministria e Shëndetësisë furnizimi me teste rapide të shpejta.

Rëntgeni nga Janari deri në Dhjetor ka pas gjithsejtë 5525 pacient dhe janë dhënë 14993 shërbime, vlen të ceket se të gjithë ata që kanë kërkuar shërbim në Radiologji edhe e kanë marrë atë shërbim, material për punë kanë pas mjaftueshëm filma të Rëntgenit si dhe CD.

Punon nga ora 07<sup>h</sup> deri 13<sup>h</sup> çdo ditë pune.

Në Rëntgenin e dhëmbit gjithsejtë ka pas 31 pacient dhe janë dhënë 45 shërbime.

#### Barnatorja Qendrore

Furnizim me material shpenzues medicinal, barëra, insulina nga lista esenciale e MSH për periudhën kohore janar – dhjetor 2022 është realizuar në vlerë **291,218.87 €**. Per shkak te mungesave gjatë furnizimit me barna dhe material shpenzues nga Ministria e Shendetësisë, QKMF ka qenë e detyruar të bëjë blerjet e tyre nga buxheti i komunës së Vushtrrisë të ndarë për blerjet e produkteve medicinale dhe material shpenzues, permes korniz konrates me furnizuesin “MEDPLUS ShPK”:

Nr.	Vlera e blerjesë €
<b>1</b>	23,498.60
<b>Gjithsej</b>	<b>23,498.60</b>

Në tabelën e mëposhtme keni të bashkangjitur përqindjen e furnizimeve nga M.Sh. me barna dhe material shpenzues për periudhën kohore janar – dhjetor 2022, nga lista esenciale:

Nr.	Muaji	Barnat	Material shpenzues
1	Janar	55.81%	86.36%
2	Shkurt	54.65%	72.72%
3	Mars	56.32%	73.91%
4	Prill	53.48%	78.26%
5	Maj	39.08%	72.72%
6	Qershor	27.90%	86.36%
7	Korrik	33.33%	83.33%

8	Gusht	30.15%	83.33%
9	Shtator	39.68%	83.33%
10	Tetor	36.50%	88.88%
11	Nentor	33.33%	88.88%
12	Dhjetor	31.74%	84.21%
	<b>Mesatarja vjetore</b>	<b>41.00%</b>	<b>81.86%</b>

Depoja Qendrore Farmaceutike gjatë vitit 2022 ka bërë shperndarjen e barnave dhe materialit shpenzues në gjithsej 18 QMF dhe AMF të komunës së Vushtrrisë, ne interval te caktuara kohore, QMF dhe AMF për çdo muaj, ndërsa QKMF dhe QMF-1 në intervale 2 javore.

#### Raporti i bombolave të oksigjenit medicinal Janar – dhjetor 2022

Nr.	Pershkrimi	Dhënia	Sasia	Totali
1	Bombola oksigjeni medicinal 8.5 kg	Pacient	84	84
2	Bombola oksigjeni medicinal 8.5 kg	Insitucionet/QKMF/QMF/AMF	43	43
3	Dhenia e aparatit koncentror	Pacientë	2	2
Totali			129	129

#### ZHVP- Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

Bazuar në raportin e ZHVP-së lidhur me aktivitetet e ndërmaruara ka bërë bashkëpunim me QZMHF në Prishtinë dhe QTMF në Mitrovicë duke realizuar planprogramin gjatë vitit 2022,

Koordinatori i Cilësisë së bashku me Kryeinfermieren e QKMF dhe trajneret e Mjekësisë familjare ka bërë një Audit klinike dhe një Rishqyrtim kolegjal, po ashtu në pjesën e dytë të vitit 2022.

ZHVP- Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional për mjekët dhe infermier, është komponent me rëndësi të veçantë për institucionin e QKMF-së. Në QKMF mbahen takime të rregullta me mjek dhe infermier të cilat organizohen përmes përgjegjëses për ZHVP. Gjatë vitit mbahen takime profesionale për profesionistet mjekësor për çdo muaj, 10 ligjërata , këto ligjërata nuk mbahen vetëm në muajin korrik dhe gusht. Zakonisht janë mbajtur ligjërata me tema që kanë qenë të përzgjedhura nga këshilli profesional i QKMF-së dhe nga ky vit janë të certifikuar nga OMK.

ZHVP për infermier gjithashtu mbanë ligjërata të përmuajshme për infermier dhe ligjërata në komunitet me theks të veçantë në edukim dhe promovim shëndetësor. Ligjëratat në komunitet mbahen zakonisht në viset rurale në objektet e qendrave shëndetësore apo në shkolla fillore, ligjërata mbahen edhe për adoleshentët në shkollat e mesme . Gjithashtu ZHVP se bashku me koordinatorin e cilësisë dhe qendrën trajnuese për infermier (QEV) i shënon ditët e caktuara botërore për sëmundje të ndryshme, me aktivitete jashtë institucionit dhe në bashkëpunim me punëtorë tjerë shëndetësor në QKMF.

Qendra për zhvillim të vazhdueshëm profesional infermierik ka dhënë aktivitetet si më poshtë për periudhën kohore 01.01.2022 deri 31.12.2022

Bazuar në kërkesën e Drejtorit të DSHPS në Komunën e Vushtrrisë, dhe me autorizimin e Drejtorit të QKMF-së "Dr.Safet Idrizi" Vushtrri është formuar ekipi mjekësor nga QKMF për kontrollat sistematike për higjienën në shkollë fillore Lumadh.

Vizitat janë kryer nga specialistet e mjekësisë familjare dhe infermier të QKMF, ku për qëllim ka pasur vizitat për skabies dhe pedikulozë.

Në formë tabelare ju paraqesim numrin e përgjithshëm të vizituarve, sipas grupmoshave.

Nr	Tema	Nxenesë	Kl	Nr I nxeneseve
1.	Vizita per skabies dhe pedikulozë grup mosha 1-5 vjeç	6	Parashkollor	6
2.	Vizita per skabies dhe pedikulozë, grupmosha 6-9 vjeç	5+13+12+10+2	KL I, KL II, KL III, KL IV.	42
3	Vizita per skabies dhe pedikulozë, grupmosha 10-14 vjeç	7+14+10+13+20+15+9	KL IV, KL V, KL VI, KL.VII, KL.VIII, KL.IX	88
<b>Totali i nxënësve</b>				<b>136</b>

#### QEV- Qendra e Edukimit të Vazhdueshëm

QEV- Qendra e Edukimit të Vazhdueshëm profesional ka një aktivitet të caktuar nga M.SH. dhe QEV në Prishtinë që merret me organizimin e kursit të ngritjes profesionale i cili është tre javor dhe ka tri module dhe secili modul ka nga 5 tema ku trajnohen infermieret për të qenë gjithmonë të përgatitur për sfidat e reja që na presin.

Gjatë vitit 2022 janë organizuar trajnime në 7 grupe me 6 pjesëmarrës për shkak të gjendjes së pandemisë ka qenë numri i kufizuar, këto trajnime kanë zgjatur 3 javë për secilin grup, përqindja e arritshmërisë së kandidatëve në total është 89.93 %.

#### Bashkëpunimi me UNICEF dhe AMC

Gjatë vitit 2022 DSHPS dhe QKMF kanë arritur që të vazhdojnë bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me donator për realizimin e projekteve me bashkëfinancim.

Në koordinim dhe bashkëpunim të MSH, UNICEF-in dhe AMC-ën vazhdohet të implementohet programi i vizitave shtëpiake për gra shtatzëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare,

Si rezultat i përmbushjes së planprogramit QKMF është shpërblyer me një veturë për kryerjen e vizitave në teren, me laptop, tensiometer, thermometer, pulsoksimeter, peshore digjitale për shtatzëna, peshore digjitale për fëmijë etj

Puna në teren ka mundur të hasim në shumë raste me interes të cilat janë referuar për trajtim dhe identifikim tek mjeku familjar, pastaj te pediatri kanë qenë gjithsej 15 të tilla. Këto rastë të veçanta kryesisht kanë të bëjnë me ngecje në rritje dhe zhvillim.

Numri i vizitave shtëpiake në komunën e Vushtrisë në vitin 2022:

Komuna VUSHTRRI	Jana r	Shku rt	Mar s	Prill	Ma j	Qe rsh or	Ko rri k	Gu sht	Sht ato r	Tet or	Në nto r	Dhje tor	Tota l
Numri i vizitave për fëmijët 0-3 vjeç	317	423	457	371	414	261	394	353	421	468	616	329	<b>4824</b>
Numri i vizitave për shtatzëna	60	66	83	49	64	41	80	67	66	68	58	49	<b>751</b>
Numri total i vizitave.	<b>377</b>	<b>489</b>	<b>540</b>	<b>420</b>	<b>478</b>	<b>302</b>	<b>474</b>	<b>420</b>	<b>487</b>	<b>536</b>	<b>674</b>	<b>378</b>	<b>5575</b>

Ofrimi i shërbimeve mjekësore për vizitat shtëpiak sipas marrëveshjes së Komunës së Vushtrrisë dhe Islamic Relief Eorldeide me seli në Prishtinë.

Në kuadër të implementimit të projektit vlera e investuar nga donatori është 110,00.00 e ose 53 %, kurse buxheti komunal të participojë me kontribut financiar prej 98,746.00 Euro ose 41.18%.

Qytetarët e komunës së Vushtrrisë në nevojë për dhënie dhe ofrimin e shërbimeve mjekësore përveç vizitave mjekësore, janë dhënë shërbime të ndryshme si dhe janë aplikuar terapitë e nevojshme nga projekti sipas listës esenciale të Ministrisë së Shëndetësisë.

Nga muaji janar 2022 projekti konkretisht realizohet me përpikëri sipas marrëveshjes ku kemi 6 ekupe mjekësore të përbërë nga 1 mjek dhe 2 infermier.

Tani nga muaji 19.05.2022, janë angazhuar në projekt në faza të konkursit dhe 2 teknik laborant dhe 1 asistent stomatologu sipas marrëveshjes.

QKMF duke zbatuar Udhëzimin administrative për bashkëpagesat në KPSH, krijon të hyra vetanake.

Paraqesim në formë tabelare të hyrat vetanake 2022:

Nr.	Viti fiskal I të hyrave vetanake janar dhjetor 2022	Vlera totale e të hyrave
1	2022	51,188.50
Vlera		51,188.50

Shpenzimet e derivative Janar – dhjetor 2022

Shpenzimet e derivateve të naftës dhe benzines sipas muajve për automjete, periudha Janar/Dhjetor 2022													
Nr.ren		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	
	Totali	1154	1008	1268	1143.55	1259.3	1363	1692	1458	1442	1371	1268	

Krahasimet mes shpenzimeve të derivateve sipas viteve 2021/2022

Viti Fiskal	2021	2022	Diferenca
Shpenzimet e derivateve	17122.46	15815.85	1306.61

### Shtëpia Rezidenciale Lummadh

Safi QR përbehet prej 2 infermierëve dhe 6 nd.infermiere si dhe konkursi gjendet i hapur edhe për dy infermier te cilët pritet te fillojnë punën vitin 2023. Punëtorë aktual punojnë me orar 24 ore në 4 ndërrime. Që nga mesi i muajit nëntor kemi hyre ne menaxhimin e kompanisë NPL.Perparimi dhe i kemi katër punëtorë te kompanisë qe paguhen për shërbimet te cilat i kane brenda institucionit (2 sigurim për objekt dhe 2 mirëmbajtës).

Rezidentet te cilët janë te vendosur ne Shtëpinë Rezidenciale janë nga komunat si ne vijim:

- Komuna e Vushtrrisë 2 rezident;
- Komuna e Mitrovicës 2 rezident;

Komuna e Skenderajt 2 rezident;  
Komuna e Prishtinës 3 rezident;  
Komuna e Obiliqit 1 rezident;  
Komuna e Shtimes 1 rezident .

Gjendja shëndetësore është stabile përjashtimit disa gripa sezonal tek disa prej pacienteve si dhe me disa probleme dentare te cilat janë evidentuar ne QKMF-ne e Fshatit Lumadh. Te gjithë rezidentet janë kontrolluar ne shëndetin mendore ne Mitrovice dhe psikologjia klinike, ku për secilin është përshkruar terapia dhe ne bashkëpunim edhe me infermieret është caktuar koha e marrjes se terapisë. Qendra e Mjekësisë Familjare ka kryer shërbimin me analiza ku secilit rezident i është marre mostra e gjakut Te gjithë janë relativisht mire vetëm rezidenti i ri nga komuna e Mitrovicës dhe një rezidente nga Skenderaj kanë probleme me aneminë dhe janë ne terapi për një kohe pastaj do te përsëriten prape analizat pas terapisë.

Rezidentet ne Shtëpinë Rezidenciale nuk kane qenë aktivë në aktivitetet e ndryshme ditore dhe si rrjedhoje e kësaj gjendje e kam planifikuar një psikologe qe te zhvilloj aktivitet me secilin rezidente 1 ore ne jave për ti ndihmuar ne zhvillimin psikomotorik. Gjate publikimit te konkursit për psikologe klinike nuk kane aplikuar asnjë kandidate dhe këtë arsye ka dështuar ky aktivitet, por pritet te iniciohet vitin 2023.

### **Qendra për punë Sociale**

#### Asistenca Sociale

Në QPS Vushtrri, në Asistencë Sociale janë 1296 familje, prej tyre 1245 familje me 5603 anëtarë janë shqiptarë si dhe 51 familje me 104 anëtarë janë minoritete.

Gjatë këtij viti janë parashtruar 121 kërkesa për asistencë sociale, prej të cilave 89 janë aprovuar kurse, 32 prej tyre janë refuzuar si familje, të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret. Ndërsa janë riaktivizuar 15 familje.

Asistenca sociale i është ndërprerë 132 familjeve, të cilat kanë qenë shfrytëzuese të asistencës sociale.

Në këtë periudhë raportuese kërkesa për ndihma momentale janë 7, prej tyre 3 janë aprovuar në vlerë prej 100 euro dhe 4 të refuzuara.

Në komision mjekësor janë dorëzuar dhe trajtuar 931 aplikantë. Prej tyre janë aprovuar 792 aplikues, janë refuzuar 139 aplikues, ndërsa në rishqyrtim kanë qenë 35.

Gjatë kësaj periudhe nga Qeveria janë mbështetur me mjete djegëse (dru) 20 familje me nga 3m.

Pako ushqimore janë 1310. Kurse, familjet e asistencës sociale janë përkrahur edhe me nga 100 euro mjete materiale.

#### Shërbimet Sociale

Në periudhën raportuese krahasuar me vitin paraprak numerikisht numri i klientëve ka pasur ngritje si rezultat i trajtimit të rasteve të dhunës në familje dhe shkurorzimeve kategorive të reja, dhe e gjithë kjo ka rezultuar edhe me rritjen e volumit të punëve dhe ofrimit të shërbimeve përmes formave të mbrojtjes sociale.

Vlen të theksohet se gjatë kësaj periode kemi pasur 59 raste të trajtimit të bashkëshortëve me marrëdhënie të çrregulluara ose në procedurën e shkurorëzimit, ku prej tyre 16 kanë arritur pajtim 23 procedur dhe 15 ndarje.

Nga këto familje janë 34 fëmijë, prej tyre 19 i janë besuar nënës në përkujdesje, ndërsa 15 ju janë besuar babait në përkujdesje.

#### Fëmijët pakujdes prindor

Kemi pasur 2 femijë të braktisur të bartur nga viti i kaluar kurse gjatë këtij viti kemi 3 fëmijë të braktisur gjithsej 5 fëmijë, 2 raste të bartuara nga viti i kaluar janë në procedur paraadoptuese, 2 fëmijë janë vendosur në strehim familjar në komunitet, 1(një) fëmijë i prindërve të penguar në detyrën prindore i bartur nga vitet e kaluara është në mbrojtje institucional i strehuar në Caritas Klinë dhe një (1) fëmijë për shkak të vështirësive që ka pasur prindi

për ti kryer detyrat prindore është trajtuar me formën mbrojtese strehim familjar në komunitet, gjatë qëndrimit në strehim familjar fëmijës ju kanë ofruar shërbime psikologjike si dhe është bërë regjistrimi në shkollë të re, dhe shërbimet e tjera të nevojshme sociale.

Gjatë këtij viti i kemi pasur 2 raste heqje e zotësis për të vepruar si dhe kërkesa për kujdestari të veçanta, kemi caktuar kujdestar ligjor për 7 raste, me rastet e bartura nga vitet paraprake gjithsej 25 kujdestari aktive. Strehim familjar tek të afërmit 20 raste, të gjithë fëmijët që janë në strehim familjar tek të afërmit janë vizituar. të gjitha rastet problematike janë trajtuar në formën e duhur duke ju ofruar fëmijëve dhe familjeve seanca këshilluese, e shërbime të tjera të nevojshme.

#### Dhuna në familje

Gjatë periodës që po raportojmë ka pasur shtim të lartë të rasteve ku kemi 57 raste të raportimit të dhunës familjare, ndaj femrave dhe raste ndaj antarëve të familjes, çka është mjaft brengosëse. Në këtë vit kemi 15 gra + 24 fëmijë gjithsej 39 persona të cilët janë vendosur në strehimoren Raba Voca Mitrovicë. Kemi pasur një transfer nga strehimorja Mitrovicë në strehimoren Ferizaj të nënës me 5 fëmijë dhe 1 rast të bartur nga vitet e kaluara e vendosur në Shtëpinë e Sigurt Gjakovë.

Janë dhënë 55 urdhra mbrojtje prej gjykatës për rastet e dhunës në familje, 16 raste kemi arritur ti pajtoim , 24 ndarje, ndërsa rastet e tjera janë në procedur.

#### Personat e moshuar

Në këtë vit rëndësi të veçantë i kemi kushtuar sidomos të moshuarve pa kujdes familjar ku i kemi pasur të vendosur 3 raste 2 në shtëpinë e pleqëve Skenderaj dhe 1 në Prishtinë, 1 kërkes është në procedur për tu vendosur në shtëpi të pleqëve Prishtinë, dhe janë dhënë 4 raste për bashkim familjar tek të afërmeve jashtë shtetit.

## **KULTURË RINI SPORT**

### QENDRA E KULTURËS “HASAN PRISHTINA”

Bazuar në Planin e Punës për vitin 2022, në Qendrën e Kulturës "Hasan Prishtina" punët kanë rrjedhë sipas planit, duke realizuar në tërësi planin e punës, por duke e plotësuar atë edhe me aktivitete të reja shtesë të cilat ndonëse nuk janë paraparë në planin e punës, kanë dalë si rezultat i ideve të reja të stafit të drejtorisë sonë, apo edhe qytetarëve që janë marrë me aktivitete kulturore, por edhe institucionet tjera me të cilat kemi bashkëpunuar gjatë këtij viti.

Stafi i Qendrës për Kulturë “Hasan Prishtina” gjatë këtij viti ka mbështetur apo ka organizuar të gjitha aktivitetet kulturore që janë organizuar nga institucionet komunale. Po ashtu, ka ndihmuar në organizimin e aktiviteteve të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe aktiviteteve të ndryshme në të cilat është kërkuar ndihma jonë, qoftë nga organizatat rinore, grupet e intelektualëve apo shkollat e komunës së Vushtrrisë. Ne, në vazhdimësi kemi mbështetur, por edhe kemi marrë pjesë në organizimin e shumë takimeve letrare, si promovime të librave të ndryshëm në territorin e komunës sonë por edhe jashtë, kryesisht të autorëve vushtrrias. Gjithashtu, janë mbështetur edhe shumë artistë për organizimin e ekspozitave të tyre, në Galerinë e Arteve në Qendrën e Kulturës, si dhe aktorëve për realizimin e shfaqjeve që janë dhënë në Teatrin e Qytetit "Adem Mikullovcit". Një punëtor i QK “Hasan Prishtina” mban në vazhdimësi të hapur dhe përkujdeset për Kalanë e Qytetit. Vlen të përmendet se në këtë vit kemi qenë të angazhuar edhe në organizimin e disa akademive përkujtimore, për nder të disa personaliteteve të rëndësishme nga Vushtrria.

Ndër aktivitetet kulturore që kemi organizuar apo që kemi marrë pjesë veçojmë:

Organizimi i ceremonisë për shpalljen e Sportistëve të vitit 2021; Promovimi i librit "Vicianë – Vushtrria I", nga autori Izet Miftari; Hapja e Ekspozitës me punime prej letre ORIGAMI, nga Hadije Zuçaku; Promovimi i librit

"Syzheu i jetës", nga Arxhela Krasniqi; Akademi Solemne për nder të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës; Aktiviteti "Mësuesi i lirisë", në kuadër të Epopesë së UÇK-së; Aktiviteti "Këpucët e kuqe", kushtuar grave që kanë humbur jetën si pasojë e dhunës; Akademi Përkujtimore për prof. Fahri Buçinca; Ekspozitë me fotografi "Fshatrat e Vushtrrisë", të autorit Berat Mernica; Përrurimi i librave "Njeriu i lartësive", të autorit Gëzim Saraçi dhe "Dhe unë jam njeri", të autorit Lulëzim Krasniqi – Arbanasi (ndonëse janë përruruar në Prishtinë, organizimi është bërë nga DKRS). Akademi Përkujtimore dhe Zbulim i Lapidarit të dëshmorit Blerim Agim Saraçi; Shfaqja "Akraballëkët", në regji të Fazli Muharremi; Akademi Përkujtimore dhe Zbulim i Lapidarit të dëshmorit Avni Hajdin Klinaku, 18 prill 2022. Akademi Përkujtimore "Studimja '99"; Koncert "Kultura na bashkon", në bashkëpunim me AKV "Mirdita", nga Mirdita e Shqipërisë, Akademi Përkujtimore për Masakrën mbi Familjes Gërzhaliu; Aktivitete dhe koncert për fëmijë për nder të Ditës së Fëmijëve - 1 Qershori 2022; Akademi Solemne për nder të Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë – 17 qershor 2022; Koncert me grupin muzikor "TNT", në Sheshin Adem Jashari, më 17 qershor 2022; Përrurimi i librit "Mos ma vjedh lirinë", të autorit Burim Gjaka; Ekspozitë "Into the ocean" të artistes vushtrriase Fjollja Ferati, në kuadër të Manifestimit "Ditët e diasporës"; Koncerti "Ti je pjesë e atdheut", ku kanë performuar solistë të shumtë nga AKV "Hasan Prishtina", si dhe mysafiri special Ramadan Krasniqi – Dani, në kuadër të Manifestimit "Ditët e diasporës"; Përrurimi i librit "Unë, biri i Oshlanit heroik", të autorit Islam Islami, i cili është një bashkatdhetar që jeton në mërgim, në kuadër të Manifestimit "Ditët e diasporës"; Tryezë për promovimin e turizmit malor, agroturizmit dhe turizmit urban në kuadër të Manifestimit "Ditët e diasporës"; Aktivitet kulturor me bashkatdhe tarë "Strofci feston", Përrurimi i librit "Dialog me gjyshin", të autorit Ibrahim Kuçi; Promovimi i librit "Halit Çuka – simbol i qëndresës shqiptare" të autorit Qazim Azemiti; Orë letrare me mërgimtarët dhe për mërgimtarët në Kalanë e qytetit, pjesa e dytë e manifestimit "Ditët e diasporës"; Mbështetja e të rinjve në organizi min e koncertit "Young Festival"; Organizimi i 1 Shtatorit – Ditës së Dëshmorëve të Kombit, të Komunës së Vushtrrisë; Përrurimi i librit "Kam një poezi për ty", të autores Merisa Pushkollit, e cila është nxënëse e klasës së gjashtë; Koncert solistik i sopranos vushtrriase Edina Pllana; Akademi Përkujtimore në fshatin Ashlan, në nderim të dëshmorit Bislim Kamer Imeri; Organizimi i festivalit "Takimet e Poeteshave Shqiptare", edicioni i 40-të; Organizimi i Akademisë për 28 Nëntor – Dita e Flamurit; Përrurimit të librit "Monografi për Hajzer Krasniqin", të autorit Jakup Krasniqi; ETJ.

### Teatri i Qytetit “Adem Mikullovcit”

Teatri i qytetit më 30 dhjetor 2021 ka shfaqur dramën “Emigrantët” autor Mrozhek, në interpretim të dy aktorëve Ekrem Smajli dhe Besart Bunjaku, e cila është reprizuar më 7 janar 2022 dhe është pritur jashtëzakonisht mirë nga publiku. Më 13 janar 2022 në teatrin e Vushtrrisë u shfaq komedia “Mat” në regji të Ben Apollonit, në interpretim të Brahim Bashës dhe Blerina Veselit, kurse autor ishte Ag Apolloni.

Më 9 prill u dha premiera e komedisë “Akraballakët” autor Kristo Floqi ku aktruan: Besart Bunjaku, Butrint Muharremi, Tuana Grabovci, Drita Dibrani, Haki Haliti, Tuana Fetiçi dhe Alban Xhema.

Më 16 qershor u organizua promovimi i librit “Mos ma vrit lirinë” ku teatri e morri organizimin e këtij promovimi, në të cilin interpretuan edhe tre aktorët e qytetit.

Sikur në organizimin e promovimit të librit “Të prita tek Ura e Gurit”, teatri ishte në organizim dhe interpretim. Më 2 dhe 3 gusht, në Teatrin e qytetit u mbajt premiera e filmit “Bomba”.

Më 10 nëntor është shfaqur komedia "Kërkohet bashkëshort i ri". Më 14 dhjetor është dhënë koncerti "Muzikë n' Teatër".

### Biblioteka “Naim Frashëri”

Të dhënat për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2022:

1. Fondi **38477** libra. Në sektorin e fëmijëve janë 12297 libra ndërsa në sektorin e të rriturve janë 26180
2. Në sektorin për fëmijë janë dhënë për lexim 4566 libra;



3. Në sektorin për të rritur janë dhënë për lexim 3637 libra;
4. Sallën e leximit e kanë shfrytëzuar 1655 lexues;
5. Janë përpunuar 850 libra;
6. Lexues të regjistruar në sektorin për të rritur ishin 87 (45 me pagesë);
7. Lexues të regjistruar në sektorin për fëmijë ishin 207 (25 me pagës).
8. janë dhënë për lexim **8203** libra;
9. Janë dhuruar nga autorë të ndryshëm dhe nga MKRS **829** libra.

Në sektorin për fëmijë libri më i kërkuara për lexim ishte: **“Lulet e Verës”**, i autorit Naim Frashëri Në sektorin për të rritur, libri më të kërkuar për lexim ishin: **“Historia e Skënderbeut”** e Marin Barletit. Libri shkencor më i kërkuar për lexim ishte: **“Vushtrria – Viciania I”**, i autorit Dr.sc. Izet Miftari.

Gjatë këtij vitit 2022 bibliotekën e kanë vizituar qindra nxënës të shkollave të fshatrave dhe të qytetit të Vushtrrisë.

Raport vjetor i punës nga muzeu për vitin 2022

### Muzeu

MUZEU	Me synim të hapjes së muzeut, janë realizuar takime me zyrtarë në MKRS. Takimet kishin për qëllim përsheptimin e procedurave të pranimit teknik të Muzeut të Qytetit të Vushtrrisë, gjegjësishtë monumentit “Shtëpia e Mahmut Pashë Gjinollit”. Ku si rezultate i diskutimeve është marrë vendim të themelohet një komision i përbërë nga MKRS-ja, QRTK-ja dhe Komuna e Vushtrrisë – DKRS-ja, i cili kishte rolin vendimmarrës në inspektimin e punëve të realizuara, deri tek pranimi teknik i monumentit të muzeut.
PUNËT HULUMTUESE DHE IDENTIFIKIMET	Përgjegjësjë e muzeut Shukrane Begu së bashku me stafin, në kuadër të punëve hulumtuese, ka vazhduar punën në hulumtimin e biografive të burgosurve politik gjatë periudhës 1944-1950 në Vushtrri dhe rrethinë, duke mbledhur dhe rexhistruar në muze edhe plotë 14 histori-biografi të të burgosurve politik. Në kuadër të punëve hulumtuese është trajtuar edhe tradita e pajës (çezit) në komunën e Vushtrrisë, tradita e artizanatit - berberit, të ndjerit “usta Murati” për punën dhe veprimtarinë tij ndër vite në komunën e Vushtrrisë, si dhe historiku i monumentit “Arkivi Historik”.
PASURIMI I SEKTORËVE: ARKEOLOGJI HISTORI ETNOGRAFI TEKNOLOGJI FOLKLOR DHE KULTURË SHPIRTËRORE	Edhe gjatë viti 2022 muzeu u pasurua me 33 eksponate nga fusha e etnologjisë, folklorit dhe teknologjisë të hulumtuara në Vushtrri dhe rrethinë.
PASURIMI I SEKTORIT TË KINOTEKËS DHE FOTOTEKËS	Muzeu- sektori i fototekës u pasurua me 53 fotografi dhe 4 video, siq janë:
BIBLOTEKA SHKENCORE E MUZEUT	Biblioteka e muzeut ka gjithësejtë 416 libra, kryesishtë shekncorë. Prandaj është punuar në sistemimin e fondit të botimeve shkencore në hapsirën dedikuar bibliotekës shkencore të muzeut. Në kuadër të bibliotekës është punuar me studentë dhe lexues, duke iu ofruar shënime dhe literaturë shkencore në realizimin e detyrave dhe punimeve shkencore.

INVENTRIZIMI DIGJITAL I EKSPONATEVE HISTORIKE, ARKEOLOGJIKE, ETNOGRAFIKE FOLKLORIKE	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Në muze u inventariuazuan gjithsejtë 97 ekspozate nga kultura materiale:           <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ 74 nga sektori i etnologjisë;</li> <li>➤ 18 nga sektori i teknologjisë;</li> <li>➤ 5 nga sektori i folklorit.</li> </ul> </li> </ul>
---	---

### Sektori i Rinisë

Aktivitetet: Takime pune dhe informuese me përfaqësuesit e OJQ- ve rinore. Gjatë takimeve me ta është bërë planifikimi, janë hartuar projekt-propozime dha janë dërguar për mbështetje në MKRS dhe USAID-ATRC, OSCE dhe organizata tjera.

Takime pune dhe bashkëpunim me OSCE,

Qendra rinore “Hareja” ka mbajtur trajnime për rrobaqepësi dhe modë, për gra dhe vajza të grupmoshave të ndryshme. Në fund të këtyre trajnimeve pjesëmarrëseve në trajnime u janë ndarë edhe certifikata për ndjekjen e trajnimeve. Ky projekt është mbështetur nga IOM dhe është asistuar nga Sektori i rinisë.

Takime me kryetaren e KVRL-së. Në këto takime u planifikua për projektet që parasheh të organizojë KVRL, po ashtu u diskutua për sfidat dhe problemet që ka KVRL

Organizata Rinore “Access” në bashkëpunim me Sektorin e rinisë dhe Departamentin e rinisë – MKRS ka planifikuar që të organizojnë trajnime për të rinjtë në Komunën e Vushtrrisë, (është hartuar projekt-propozimi dhe do të dërgohet për financim).

Takime pune me përfaqësuesit e The Poëer of Mind dhe KVRL-së, ata kanë hartuar një projekt për hartimin e Planit të Veprimt Rinor Lokal. Në fund të këtij projekti do të hartohet PVRL për tri vitet e ardhshme.

Takim me përfaqësuesin e OJQ “Lëvizja Koha” me të cilin u diskutua për projektet që parasheh të realizojë kjo OJQ, për formën e aplikimit dhe qasje në fonde të donatorëve të ndryshëm. Është në realizim e sipër projekti “Komuna për të rinjtë”. Ky projekt realizohet nga Komuna e Vushtrrisë në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Bankës Botërore, si dhe organizatës facilituese CDF. Ky projekt do të ketë një impakt të mirë për zhvillimin e aktiviteteve rinore, pasi që shuma totale për mbështetjen e të rinjve në total arrin vlerën 250.000.00 dollarë amerikan.

KVRL në bashkëpunim me organizatën “Domain for Kosovo” kanë mbajtur sesion informues për të rinjtë në shkollat e mesme. Ky sesion ka për qëllim informimin e të rinjve për themelimin dhe punën e KVRL-së, si dhe promovimin e Domenit shtetëror për Kosovë.

Trajnime për shkathtësi të buta, kurse për kompjuter, kurse për gjuhë të huaja, kurse për matematikë, të mbajtura nga Qendra rinore “Hareja” e cila është licencuar në fund të vitit të kaluar.

Është bërë certifikimi i të rinjve në trajnimin për ndërmarrësi dhe kodim.

### Sektori i Sportit

Num-ër Rend- or	Emri i shfrytëzuesit të palestrës	Stërvitje		Ndeshje		Rekreacion	
		Me pagesë	Pa pagesë	Me pagesë	Pa pagesë	Me pagesë	Pa pagesë
1	Kl. i boksit “KALAJA”		113				
2	Kl. i boksit “VUSHTRRIA”		116				

3	Kl. i basketbollit "VU BASKET"		364		77		
4	Kl. i basketbollit "VUSHTRRIA" - F		171		15		
5	Kl. i basketbollit "VUSHTRRIA" - M		152		18		
6	Kl. i gjimnastikës "VUSHTRRIA"		232				
7	Kl. i hendbollit "VUSHTRRIA" - F		161		45		
8	Kl. i hendbollit "VUSHTRRIA" - M		158		45		
9	Kl. i hendbollit "SAMADREXHA" - F						
10	Kl. i hendbollit "SAMADREXHA" - M						
11	Kl. i volejbollit "VUSHTRRIA" - F		197		45		
13	Kl. i volejbollit "AS VUSHTRRIA" - M		156		45		
14	Kl. i volejbollit "AS VUSHTRRIA" - F		156		45		
15	Kl. i pingpongut "H.PRISHTINA"		231				
16	Kl. i pingpongut "VUSHTRRIA"		231				
17	Kl. i xhudës "VICIANUM"		118				
19	Kl. i mundjes "KOSOVA"		73				
22	Gëzim Sokoli						
25	Shoqata e të shurdhërve		41				
27	Agron Neziri						
28	Besart Muja						
29	Kl. i basketbollit "GJIMNAZISTI"		37				
30	KXH Studenti		80				

### Arkivi Historik

Arkivi Historik është institucion i cili pranon , evidencon, rregullon dhe publikon lëndën arkivore, mundëson shfrytëzimin e saj për hulumtime shkencore dhe punë profesionale si dhe për nevoja tjera të cilat janë në interes për organet,organizatat, institucionet, personat civil-juridik.

Arkivi Historik i Qytetit-Vushtrri:

<b>Shërbimi për mbrojtjen e dokumenteve arkivore jashtë arkivit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në periudhën Janar- Gusht 2022 kemi bashkëpunuar me Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës për hartimin e ligjit të ri për Arkivat.</li> <li>Me kërkesë të Agjencisë kemi dërguar në mënyrë elektronike rekomandimet tona në lidhje me projektligjin nr.08/L-111 për Arkivat Shtetërore me datë 27.04.2022.</li> <li>Kemi pasur bashkpunim profesional edhe me Arkivin Ndërkomunal të Mitrovicës në lidhje me regjistraturat jashtë Arkivit.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në këtë muajin mars kemi pranuar material të ndryshëm nga Drejtoria e Kadastrit , materiali i dorëzuar është jashtë funksionit të resorit, i cili</li> </ul>

<p><b>Pranimi i lëndës arkivore nga institucionet lokale</b></p>	<p>i'u ka dorëzuar Arkivit komunal..</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Në muajin tetor-nentor kemi pranuar material arkivor nga Drejtoritë Komunale-Administrata, Urbanizmi, Prokurimi, Bujqësia. Materiali nuk është dorëzuar në mënyrë të rregulltë, por nevoja për lirim e hapsirës në depot e Komunës për renovimin e tyre e ka pamundësuar pranim –dorëzimin në formë të rregulltë.</li> <li>• Marveshja në mes të Drejtorisë së Administratës dhe DKRS-Arkivit është që të rissistemohen dhe klasifikohen dhe të rëgjistrohen nga Drejtorit e caktuara.</li> </ul>
<p><b>Evidentimi rregullimi dhe klasifikimi dokumenteve brenda arkivit</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Në këtë periudhë kohore kemi bërë vetëm ndarjen dhe klasifikimin e lëndës në sektore të caktuara, materiali pjesërisht është i vendosur në rafta arkivore.</li> <li>• Mungesa e raftave dhe ndërperja e kontratës për furnizim me rafta të sistemit modular paraqet problemin kryesor për sistemin e lëndës arkivore e cila nuk është në gjendje të mirë.</li> <li>• Pas anulimit të kontratës për furnizim me rafta arkivore kemi filluar modifikimin e raftave egzistuese të cilat nuk i plotësojnë kushtet. Sasia e tyre dhe cilësia janë në nivel të ulët për shfrytëzim, por pasi që mungojnë rafta tjera duhet të shfrytëzohen nëse kemi mundësi .</li> </ul>
<p><b>Aktivitete tjera</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Si njësi arkivore dhe si staf zyrtar kemi bashkëpunuar me DKRS dhe fushat tjera të Kuvendit komunal Vushtri.</li> <li>• Angazhimi në komisione për vlerësim të ofertave të prokurimit në kuadër të DKRS-së.</li> </ul>
<p><b>Punët e udhëheqjes në Arkiv</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Arkivi Historik i qytetit menaxhohet nga udhëheqësi dhe stafi i Arkivit në bashkëpunim me DKRS-Vushtri.</li> <li>• Në arkivin e qytetit janë dy vende të lira si ndihmësarkivist , kështu që edhe kjo dukuri e pengon punën ekipore e cila duhet të zhvillohet në Arkiv.</li> </ul>
<p><b>Aftësimi profesional i punëtorëve</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjatë këtij viti të punës sa përket aftësimin profesional nuk ka pasur trajnime në drejtim të lëndës së Arkivistikës si lëmi përkatëse për arkiv.</li> </ul>

## INSPEKSIONI

Aktivitetet të paraqitur në mënyrë tabelare

Inspektoratet	Numri i Inspektorëve	Procesverbale	Fletparaqitje	Urdhëresaa	Aktivendime	Mbyllje të lokaleve përkohsishtë	Gjoba mandatore
Inspektorati i Tregut	4	469	-	55		2	7
Inspektorati i Ndërtimtarisë	1	65	4		13		2
Inspektorati i Komunikacionit	2	45		6	36		3
Inspektorati i Shërb Publike - Higjienës	2	39	-	85		-	5
<b>Totali</b>	<b>9</b>	<b>618</b>	<b>4</b>	<b>146</b>	<b>49</b>	<b>2</b>	<b>17</b>

Subjektet afariste të pajisura me pëlqim për plotësimin e kushteve minimale teknike  
Bartës të aktivitetit - Inspektorati i Tregut

APLIKUAR	130
TË VENDOSURA	123
NË PROCEDURË	-
TË REFUZUARA	7
Mjete të inkasuara	5970,00 €

Pranimi tekniki automjeteve  
Bartës të aktivitetit - Inspektorati i Komunikacionit

APLIKUAR	36
TË VENDOSURA	36
NË PROCEDURË	-
Mjete të inkasuara në €	180,00 €

Malli i larguar nag shitja dhe qarkullimi dhe mall i asgjësuar

Bartës i aktivitetit  
Inspektorati i Tregut

Mall i asgjësuar	19224,82 kg
------------------	-------------

Mjete të inkasuara nga malli i asgjësuar

Mall i asgjësuar	5 x 150.00	750.00 €
------------------	------------	----------

Gjoha të aplikuara nga Inspektorati

APLIKUAR	14
TË VENDOSURA	14
Mjete të inkasuara në €	1850,00 €

Vërejtje : Të gjitha pagesat e gjobave janë të kryera me 50 % të pagesës duke mbështetur në Ligjin Për Kundërvajtje 05/L-087, ndërsa disa gjoba të shqiptuara nga Inspektorati i Tregut janë bartur në të hyra në MINT.

AKTIVITETET NË FORMË TABELARE

Nr.	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	SASIA	VLERA
1	AKTIVITETE INSPEKTUESE	922	
2	PROCES VERBALE	618	
3	AKTVENDIME/ URDHËRESA TË NDRYSHME	146	
4	FLETËPARAQITJE NË GJYKATË	4	
5	PRANIME TEKNIKE	130	5970,00 €
6	PRANIME TEKNIKE TË AUTOMJETEVE	36	180,00€
7	MALL I LARGUAR NGA SHITJA DHE ASGJASIMI I MALLIT	19224,82 kg	
8	PAGESË PËR ASGJASIM TË MALLRAVE	5	750,00 €
9	KËRKESA TË PRANUARA	503	

10	KËRKESA TË MIRATUARA	473	
11	KËRKESA TË REFUZUARA	13	
12	KËRKESA TË HEDHURA POSHTË	15	
12	KËRKESA NË PROCEDURE	2	
13	DENIME MANDATORE	17	1850,00 €
14	MBYLLJE TË PËRKOHSHME TË LOKALEVE AFARISTE	3	

#### TË HYRAT NGA DREJTORIA PËR INSPEKTIVE

Pranime teknike	5970,00 €
Gjoha mandatore	1850,00 €
Pranime teknike të automjeteve	180,00 €
Asgjësimi i mallit	750,00 €
Totali i të hyrave	8750.00 €

#### Inspektorati i Tregut - Aktivitetet e inspektimit :

- Subjekte afariste ku frekuentimi i konsumatorëve është më i madh,
- Subjekte afariste të cilat merren me shitje me pakicë dhe shumicë,
- Subjektet të cilat merren me shërbime –restorante – hotele - motele,
- Subjektet lidhur me respektimin e orarit të punës,
- Inspektimi i bizneseve të reja,
- Siguria e përgjithshme e produkteve,
- Luftimi i praktikave të padrejta tregtare si dhe parandalimi i tregtisë informale,
- Mbrojtja e konsumatorit,
- Mbrojtja e shëndetit publik duke kryer kontrolla të rregullta në sigurinë e përgjithshme të produkteve,
- Udhëzime, këshilla tek subjektet ekonomike mbi Ligjet në fuqi si dhe për Ligjet e aplikueshme që rregullojnë praktikat tregtare si dhe qështje të tjera që ndikojnë në zhvillimin e tregtisë.

Gjatë inspektimeve të marketeve është hasur në produkte pa deklaracion në gjuhën zyrtare si dhe në disa produkte të cilat nuk kishin të vendosur flamurin e origjinës të produktit.

Produktet të cilat nuk kishin deklaracion në gjuhën zyrtare janë larguar nga shitja dhe qarkullimi ndërsa, Për këto parregullësi, ndaj operatorëve ekonomik, përgjegjësve të subjekteve afariste, ndaj tyre janë marrë masa administrative – ndëshkim me gjobë mandatorë .

Një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit është edhe zëri i shoqërisë civile si dhe informimi, edukimi dhe ngritja e vetëdijesimit të konsumatorëve përmes mekanizmave të ndryshëm. Sa i përket Mbrojtjes së Konsumatorit, janë shqyrtuar dhe janë proceduar ankesat e konsumatorëve duke ndërmarr masat e parapara me Ligj.

## SIGURIA E PRODUKTEVE - AKTIVITETI

Inspektorati i Tregut është duke krijuar një ambient të sigurt në Mbrojtje të Konsumatorit dhe një garanci për të gjitha produktet dhe artikujt që mund t'i blejnë konsumatorët, që të jenë të sigurta në treg. Në përgjithësi objektivi kryesor i Inspektoratit të Tregut, ka qenë kontrolli në SIGURINË E PËRGJITHSHME TË PRODUKTEVE : afatin e përdorimit , deklaracionet, etiketa e vendosur në produkte, kushtet e ruajtjes sipas llojit të produkteve, flamuri i origjinës së produktit.

### Inspektorati i ndërtimit

Gjatë kësaj periudhe, Inspektorët e Ndërtimit kanë kryer inspektime në bazë të ligjit dhe rregulloreve që janë në fuqi për fushën e ndërtimit. Për këtë periudhë janë kryer inspektime lidhur me ndërtimet e objekteve të ndërtimit të lartë dhe të ulët, duke kontrolluar terrenin e komunës së Vushtrisë, ndërprerjen e të gjitha ndërtimeve pa leje, kontrollimin e objekteve me leje ndërtimi, rrënimin e objekteve pa leje.

### Aktivitetet

- Në kuadër të kontrollimit të terrenit, janë përpiluar procesverbalet dhe Aktvendime për ndërtimet me leje ndërtimi dhe ato pa leje ndërtimi.
- Ndërprerja e ndërtimeve pa leje ndërtimi, ndalimi i punimeve është urdhëruar me afat kohor menjëherë si dhe janë vendosur shirit rrethues të cilët ndalojnë punimet pa leje deri në pajisjen me dokumentacion përkatës të lejes ndërtimore, shumica e ndërtimeve pa leje janë shtëpi banimi, por ka edhe objekte afaristë.
- Kontrollimi i objekteve me leje ndërtimi,

Procesverbalet janë lëshuar për ndërtimet të bëra pa leje ndërtimi dhe pa pëlqime urbanistike, kryesisht për ndërtime të banimit individual, por ka pas edhe raste të ndërtimeve për të cilat kërkohen pëlqimet urbanistike, siç janë: terrasat para objekteve, ndryshimet në objektet ekzistuese me leje ndërtimi, ndryshimet në kulmet e objekteve dhe në fasadat e tyre.

### **Vendime për ndërprerjen e ndërtimeve pa leje ndërtimi**

Vendimet për ndërprerje të punimeve janë lëshuar për objektet që kërkohet leja e ndërtimit por të cilat nuk janë pajisur me leje ndërtimi, vendimet për ndërprerjen të punimeve kanë karakter të urdhëresës së prere për ndërprerje të punimeve deri në pajisje me leje ndërtimi.

### **Gjoha mandatore**

Gjobat mandatorë janë lëshuar në bazë të udhëzimit administrativ për shqiptimin e gjobave mandatorë, për ndërtimet e bëra pa leje dhe pjesëmarrësve në ndërtim si dhe në mbështetje të Ligjit për Kundërvajtje 05/L-087 të cilët kanë punuar në kundërshtim me dispozitat ligjore në lidhje me ndërtimin e objekteve.

Takimet me palë .....	20
Lëndët (kërkesat) e pranuar .....	257
Lëndët e përfunduara .....	255
Lëndët në procedurë .....	2
Ndërprerja e punimeve ndërtimore .....	3



Kërkesat kanë të bëjnë kryesisht me inspektimet rutinë të cilat bëhen nga Investitorët e ndërtimeve me leje ndërtimi për inspektimet e fazave të ndërtimit, prej fillimit të ndërtimeve deri në përfundimi të ndërtimit, ne si drejtori i jemi përgjegjës këtyre kërkesave duke vizituar vend ndërtimit dhe plotësuar kartelën e inspektimit.

Po ashtu ka pasur kërkesa të natyrës së ndryshme të ankesave nga qytetarët të cilët kanë kërkuar inspektime të gjendjeve faktike në terren.

Për të gjitha kërkesat e drejtuar drejtorisë sonë i jemi përgjegjës komfor përgjegjësi dhe kompetencave.

## **Sfidat**

Pavarësisht mbarëvajtjes së punës, në Drejtorinë për Inspektime kemi hasur edhe në sfida të ndryshme të cilat kanë penguar rrjedhën normale të punës, ndër sfidat kryesore të evidentuara janë:

- Mungesa e Planifikimit Hapësinor, Mungesa e Hartës Zonale dhe Planeve Rregulluese të hollësishme, në shumicën e zonës mungojnë planet rregulluese po ashtu pa përputhshmëri e planeve me gjendjen faktike në terren, mangësi të tilla detyrojnë qytetarët të ndërtojnë objekte pa leje ndërtimi.
- Vonesat procedurale në lëshimin e lejeve ndërtimore,
- Pamundësia për tu pajisur me leje ndërtimore ( zona nën komasacion, problemet pronësore, etj.), propozojmë që kuvendi komunal të hartojë rregullore komunale për lehtësimin dhe tejkalimin e këtyre sfidave,
- Kërcënimet dhe sulmet e vazhdueshme ndaj stafit,
- Mungesa e stafit, numri i vogël i inspektorëve
- Mungesa e automjeteve dhe pajisjeve teknologjike për terren,

## **Inspektorati i Komunikacionit - Aktivitete inspektuese :**

Mbikqyrja dhe inspektimi i të gjithë operatorve që merren me veprimtarinë mbi transportin e udhëtarve dhe mallrave të cilat qarkullojnë në territorin e Vushtrrisë;

- Inspektimi i Autotaksive;
- Operatorët "Taksi";
- -Ndermarrjet të cilat mirren me transport të udhëtarve;
- -Ndalimi i operatorve ilegal ,masat e ndermarura ndaj tyre;
- -Ndalimi i kombi busve ne relacionin Vushtrri- Prishtine
- -Kushtet teknike të automjeteve;
- -Inspektimin e automjeteve të transportit të mallrave;
- -Kontrollimin e vijave Komunale urbane dhe ndërurbane.

Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës njësia në Vushtrri. Janë kemi kryer edhe inspektime në komunikacionin rrugor magjistarle.

Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar gjithësej : 45 procesverbale , 36 vendime dhe urdhëresa për ndalim të veprimtarisë gjoba mandatore .

Duke analizuar gjendjen faktike në Drejtorinë për Inspektime përkatësisht në sektorin e Komunikacionit si rekomandime kryesore që do të ndikoni në performancë janë:

- Rritja e numrit të inspektorëve,
- Profesionalizimi dhe trajnimet adekuate për fushat adekuate të Inspektoratit të Komunikacionit.

## Inspektorati i Shërbimeve Publike

Gjatë punës vjetore 2022 janë ndërmarrë të gjitha masat administrative të nevojshme për arritjen e objektivave të përcaktuara me planin e vitit 2022 sikurse që janë:

- Inspektimi i pastërtisë të qytetit me rrethinë dhe objektet komunale të rrjedhjes së kanalizimeve dhe fekaleve
- Inspektimi i papastërtisë së sipërfaqeve të gjelbëruara publike;
- Inspektimi i papastërtisë rreth objekteve banesore nga hedhurinat e banorëve.
- shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve sa i përket lëmisë se higjienës komunale dhe marrjen e masave administrative në rastet e nevojshme.

Angazhimi për mbikëqyrjen e pastërtisë së qytetit me rrethinë dhe objektet komunale ka qenë në përditshmëri dhe i vazhdimësi po ashtu kemi bërë inspektime dhe mbikëqyrje të rregullta papastërtisë rreth objekteve banesore dhe përcjelljen e hedhjes së hedhurinave të banorëve në kontejnerë . Ne gjithashtu kemi përcjellë mbajtjen e pastërtisë së vitrinave, të lokaleve afariste si dhe në bashkëpunim me inspektorë kemi mbikëqyrur tregun e gjelbër dhe hapësirat publike, rrugët, trotualet rreth tregut. Për konstatimet e bëra kemi lëshuar procesverbale dhe urdhëresa dhe masa tjera administrative me qëllim të ngritjes së cilësisë të higjienës në Komunën tonë .

Angazhime të rregullta kanë qenë edhe në mbikëqyrjen e rrjedhjes së ujit dhe në raste të caktuara kur kemi konstatuar apo me kërkesë të qytetarëve ndonjë rrjedhje uji, kemi urdhëruar KRU-Ujësjetësi – Njësia Vushtrri për të bërë sanime të menjëhershme.

Të gjitha kërkesat e qytetarëve të cilat i janë drejtuar për Inspektoratin e Shërbimeve Publike – Higjienës janë zgjidhur brenda afateve ligjore.

Me qëllim të realizimit të detyrave jam angazhuar dhe kam bashkëpunuar me Inspektorët e lëmvive të ndryshme varësisht nga kërkesa e Drejtorit të Drejtorisë për Inspektime Kemi 82 shënime zyrtare, janë dorëzuar, raporte ditore dhe javore .

Nga inspektimet-konstatimet të përpiluara, janë hartuar 39 procesverbale, 85 urdhëresa dhe 5 gjoba mandatorë si dhe njoftime për palët dhe komunikime tjera me Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

## GJEODEZI KADASTËR DHE PRONË

Gjatë periudhës raportuese janë kryer këto punë:

Nr. Rend.	LENDET E ARRITURA Janar- dhjetor 2022	Gjithsejtë
1.	KERKESAT E ARRITURA	<b>9221</b>
2	AKTVENDIME PER BARTJE TE PRONES	<b>1694</b>
3.	AKTV. PER PERMIRESIM TE EMRAVE NE RDPP	<b>185</b>
4.	AKTVENDIME PER REGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	<b>122</b>
5.	AKTVENDIME PER CREGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	<b>103</b>
6.	VERTETIME-CERTIFIKATA TE NDRYSHME	<b>353</b>
7.	NDARJE DHE BASHKIM TE PARCELAVE	<b>620</b>
8.	INQIZIMI I GJENDJES FAKTIKE	<b>41</b>

9.	REGJISTRIM DHE FSHIRJE E BARRES TATIMORE	4
10.	KOPJE TE PLANIT	810
11.	LISTA POSEDUESE	2501
12.	KERKESA ZYRTARE TE NDRYSHME	152
13.	REGJISTRIM DHE FSHIRJE E MASES SE SIGURISE	10
14.	LENDET NE PROCEDURE	38
15	Kërkesa tjera(identifikim, dalje ne teren, ankesa etj).	210

Në periudhën Janar-dhjetor 2022 kemi pranuar 1694 kërkesa për regjistrimin e bartjes së pronës. Pas zhvillimit të procedurës administrative dhe studimit të lëndëve ky shërbim ka marr 1652 aktvendime me të cilat janë miratuar ose refuzuar kërkesat e palëve, kurse në procedurë administrative për vendosje për vitin 2023 kanë mbetur 42 kërkesa (lëndë). Kemi pranuar nga ana e palëve – qytetarëve 185 kërkesa për korrigjimin e gabimeve sa i përket emrit apo mbiemrit në regjistrat e pronave, të cilat gabime kanë pasuar nga e kaluara. Pas zhvillimit të procedurës administrative janë aprovuar 170 kërkesa të tilla ndërsa 15 prej tyre janë refuzuar. Këto kërkesa në lidhje me korrigjimin e emrit apo të mbiemrit bëhen pa pagesë.

Poashtu kemi pranuar 122 kërkesa për regjistrimin e hipotekave dhe 103 kërkesa për çregjistrimin e hipotekave, të paraqitura nga personat fizik dhe juridik. Pas zhvillimit të procedurës kemi marr 122 aktvendime për regjistrimin e hipotekave dhe 103 aktvendime për çregjistrimin e hipotekave, 2501 certifikata pronësore dhe 810 kopje të planit si dhe kemi aprovuar kërkesa zyrtare të ndryshme të parashtruara nga ana e organeve komunale, gjyqësore, institucioneve qeveritare dhe joqeveritare etj.

### **MBROJTJE DHE SHPËTIM**

Gjatë vitit 2022 DMSH ka pasur angazhime të rregullta por edhe raste emergjente veçanërisht me vërshime dhe fatkeqësi tjera ku edhe kemi intervenuar me kompaninë e kontraktuar “ËËENDA”për angazhim në situata emergjente në terren për eliminimin e disa pikave kritike .

Me qëllim të parandalimit të rrezikut dhe minimizimin e pasojave nga vërshimet eventuale, kjo Drejtori ka marrë masat e duhura duke angazhuar Kompaninë Kontraktuese për hapjen, deblokimin, zgjerimin dhe funksionalizimin e lumenjve, proçkave, kanaleve kulluese dhe lëshesave të ujit aktivitet i cili ka rezultuar mjaft efikas dhe ka ndikuar në masë të madhe në parandalimin e vërshimeve.

Gjatë verës gjegjësisht në qershor, gusht dhe shtator jemi ballafaquar me të reshura të dendura, rrebeshe shiu, shtrëngata dhe breshër e që ka rezultuar me dëme të konsideruara në pronat bujqësore të fermerëve .

Dëmet më të theksuara janë shënuar në fshatrat; Strovç, Beqk, Mihaliq,Gllavotin,Bivolak si dhe në fshatrat Ceceli, Kunovik, Kurillovë Vesekovç , Pestovë, Stanovç etj.

Fermerët e dëmtuar nga kanë parashtruar kërkesë për vlerësim të dëmeve të cilët i ka vizituar Komisioni Komunal për vlerësim të dëmeve. Pas vizitave në familje , parcela bujqësore dhe prona të dëmtuara dhe pas konstatimeve individuale- raporteve individuale komisioni ka vlerësuar se janë shkaktuar dëme në vlerë prej 195.373.58 euro.

Moti i keq me reshje të dendura të shiut mbretëroi edhe në mesin e dytë të Nëntorit 2022 veçanërisht më 20,21 dhe 22 nëntor si dhe në fillim të dhjetorit ku për pasojë një pjesë e territorit të komunës u përmbyt nga ujërat si dhe u shkaktuan vërshime të cilat përveç dëmeve materiale nuk kishte dëme në njerëz..

Lumenjtë kryesor dhe disa prroçka ma të vogla dolën nga shtrati ku për pasojë shumë prona, shtëpi banim dhe anekse shtëpish, prona bujqësore dhe ferma u vërsjuan nga uji.

Dëmet më të theksuara janë shkaktuar në fshatrat buzë lumit Silnica afër kanalit kullues dhe proçkës së Sfaracakut cili për shkake të akumulimit të lartë të ujërave ka dalë nga shtrati dhe ka vërsjuar magjistralen Prishtinë Mitrovicë si dhe pronat bujqësore nën këtë Magjistrale.

Me qëllim të evitimit të rrezikut dhe kthimin e normalitetit është angazhuar Kompania Kontraktuese për Intervenime në raste emergjente e cila ka bërë ndërhyrjen e nevojshme për të krijuar mundësinë e derdhjes së ujrave në lumin e Studimës.

Me këtë rast janë eliminuar të gjitha barrierat, gypat dhe fytyt e ngushta e që ka rezultuar me evitimin e rrezikut dhe kthimin e normalitetit në atë pjesë.

Ekipet e Shpëtimit në koordinim të plotë me Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim janë vu në gjendje gatishmërie dhe kanë punuar në terren për identifikimin e faktorëve , ndihmën, shpëtimin dhe lehtësimin e përballimit të kësaj situatë.

Për shkak të gjendjes së krijuar është dashtë edhe intervenimi i ekipeve shpëtimtare të përkratura, Njësia e Zjarrfikësve, Policia e Kosovës dhe ekipet vullnetare të cilat janë angazhuar në mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve të rrezikuar nga vërshimet. Gjithashtu përveq Operatorit të Kontraktuar nga Komuna për Intervenime në raste Emergjente ,janë angazhuar edhe shumë Kompani Vullnetare të cilat me mekanizmin e tyre kanë ndihmuar në sanimin e dëmeve dhe minimizimin e pasojave.

Për shkake të sasisë së madhe të ujit dhe rritjes së lumenjve Llap dhe Drenica, ka qenë rrezik të del nga shtrati por duke pasë parasysh angazhimin dhe intervenimin me kohë lumi Slnica nuk ka dalë nga shtrati me përjashtim në disa pika më të ulta e që në shumicën e rasteve shkaktare ka qenë dëmtimi i argjinaturave të shtratit të këtij lumi.Me një angazhim maksimal është arritë që kjo argjinatura të mbyllet dhe të ndërpritet e ujit jashtë argjinaturave .

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim në Koordinim të plotë me Kryetarin e Komunës (i cili me kohë ka formuar Shtabin Emergjent dhe i cili Vazhdimisht ka qenë në teren dhe ka koordinuar punët dhe aktivitetet), Policinë e Kosovës, Njësinë e Zjarrfikësve, Shoqatën e Peshkatarëve, duke vizituar të gjitha pikat kritike dhe duke ofruar ndihmë dhe Intervenim sipas nevojës.

Sipas vlerësimit preliminarë të realizuar nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim dëmet nuk konsiderohen të jenë relativisht të mëdha.

Pas kalimit të fazës emergjente dhe rënjes së nivelit të ujit , zyrtarët e DMSH-së dhe komisionet kanë dalë në teren dhe kanë evidentuar pronat, tokat bujqësore, infrastrukturën dhe objektet e banimit të cilat janë dëmtuar nga këto vërshime .

Sipas komisionit janë përmbytë rreth 70 hektar tokë bujqësore prej të cilave rreth 27 hektar të mbjella me grurë dhe kultura tjera vjeshtore.

Janë dëmtuar apo kanë pësuar dëme materiale në shtëpi dhe anekse banimi rreth 30 shtëpi banimi kryesisht në qytetin e Vushtrrisë , por edhe në fshatrat Samadrexhë, Ceceli, Ropicë, Nadakovc, Pestovë, Stanovc, Sllakovc, si dhe qytetin e Vushtrrisë.

Është dëmtuar infrastrukturë rrugore e rendit të katërt si dhe një sipërfaqe e konsideruar e rrugëve të asfaltuara. Komisioni Komunal për vlerësimin e dëmeve janë në proces të vlerësimit dhe në bazë të vlerësimeve preliminarë vlerësohet se dëmet janë tejet të larta .

Komisioni ka grumbulluar të gjitha informatat dhe ka vizituar familjet të cilat kanë paraqitë kërkesë për vlerësim , ku deri në mbylljen e afatit për aplikim datë 30.11.2022 kanë aplikuar gjithsejtë 24 persona.

Komisioni është në fazën e përlogaritjes dhe vlerësimit përfundimtarë.

Me gjithë problemet e paraqitura konsiderojmë se Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim me përgjegjësinë më të madhe ka ndërmarrë të gjitha masat, procedurat dhe aktivitetet e duhura, duke azhurnuar dhe mundësuar realizimin e Planit të veprimit për menaxhim të situatës në terren dhe se angazhimet e kompanive dhe akterve tjerë relevant kanë qenë në përputhje me kërkesat e drejtorisë dhe nevojave të qytetarëve për t'u siguruar qëndrim nëpër shtëpitë e tyre dhe lëvizje të lirë. Konsiderojmë se menaxhimi i situatës në terren është kryer me mjaft sukses.

## Njësia e Zjarrfikësve

### PASQYRA E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË ZJARREVE

2022	Zjarrë në Objekte ndërtimore					Zjarrë në Objekte ekonomike				Zjarre në Paisje elektrike				Zjarrë në Sipërfaqe të hapura				Zjarre në Aut.	Gjithëse j	
	Banesa / shtëpi	Objekte ndimse	Plevica - Shtalla	Objekte kolektive	Oxhaqe	Të tjera	Publike	Objekte Biznesi	Objekte Industriale	Të tjera	Pajisje elektrike	Pajisjet shpërndarëse	Gjeneratora	Të tjera	Mal	Bari i that	Sipërfaqe bujqësore	Të tjera		Automjete motorrike
Janar	2				1					1	2			1				6		13
Shkurt					1						2			4	7			4		18
Mars	1		1		2						2			11	23			4	1	45
Prill	2	1			1						2			8	1			5	1	21
Maj		1				1					3				2			7		14
Qershor	3					2			2		5				3			15		30
Korrik	2	3				1				1	4			8	60			15	1	95
Gusht							2				3	1		3	45	1		12	1	68
Shtator															1			2	2	5
Tetor						1				1	2				1			5	2	12
Nëntor	1								1		1				1			4	2	10
Dhjetor					1						1							2	1	5
Total	11	5	1		6	5		2	3	3	26	1	0	35	144	1		81	11	336

#### Gjendja e përgjithshme e mbrojtjes –parandalimit nga zjarri në K.K. –Vushtrri.

Sa i përket gjendjes së përgjithshme të sigurisë mbrojtjes nga zjarri në rajonin e komunës së Vushtrrisë me rrethinë mund të thuhet se gjatë këtij viti ka pasur me pakë raste e veqanarisht atyre të zjarreve (fushore- malore) zjarre të shkaktuara nga temperaturat dhe pakujdesia e faktorit njeri .

Zjarrfikësit kanë qenë në gadishmëri të plotë. Kemi pasur mobilizimin e punetorëve me urdër të DMSH si dhe në bazë të rekomandimeve nga qendra –Prishtine për masat shtesë, është bërë shtimi i gatishmërisë në nivel më të lartë dhe automjeti i NJPZSH ka qenë në gjendje gatishmërie gjatë muajit korrik, gusht dhe shtator në zonat fushore- malore.

Eshtë bërë punë dhe përpjekje për parandalimin e shkaktarve të zjarrit, në bashkëpunim me NJPZSH, DMSH në Vushtrri dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me organet tjera kompetente si Policinë, Sektorin e Hetuesisë, gjykatësin hetues, prokurorinë dhe ekspertin e pavarur të elektrikes.

## ZYRA LIGJORE

Gjatë periudhës raportuese, janë kryer këto punë dhe detyra:

- Përfaqësimi i komunës në pesëdhjetë e tri (53) seanca gjyqësore deri më datën 14.04.2022 në Gjykatat e Kosovës.
- Janë ushtruar njëzet e një ankesa (21) kundër aktgjykimeve të shkallës së parë.
- Janë dhënë njëzet e gjashtë (26) opinione ligjore sipas kërkesave të parashtruara .
- Është ushtruar një prapsim(1).
- Janë përgatitë dy (2) informata.
- Kam marrë pjesë në komisione të ndryshme të themeluara nga kuvendi dhe kryetari për hartimin e statutit të komunës dhe rregulloreve komunale.

Në Zyrën Ligjore është i punësuar për momentin vetëm një zyrtar, janë të parapara dy pozita dhe shpresojmë që gjatë vitit 2023 do të bëhet rekrutimi edhe për një zyrtar tjetër, sepse është e pa mundur të kryhen të gjitha punët të cilat kërkohen nga kjo zyrë.

Udhëheqësi i Zyrës Ligjore ka prezantuar në mbledhjet e KPF-së dhe KK-së së Vushtrrisë dhe sipas kërkesave ka dhënë opinione për qeshtëje të ndryshme.

## ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE

Zyra për Integrim Evropian ka punuar intesivisht për përmbylljen e agjendës së planifikuar dhe planit të veprimit për përmbushjen e obligimeve që dalin nga agjenda evropiane për komunën e Vushtrrisë për vitin 2022 gjegjësisht plotësimin e prioritetëve komunale që dalin nga „Obligimet e Komunave nga Agjenda Evropiane 2022” të përgatitur nga MAPL-ja.

### **Prioritet komunale**

Objektiv i “Obligimeve të Komunave nga Agjenda Evropiane 2022” kanë qenë: Administrata publike, Shoqëria civile, të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve, të drejtat e grave dhe barazia gjinore, të drejtat e fëmijëve, Fuqizimi i rolit të femrës në pozita, Lufta kundër trafikimit me qenie njerëzore, përmirësimi i implementimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, mbrojtja dhe promovimi trashëgimisë kulturore, Zvogëlimi i nivelit të ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal, punësimi dhe politikat sociale, politikat e shëndetit publik, ngritja e kapaciteteve institucionale në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Komunitetet RAE, rritja e nivelit të pjesëmarrjes së fëmijëve në institucionet e edukimit parashkollor dhe fëmijët me nevoja të veçanta, etj.

### **Aktivitetet e Zyrës për Integrim Evropian:**

Përgjigjet në pyetësorin e dërguara në MAPL-ja për të gjithë sektorët e komunës për vitin 2022.

Pjesëmarrje në punëtori dhe takime të organizuara nga MAPL me qëllim në përmbushjen e obligimeve të komunës nga agjenda evropiane

Hartimi i raportit të punës për vitin 2022

Takimi i Kolegjiumit për Integrim Evropian në Asociacioni i Komunave të Kosovës Pjesëmarrje në hartimin rregulloreve të ndryshme komunale

Raporti vjetor i planit të integritetit në komunën e Vushtrrisë,

Pjesëmarrje në hartimin e Strategjisë për Komunikim dhe marrëdhënie me Publikun

Pjesëmarrje në takime dhe aktivitetet të shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare të cilat kanë lidhshmëri me angazhimet e komunës në agjendën evropiane

### **Raportimi ne MAPL**

Për çdo gjashtë muaj Zyra për Integrim Evropian iu ka përgjigjur pyetësorëve të dërguar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për zbatimin e detyrave që dalin nga „Obligimet e Komunave nga Agjenda Evropiane 2022”. Po ashtu i jemi përgjigjur edhe pyetësorit të dërguar nga MAPL-ja në fund të vitit në lidhje me obligimet komunale.

### **ZYRA LOKALE E KOMUNITETEVE**

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim ka punuar për 12 muajt e fundit për të ofruar ndihmë për komunitetet joshumicë në zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohen.

Përmes bashkëpunimit të rregullt me të gjitha drejtoritë në komunë, si dhe bashkëpunimit me kryetarin e komunës, kemi arritur të zgjidhim mjaft probleme me komunitetet jo shumicë.

Procesi i kthimit në vitin e kaluar: - nuk kishte familje të interesuara për kthim në territorin e komunës së Vushtrrisë.

Në vitin 2022 është punuar për hartimin e Planit të Veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve për periudhën 2022-2026.

Sa i përket personave të riatdhesuar, në vitin paraprak 2022 kemi pasur 19 raste të cilët kanë kërkuar tju lëshohet vërtetimi se janë kthyer nga vendet ku kanë kërkuar azil, për të aplikuar për projekte individuale pranë Zyrës Komunale të Punësimit. Prej tyre 3 raste janë miratuar nga Komisioni Komunal për Riatdhesim dhe lëndët janë dërguar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, sektori për riatdhesim (ndihma është për pagesën e qirasë).

Në një rast të riatdhesimit, një shtëpi në fshatin Studime e Poshtme ishte rinovuar. Renovimi është bërë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim së bashku me OSBE-në dhe Drejtorinë për Arsim në Komunën e Vushtrrisë kanë ndihmuar qendrën për arsimimin e fëmijëve romë në fshatin Prelluzhë. U ndanë pajisje kompjuterike.

Përfundim,

në këtë raport është paraqitë në mënyrë të detajuar puna dhe aktivitetet e kryetarit – ekzekutivit të komunës brenda vitit 2022 dhe është arritur që në masë të kënaqshme të përmbushen objektivat e përcaktuara në planet e punës për të iu ofruar shërbime sa më cilësore qytetarëve të komunës sonë. Siq e dijmë, viti 2022 ka qenë viti i parë i punës së ekzekutivit pas mandatit të cilin e kemi marrë nga qytetarët dhe ndoshta ka munguar përvoja e duhur të shumica e drejtorëve të drejtorive të cilët me angazhim dhe përkushtim kanë bërë përpjekje për të i përmbushur obligimet e tyre dhe përgjegjësitë ligjore ndaj qytetarëve. Me përvojën e krijuar në periudhën raportuese, tani, në vitin që jemi dhe vitet që na presim si dhe me përkrahjen edhe të juajën si anëtarë të kuvendit do të arrijmë që të jemi në shërbim të qytetarëve për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe mirëqenie të qytetarëve.

Mirëpresim sugjerimet dhe propozimet me rastin e shqyrtimit përkatësisht diskutimeve të këtij raporti në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe kuvend.

**Ferit Idrizi**


  
Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS-KOMUNA VUSHTRRI



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATE /A:	07.03.2023
REFERENCË:	10 Nr. 191 /23
PËR:	Kuvendi Komunal- Vushtri
NGA/:	Drejtori i DKA-së, Dardan Abazi 
TEMA:	Informatë për përfundimin e gjysmë-vjetorit të parë të vitit shkollor 2022/23



Të nderuar anëtar të Kuvendit Komunal,

Me kënaqësi ju paraqesim këtë informatë mbi përfundimin e gjysmë-vjetorit të parë të vitit shkollor në shkollat e komunës sonë. Do të dëshironim t'ju falenderojmë për interesimin tuaj të vazhdueshëm për sektorin e arsimit dhe për mbështetjen tuaj në përpjekjet tona për të siguruar arsimin më të mirë të mundshëm për nxënësit tanë.

Gjysmë-vjetori i parë i vitit shkollor ka qenë një periudhë e suksesshme dhe produktive për shkollat tona. Jemi krenarë të raportojmë se shkollat tona arritën rezultate shumë të mira në garat ndër-komunale, duke treguar talentet dhe aftësitë e nxënësve, mësimitdhënësve dhe administratorëve tanë.

Procesi i arsimit vazhdoi në këtë gjysmë-vjetor për të sjellë suksese dhe rezultate që do t'i ndajmë në këtë informatë. Progres u shënua edhe në rritjen e bashkëpunimit të shkollave me donatorët dhe bashkëpunimit me organizatat jo-qeveritare e po ashtu edhe në rritjen e kapaciteteve të drejtorëve të shkollave dhe stafit përmes trajnimeve dhe pjesëmarrjes në aktivitete jashtë-shkollore.

Megjithatë, duhet të njohim edhe sfidat që hasëm gjatë këtij gjysmë-vjetori. Shkollat filluan mësimin një muaj më vonë se zakonisht për shkak të grevës së mësimitdhënësve, dhe ka pasur vështirësi në kompensimin e orëve të humbura. Sfida të tjera ka pasur edhe në procesin e rekrutimit fillimisht për shkak të ndryshimeve ligjore sipas Nr. 06/L – 114 për Zyrarët Publik që kërkon periudha më të zgjatura të administrimit të konkurseve. Më tutje, një pjesë e konkurseve kanë dështuar sepse ka pasur më pak se tre kandidat. Kjo ka qenë veçanërisht e theksuar tek profilet e shkencave të natyrës si profile deficitare dhe veçanërisht në konkurset me kontraktim me kohë të caktuar.

Pavarësisht sfidave, ne jemi të bindur se duke vazhduar të fokusohemi në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe duke ofruar mbështetje për studentët dhe mësuesit tanë, ne do të arrijmë rezultate edhe më të mëdha në muajt dhe vitet e ardhshme. Ne besojmë se me bashkëpunimin e të gjitha palëve të interesuara, përfshirë anëtarët e Kuvendit Komunal, prindërit, mësimitdhënësit dhe nxënësit, mund t'i adresojmë me sukses sfidat që na presin.

Në mbyllje, ftojme të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës që të punojnë ngushtë me ne, pasi ne përpiqemi të ofrojmë arsimim sa më të mirë për nxënësit tanë. Së bashku, ne mund të ndërtojmë një të ardhme më të ndritshme për fëmijët e komunitetit tonë dhe të sigurojmë që ata të kenë njohuritë, aftësitë dhe aftësitë e nevojshme për të pasur sukses në një ekonomi globale gjithnjë e më konkurruese.

Sinqerisht,



Dardan Abazi  
Drejtor i DKA-së

## Përmbajtja

I.	Informata të përgjithshme mbi sistemin arsimor në Vushtrri .....	4
II.	Zhvillimet, aktivitetet dhe të arriturat e DKA-së .....	6
2.1.	Garat, aktivitetet dhe të arriturat .....	8
2.2.	Donacionet .....	9
2.3.	Bashkëpunimet me organizata .....	11
2.4.	Trajnimet.....	11
2.5.	Garat sportive.....	12
III.	Suksesi i gjysmëvjetorit të parë 2022/23 .....	13
	Numri i mungesave të gjysmëvjetorit të parë, të vitit shkollor 2022/23 .....	17
IV.	Sfidat.....	18

**I. Informata të përgjithshme mbi sistemin arsimor në Vushtrri**

<b>Numri i përgjithshëm i institucioneve edukativo-arsimore</b>	<b>36</b>
<b>Numri i punonjësve</b>	<b>1141</b>
<b>Numri i nxënësve në gjysmë-vjetorin e parë</b>	<b>12635</b>
<b>Numri i paraleleve</b>	<b>651</b>
<b>Numri i nxënësve djem</b>	<b>6009</b>
<b>Numri i nxënësve vajza</b>	<b>6626</b>

Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri ka menaxhuar mbarëvajtjen e procesit mësimor gjithnjë sipas kalendarit të vitit shkollor. Në këtë periudhë u krijuan vështirësi për mësimin e rregullt pas gjendjes së mbajtës së grevës.


Viti shkollor 2022/23 ka filluar më 3 tetor 2022, pasi që nga 25 gusht 2022 u mbajt greva në të gjitha institucionet arsimore.

▪ Numri i nxënësve në nivele për vitin shkollor 2022/23:

Këto shifra paraqesin numrin e nxënësve të regjistruar në çdo nivel për vitin shkollor 2022/23 në Vushtrri. Ka 1149 nxënës në Nivelin 0, i cili përfshin fëmijë të moshës parashkollore ose çerdheve. Nivelin 1, i cili përfshin klasat 1-5, ka numrin më të madh të nxënësve me 5,077 të regjistruar. Nivelin 2, i cili përfshin klasat 6-9, ka 4022 nxënës të regjistruar. Së fundmi, Nivelin 3, i cili përfshin klasat 10-12, ka 2,387 studentë të regjistruar. Në sistemin arsimor të Vushtrrisë për vitin shkollor 2022/23 janë gjithsej 12635 nxënës.

### Numri i nxënësve sipas niveleve

▪ Nivelin 0    ▪ Nivelin 1 (1-5)    ▪ Nivelin 2 (6-9)    ▪ Nivelin 3 (10-12)



Duke pasqyruar punën e DKA-së, drejtorëve, mësimdhënësve, nxënësve dhe personelit tjetër arsimor, për përfundimin e gjysmë-vjetorit të parë të vitit shkollor 2022/23, ka pasur suksese dhe sfida në përmbushjen e objektivave të përcaktuara, të cilat janë paraqitur në këtë informatë. Këto zhvillime u bënë duke u ndarë detyrat me kohë më qëllim të përgjegjësisë dhe llogaridhënies reciproke.

## II. Zhvillimet, aktivitetet dhe të arriturat e DKA-së

### Aktiviteti 1 – Monitorimi i shkollave:

- Janë zhvilluar monitorime në të gjitha shkollat e Komunës së Vushtrrisë, e që në objektiv kryesor kishin: fushën e menaxhimit dhe qeverisjes së shkollës në funksion të sigurimit të cilësisë.

### Aktiviteti 2 – Takimet e rregullta me partnerët dhe akterët e tjerë

Gjatë gjysmë-vjetorit të parë, u zhvilluan takime të rregullta me partnerët dhe akterët e tjerë të sektorit të arsimit. Këto takime përfshinë:

- Takime të rregullta me Inspektoratin e punës
- Takime të rregullta me Inspektorët Regjional të Arsimit
- Takime të rregullta me KFORIN sloven.
- Takime të rregullta të Asociacionit të Komunave të Kosovës, Kolegjiumi për Arsim;

### Aktiviteti 3 – Vlerësime të performancës

- Ju është vlerësuar performanca 4 drejtorëve të shkollave;

### Aktiviteti 4 – Vlerësime të nxënësve

- Nga ekipi komunal për vlerësimin e nxënësve janë vlerësuar 5 nxënës si dhe rivlerësuar 5 nxënës me nevoja të veçanta arsimore;

### Aktiviteti 5: Aktivitete të Furnizimit dhe prokurimit

- Kontrata të menaxhuara nga zyrtarët e DKA:
  - kontrata për furnizim me material për mirëmbajtje të objekteve,
  - kontrata për furnizim me inventarë zyrtar shkollor,
  - kontrata për furnizim me letër,
  - kontrata për furnizim me shujta ditore për klasat 0-5,
  - kontrata për furnizim me lëndë djegëse ( dru) në shkolla,
  - kontrata e transportit të nxënësve, kontrata për internet;

- kontrata për material zyrtar;

#### Aktiviteti 6 – Projekte të realizuara

- Përurimi i fushës sportive në SHFMU “Migjeni” Stanoc i Epërm;
- Meremetimi i SHFMU “Naim Frashëri” Vushtrri dhe ndërtimi i tualeteve;
- Meremetimi i SHFMU “Adem Voca” Pasomë;
- Meremetimi i SHF “Ali Kelmendi” Vushtrri;
- Meremetimi i SHFMU “Enver Hadri” Smrekonicë;
- Meremetimi i SHFMU “Rexhep Musa” Mihaliq
- Meremetimi i SHMU-1 Vushtrri;
- Meremetimi i SHFMU “Hajrullah Shala” Akrashticë;
- Përurimi i fushës sportive në SHFMU “Bajram Curri” Dumnicë e Mesme;
- Vendosja e kubëzave të betonit në SHFMU “Naim Frashëri” Vushtrri;
- Vendosja e kubëzave të betonit në SHF “Mustafë Venhari” Vushtrri;
- Rregullimi i rrethojave dhe hyrjes së oborrit të SHFMU “Migjeni” Stanoc i Epërm;
- Janë furnizuar shkollat me 138 llaptopë, 52 kompjuterë dhe 54 monitorë;
- Janë furnizuar shkollat me klima: SHFMU “Rilindja” Maxhunaj: me 3 klima, SHFMU “A.Z.Çajupi” Vushtrri; me 10 klima, SHMP” Bahri Haxha” Vushtrri, me 8 klima, IP “Foleja” me 12 klima; SHF “Mustafë Venhari” Vushtrri; me 3 klima, SHFMU “Liria” Stroc; me 1 klimë, SHFMU “Bahri Kuçi” Shtitaricë; me 1 klimë, SHF “Naim Frashëri” Vushtrri; me 3 klima,
- Janë furnizuar me kiflet nxënësve nga klasa parafillor deri në klasën e V-të;

#### Aktiviteti 7 – Ngjarje dhe aktivitete të tjera gjatë gjysmëvjetorit të parë

- Në SHMU-1 Vushtrri, me datë: 18.11.2022 u mbajt tryezë diskutimi, lidhur me temën “Së bashku kundër abuzimit të fëmijëve”;
- Me datë: 18.11.2022, në Galerinë e Arteve të Qendrës së Kulturës në Vushtrri u mbajt ekspozita me vizatime të nxënësve “Së bashku kundër abuzimit të fëmijëve”;
- Me 29 nëntor 2022, nxënësja Albina Aliu e SHMU-1 nga Komuna e Vushtrrisë, pranoi “Diplomë Nderi” nga Ambasadori i Republikës së Çekisë në Kosovë, z.Pavel Bílek;

- Në SHMP “Bahri Haxha” Vushtri, më datë 9 dhjetor 2022, në kuadër të Projektit Ndikimi i Rinisë në Mjedis – YENI i Caritasit Zvicëran në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit- Vushtri, u mbajtë punëtorja me angazhimin e ndërsjellët “Ndërgjegjësimi ndaj Ndryshimeve Klimatike - Freska Klimatike” për Eko klubet e Komunës së Vushtrrisë, përkatësisht të dy shkollave të mesme. SHMP “Bahri Haxha” Vushtri dhe Gjimnazi “Eqrem Çabej” të Vushtrrisë;
- U shënua “Dita e maleve” me dy aktivitete: ligjëratë dhe ekspozitë përkrahur nga Kryetar i Komunës z.Ferit Idrizi si dhe nga DKRS në bashkëpunim më OJQ “Biodiverisiteti” dhe ekoklubet e shkollave të Vushtrrisë;
- Ambasadori i Francës z.Olivier Guérot, vizitoi SHMU-2;
- SHMLP “Bahri Haxha” është përzgjedh si shkollë përfituese në kuadër të FONDIT RAJONAL TË SFIDAVE” RCF ku kanë marrë pjesë rreth 200 shkolla nga 6 vende të Ballkanit (projekti i cili pritet të zbatohet në këtë vit është në vlerën rreth 400 mijë euro);
- Në SHFMU “Liria” Stroc është duke u zbatuar projekti: “Të rinjtë dhe pasurimi i jetës kulturore përmes stop motion animacioneve” I përkrahur nga MKRS-ja dhe i implementuar nga “FORUMI PËR INTEGRIM SOCIAL” 14.01.2023 ( përmes krijimit të filmit vizatimor dhe pikturave nxënësit shfaqin monumentet e trashëgimisë kulturore të komunës së Vushtrrisë)Krijimi i Muzeut në shkollën tonë me artefakte të gjetura në këtë lokalitet dhe jo vetëm, përkrahur nga MKRS dhe implementuar nga OJQ “ Gjurmët”;

#### Aktiviteti 8 – Puna me palë

Gjatë gjysmëvjetorit të parë, DKA ka shqyrtuar qindra kërkesa të qytetarëve dhe ka punuar ngushtë me ta për adresimin e tyre.

- Në protokollin e hyrjes janë regjistruar 136 shkresa;
- Në protokollin daljes janë regjistruar 436 shkresa;
- Në intranet janë regjistruara 477 kërkesa dhe janë shqyrtuar 477;

#### **2.1. Garat, aktivitetet dhe të arriturat**

- Në garat komunale për esenë më të mirë, me rastin e Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, nxënësja e SHMU-1 Adonisa Zeqiri, ka zënë vendin e parë;
- SHMU 2- Vushtrri, ka zënë vendin e parë në Olimpiadën e Matematikës në nivel komunal;
- SHMU-2, ka zënë vendin e parë në Kosovë në garat e diturisë “Eureka 10” organizuar nga gjimnazi “Hasan Nahi” Prishtinë;
- SHMP “Bahri Haxha” Vushtrri ka zënë vendin e parë në pikturë në nivel komunal, nxënësja Fazile Murati kl. XII/4;
- SHFMU “Liria” Stroc: ka zënë vendin e parë me pikturë në ekspozitën “Së bashku kundër abuzimit të fëmijëve”, të organizuar nga Komuna e Vushtrrisë, me përkrahjen e Kryetarit të Komunës, z.Ferit Idrizit dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit në bashkëpunim me organizatën KEC – Qendra për Arsimin e Kosovës, me qëllim të shënimit të 19 Nëntorit, “Ditës Ndërkombëtare për Parandalimin e Abuzimit me Fëmijë”;
- SHFMU “Liria” Stroc, shënoi javën e kulturës më 21.11.2022 deri 25.11.2022, pjesmarrës Daut Demaku, ndërsa nga Karvani i shkrintarëve “Agim Deva” morën pjesë: Agron Mulliqi – piktorë, Bleonita Duraku – Fotografe, Ard Gashi- këngëtarë;
- Gjimnazi “Eqrem Çabej” Vushtrri: në garat komunale në lëndën e Matematikës mori vendin e parë për klasat 10, 11 dhe 12;

## 2.2. Donacionet

- Më 4 tetor 2022, pranuar donacion nga Raiffeisen- Bankë, për shkollat: SHFMU "Adem Voca" Pasomë: 51 çanta, SHFMU "Azem Bejta" Dubofc: 65 çanta, SHFMU "Mustafë Shyti" Oshlan: 75 çanta, SHFMU "Hajruallah Shala" Akrashticë: 65 çanta, SHFMU "Dëshmorët" Zhilivodë: 30 çanta, gjithsej 259 çanta;
- Shoqatat humanitare ”Bosporus” – Holandë, ka rinovuar shkollën: SHFMU “Hajrullah Shala” në Akrashticë;
- Shoqata “Mira”-Holandë, ka rinovuar SHFMU “Martiret” në Reznik;
- Nuredin Gubetini ,veteran i Arsimit dhuroi donacionin e djalit të tij Shqiptar Gubetini nga Gjermania 2 smart tv për Shkollën e Muzikës në Vushtrri;
- Bashkatdhetarët tanë në Amerikë z.Afrim Shabani bashkë me përfaqësuesin e grupit të donatorëve, z. Muhamed Beluli dhe, ndërmjetësuesit z. Artan Hasani dhe znj. Arbenita



- Hasani, pasuruan nototekën për Shkollën e Muzikes Vushtrri me literaturë të ndryshme muzikore për shkollën e muzikës;
- SHFMU- Pestova, pranoi donacion: 6 TV nga prindërit e kësaj shkolle si dhe 30 libra nga organizata KEC- Qendra për Arsim e Kosovës;
  - SHFMU “Migjeni” Stanoc i Epërm: ka pranuar donacion 2 pako të ndihmës së parë nga Idriz Sadiku, pronar i barnatores “Shqiproni pharm”;
  - SHFMU “Bahri Kuqi” Shtitaricë, pranoi donacion nga Kompania “BERISHA” Sh.P.K ka ndihmuar shkollën për rrafshim dhe zbukurim të oborrit të shkollës. Organizata Austriake “KOSOVO Hilfe” me seli në Austri dhe mërgimtari nga fshati Balinicë z. Avni Pllana ka dhuruar fanella për klubet e shkollës si për Klubin e Gjelbër dhe për aktivitetet sportive. Poliklinika “BENI” me seli në qytetin e Vushtrrisë dhe drejtori i kësaj poliklinike z. Arben Pllana ka kompletuar kutinë e ndihmës së parë dhe 50Euro për zërim të shkollës. Kompania “LONI PARK” SH.P.K, ka dhuruar vazo për lule për të zbukuruar ambientin e jashtëm të shkollës;
  - SHFMU “12 Qershori” Mihaliq; ka pranuar donacion me vlerë 350 euro raftet e mësimdhënësve në sallën e arsimtarëve nga komuniteti;
  - SHFMU- Nedakoc: dollapët për libra për nxënësit, vlera 600 euro (nga mësuesja Afërdita Gërxhaliu-Krasniqi). Ulëset për oborrin e shkollës, vlera 500 euro , nga “Duli Bau Menxhiqi”. TV për klasën e tretë, vlera 200 euro, nga mësuesja Dorarta Shabani;
  - SHMU-2: Investim nga prindërit në inventarin e një klase në vlerë prej 2340 € si dhe donacion për bibliotekën e shkollës prej 55 librave nga shkrimtari Bedri Tahiri ; Donacion nga SPEEEX, shkopinj për mbledhjen e mbeturinave të ndryshme;
  - SHFMU “Liria” Storc: Ndihma e parë dhuruar nga Barnatorja “PENTAGONI” me pronar Burim Behrami si dhe dhurata me rastin e festave të fundvit nga bashkatdhetarët z. Rrahim Hasani dhe Adem Ademi, vlera 300 euro;
  - SHF ”Mustafë Venhari” Vushtrri: ka marrë donacion nga mërgimtari Sokol Zejnullahu me vlerë prej 1000 euro ku shkolla është pajisur me 2 TV dhe fotokopjues;
  - SHFMU “Emin Duraku” Novolan: mërgimtari Abdullah Kovaci, materiale për shkollën në vlerë prej 300 euro ( letër, hamera, etj). Kompania “Deti Com” me pronar Ismet Zymberi ka dhuruar vireless për shkollën;

- SHFMU “Mustafë Shyt” Oshlan , shkrimtarë nga Vushtrria i dhuruan shkollës 305 libra për bibliotekë më vlerë 1615 euro
- SHFMU “Jusuf Gërvalla” :Vendosja e i shkallëve metalike të pjerrësisë me Donator ;Komuniteti i fshatit në vlerë prej 1000 euro;
- SHFMU “Hajrullah Shala” Akrashticë: familja e Hajrullah Shalës ka investuar 3000 euro në heqjen e drunjëve joproduktiv dhe zëvendësimin e tyre me drunjë dekorativ;

### **2.3. Bashkëpunimet me organizata**

- SHMP “Bahri Haxha” Vushtrri: Shkëmbimi i përvojave dhe krijimi i urave të bashkëpunimit me shkolla nga rajoni - vizita të ndërsjella me SHMQSH “Marija Kiri Skllodovska” nga qyteti i Shkupit; shkëmbimi i përvojave për mësimdhënie bashkëkohore në kuadër të projektit SEKOS-2 me mësimdhënës nga Suedia
- Bashkëpunimi me CARITASIN zviceran lidhur me trajnimin e edukatorëve;
- Takim me përfaqësuesit e organizatës up to youth – USAID lidhur me infrastrukturë shkollore;
- Bashkëpunimi për 5 mësuese mbështetëse me shoqatën “Torres Des Homes” ;
- Bashkëpunimi me organizatën gjermane “GIZ” lidhur me çështjen punësimit të rinjve;
- Bashkëpunim me ICMLD rreth projektit MIS 2, edukimi mjedisor në arsimin parashkollor;
- Bashkëpunimi “Internacional Charity” për hapjen e dy puseve njërin në SHFMU “Rilindja” Maxhunaj dhe tjetri në Pestovë;
- Bashkëpunimi me OJQ “VORAE” rreth komunitetit ;
- Bashkëpunimi OJQ ”Koralet” në kuadër të UNICEF për edukatorët;
- Bashkëpunimi me Qendrën Psiko-sociale për trauma terapi “Diakonie Kosova” znj. Albina Koliqi Musliu e cila ju ofroi nxënësve të komunës trajtim falas në këtë qendër dhe në disa shkolla mbajtja e ligjëratave me mësimdhënës;

### **2.4. Trajnimet**

- Më datë: 18, 19 shtator u mbajtë, trajnimi i drejtorëve në programin "Shkollat e Shekullit 21" organizuar nga British Council lidhur me Micro-Bite. Trajnimi i edukatoreve të klasës përgatitore përmes projektit Shpresa të Caritasit Zvicran;

- Trajnim me dt. 11,12 dhe 13 nëntor përmes UNICEF, OJQ”Koralet;
- Në Qendrën për Ngritje Profesionale në Vushtri, në kuadër të projektit nga Qendra për Arsimit e Kosovës -KEC; "Së bashku kundër Abuzimit të Fëmijës". Gjatë dy ditëve të vikendit më 10 dhe 11 dhjetor, u mbajt trajnimi me temë: “Ndërmjetësimi mes bashkëmoshatarëve”, për dhjetë shkollat e Komunës së Vushtrrisë.
- Trajnimi: Edukimi për Qytetari AKTIVE dhe të Drejtat e Njeriut dt.08-10 tetor 2022 (KEC);
- Nxënësit e klasave të nënta (IX) të SHFMU “Bahri Kuqi” Vushtri u trajnuam nga OJQ “ACCESS” për orientim në karrierë;
- Trajnimi i mësimdhënësve për pilotimin e mësimin në vendin e punës (MVP) nga GIZ.
- SHFMU “Liria” Strofc: Trajnimi "Të nxënit përmes përvojës", trajnim ky që u përcjell me mentorime të vazhdueshme nga TOKA në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës, Fakultetin e Edukimit dhe financuar nga Bashkimi Evropian për dy mësimdhënëse.

## 2.5. Garat sportive

Gjatë gjysëmvetorit të parë, DKA u angazhua për mbajtjen e garave sportive në nivel të komunës. Në vijim janë paraqitur sukseset e shkollave në këto gara:

- SHMU-2 Vendi i parë në garat e shahut në nivel komunal;
- SHM-2 Vendi i dytë në garat e shahut në nivel regjional;
- SHMP “Bahri Haxha” Vushtri: vendi i parë në garat regjionale në ping pong (femrat), vendi i parë në garat komunale në ping pong (femrat)
- vendi i parë në garat komunale në Hendboll (meshkujt);
- Garat komunale në Hendboll për Shkollat e Mesme të Ulëta: Shkolla fituese: vendi i parë, SHFMU " Andon Zako Çajupi "- Femra dhe Meshkujt, ndërsa në garat regjionale, Vendi i parë – vajza, Vendi i dytë – djemtë
- SHMU-2 Vendi i parë në garat e ping-pongut për djem në nivel komunal;
- SHMU-2 Vendi i dytë në garat e ping-pongut për vajza në nivel komunal;

### III. Suksessi i gjysmëvjëtorit të parë, viti shkollor 2022/23 klasa 1 - 5, krahasuar me periudhën e njëjtë

Periudha e njëjtë	Shkëlqyeshëm	Sh. Mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pamjaftueshëm	Të panotuar
2022	62.04%	21.81%	12.12%	3.34%	0.66%	0.02
2021	65.83%	20.31%	10.35%	2.85%	0.14%	0
Krahasim	-3.79%	1.50%	1.77%	0.49%	0.52%	2.00%

Shkëlqyeshëm: ka rënë të suksesit për 3.79%


Shumë mirë: ka ngritje të suksesit për 1.50%

Mirë: ka ngritje të suksesit për 1.77 %

Mjaftueshëm: ka ngritje të suksesit për 0.49%

Të pamjaftueshëm: ka ngritje të pamjaftueshmërisë për 0.52%

## Suksesi i I-V



Suksesi i gjysmëvjetorit të parë, viti shkollor 2022/23 klasa 1-5, krahasuar me periudhën e njëjtë

Periudha e njëjtë	Sh.		Mirë	Mjaftueshëm	Të pamjaftueshëm	Të panotuar
	Shkëlqyeshëm	Mirë				
2022	27.50%	22.33%	20.92%	4.34%	24.40%	0.50%
2021	24.65%	21.76%	20.14%	4.11%	28.91%	0%
Krahasim	2.85%	0.57%	0.78%	0.23%	-4.51%	0.09%

Shkëlqyeshëm: ka ngritje të suksesit për 2.85 %


Shumë mirë: ka ngritje të suksesit për 0.57%

Mirë: ka ngritje të suksesit për 0.78 %

Mjaftueshëm: ka ngritje të suksesit për 0.23 %

Të pamjaftueshëm ka rënie për 4.51%

Suksesi i gjysmëvjetorit të parë, viti shkollor 2022/23 klasa 6-9, krahasuar me periudhën e njëjtë



Suksesi i gjysmë-vjetorit të parë, viti shkollor 2022/23 klasa 10-12, krahasuar me periudhën e njëjtë						
Periudha e njëjtë	Sh. Mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pamjaftueshëm	Të panotuar	
2022	11.38%	16.48%	16.33%	7.63%	46.20%	1.97%

2021	9.42%	16.56%	16.27%	2.86%	54.67%	0.17%
Krahasim	1.96%	-0.08%	0.06%	4.77%	-8.47%	1.80%

Shkëlqyeshëm: ka ngritje të suksesit për 1.96 %


Shumë mirë: ka rënie të suksesit për 0.08%

Mirë: ka ngritje të suksesit për 0.06%

Mjafueshëm: ka rënie të suksesit për 4.77%

Të pamjafueshëm: ka rënie të suksesit 8.47%

Suksesi i gjysmëvjetorit të parë, viti shkollor 2022/23, klasa 10-12, krahasuar me periudhën e njëjtë



3.1. Numri i mungesave të gjysmë-vjetorit të parë, të vitit shkollor 2022/23

KLASA	Numri i nx.	Të arsyeshme	Numri mesatar i mungesave të arsyeshme për nxënës	Të paarsyeshme	Numri i mungesave të paarsyeshme për nxënës
Klasa I-V	5077	43259	8.52	8460	1.66
Klasa VI-IX	4022	42199	10.49	11646	2.89
Klasa X-XII	2387	18322	7.67	12900	5.40



#### IV. Sfidat

- Fillimi i gjysmë-vjetorit të parë më vonesë për shkak të grevës së mësimdhënësve dhe vështirësitë për zëvendësimin ditëve të shtunave;
- Zgjatja e procedurave të konkursit sipas ligjit LIGJI NR. 06/L – 114 PËR ZYRTARËT PUBLIKË i cili përcakton 30 ditë qëndron i hapur, pastaj 15 ditë koha për aplikimin e kandidatëve, lista e ngushtë 3 ditë, 2 ditë lista e ftesës për intervistë me shkrim , 3 ditë qasja në teste, 2 ditë ftesa për intervistë me gojë, 8 ditë koha e ankesës komisionit për ankesa. Gjithsej 63 ditë pune kërkohen që të realizohet një konkurs brenda afateve ligjore:
- Dështimi i konkurseve vetëm me një kandidatë (edhe pse është i kualifikuar):
- Mungesa e të kualifikuarve për lëndët shkencore;
- Mungesa e të kualifikuarve për lëndët e IT;
- Mungesa e asistentëve të mjaftueshëm për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore;
- Mungesa e sallave sportive;
- Mungesa e kabinetëve dhe mjeteve didaktike;
- Numri i vogël i nxënësve në shkolla të fshatrave;



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës- Vushtrri

**Për: KPF-në dhe Kuvendin e Komunës**

**Propozues: Ferit Idrizi, Kryetari i Komunës**

**Hartues: Medina Bunjaku, Drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport**

**Lënda: Propozim-vendim**

Bazuar në nenin 13.1. pika "a" të Ligjit mbi Tokën Bujqësore nr.02/L-26, nenit 12.2 "d", 14.1 dhe 17 "c" lidhur me pikën "s" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, si dhe nenin 19, paragrafi 1, pika 4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_ 2023 mori këtë:

## V E N D I M

**Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë**

### Neni 1

Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e lapidarit në fshatit Pasomë pjesë nga parcela kadastrale P-70202050-01296-0 në sipërfaqe prej 613 m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja të përgjithshme prej 89886 m<sup>2</sup>, me kulturë kullosë e kl.4 ZK P e cila evidentohet si pronë e Komunës së Vushtrrisë.

### Neni 2

Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit të patundshmërisë të cekur në neni 1 të këtij vendimi, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi obligohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë që të bëjë ndërrimin e destinimit (kulturës) së kësaj parcele në elaboratin kadastral.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendim obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

### Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Melihate Basholli**

## **A r s y e t i m**

Banorët e fshatit Pasomë, përmes përfaqësuesit të tyre në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë, z. Ali Januzi, i kanë paraqitur kërkesë kryetarit të komunës për mundësinë e ndërtimit të një lapidari në fshatin Pasomë, por edhe sigurimin një parcele kadastrale, në të cilën do të ndërtohej lapidari në nderim të patriotit shqiptar Adem Voca, në fshatin Pasomë.

Pas shqyrtimit të kërkesave, në buxhetin e Komunës së Vushtrrisë është planifikuar ndërtimi i lapidarit dhe është identifikuar vendi ku do të mund të ndërtohej ai lapidar, pasi që prona në të cilën është propozuar nga banorët por edhe nga ekipi i zyrtarëve komunalë që kanë dalë në terren për të parë vendin e propozuar është pronë e Komunës së Vushtrrisë, në zonën kadastrale në Pasomë.

Duke vlerësuar se në atë vend kishte qenë më herët edhe kulla e patriotit shqiptar Adem Voca, edhe komisioni i caktuar nga komuna e Vushtrrisë për vlerësimin e atij vendi ka mbështetur propozimin dhe ka bashkëngjitur edhe dokumentet e nevojshme që anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, të kenë mundësinë t'i shohin.

Prandaj Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport kërkon nga Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë që ta mbështesë këtë propozim-vendim, me të cilin nga parcela kadastrale P-70202050-01296-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 89886 m<sup>2</sup>, me kulturë kullosë e kl.4 ZK P e cila evidentohet si pronë e Komunës së Vushtrrisë, sipërfaqja prej 613 m<sup>2</sup> caktohet për ndërtimin e lapidarit për Adem Vocën.

*Bashkëngjitur me këtë propozim-vendim, keni dokumentet dhe shkresat e nevojshme për çështje në fjalë:*

- certifikatën e pronës
- kopjen e planit
- dy fotografi të pjesës së parcelës që planifikohet për ndërtim të lapidarit

**Drejtoreshë e DKRS-së**

  
**Medina Bunjaku**



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70202050-01296-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

18-3780/22

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

30.09.2022 - 10:48

Komuna / Opština / Municipality:

VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Pasomë / Pasomë / Pasomë

Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70202050-01296-0	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		89886			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvaño Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On
SUVI BREG			

## A.2 LLOJII I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> ) (m <sup>2</sup> ) (m <sup>2</sup> )
1	Bujqësore/Pojiprivredno/Agriculture	Kullosaj/Pashnjac/pasture	Kullosë E Klasës 4/Pashnjak 4 Klasse/4th Class Pasurje	99886

## B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Te drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postaj Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Përshkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Lidhëdhëna Drzavina / Single possessor	Komuna e Vushtrisë	600335001	VUSHTRRI / VUSHTRRI / VUSHTRRI /		AHMET KRASNIQI	1/1		






REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
 MINISTERIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS  
 MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE  
 MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

1815780

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VUSHTRRI  
 Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Pasomë



Shkalla/Razmera/Scale: 1:6016

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 30.09.2022


Koha/ Vreme/ Time: 10:51:55

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:











**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Komuna e Vushtrrisë**  
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



**Për:**  
**Propozues:**  
**Hartues:**  
**Tema:**

Kuvendin e Komunës  
Kryetari i Komunës  
DEBPZHR  
Propozim – vendim

Bazuar në nenin 12 paragrafi 2 pika “d” lidhur me nenin 17 pika “s” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040/2008, neni 19, paragrafi 1.4. të statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me \_\_\_\_\_ 2023, merr këtë:

**VENDIM**

**PER KORRIGJIMIN E VENDIMIT TE KUVENDIT TE KOMUNES SE VUSHTRRISE  
ME NR.01.49/20 I DATES 27.02.2020**

1. Me këtë vendim korrigjohet pika 1.1 dhe 1.2 e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01 nr.49/20 i datës 27.02.2020 për dhënien në shfrytëzim me kompensim të vend gjuetive të përbashkëta ashtu që bëhet korrigjimi i sipërfaqes si në vijim:

1.1. Shalë ..... 19,485.00ha

1.2. Çyqavica.....12,878.67ha

2. Pjesët tjera të vendimit me numër të protokollit 01.nr.49/20 i datës 27.02.2020 mbesin në fuqi.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: harta për zonën e Shalës dhe zonën e Çyqavices.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen : Kryetari i Komunës, Drejtoria për Prokurim dhe Drejtoria për Ekonomi , Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

5. Ky Vendim Hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) dit pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Melihate Basholli-Latifi

---

Kryesuese e Kuvendit të Komunës

### **ARSYETIM**

Me vendimin me numër të protokollit 01.nr.49/20 i datës 27.02.2020 për dhënien në shfrytëzim me kompensim të vend gjutive të përbashkëta, është evidentuar një gabim teknik sa i përket sipërfaqes së tokës e cila është dhënë në shfrytëzim ashtu që në zonën e Shalës sipërfaqja është 197.85.00 ha, ndërsa duhet të jetë 19,485.00 ha, kurse në zonën e Çyqavices sipërfaqja prej 128.78,67 ha duhet të korrigjohet në sipërfaqe prej 12,878.67 ha.

Nga të cekurat me larte i propozojmë Kuvendit të Komunës së Vushtrisë që ta aprovoj këtë propozim –vendim si në dispozitiv në mbledhjen e datës .....

Me respekt;

**Ergin Sunguri**

---

Drejtor i DEBPZHR



Republika e Kosovës

49/20  
-1-  
27.02.2020



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, lidhur me nenin 34 të Ligjit Nr.02/L-53 për Gjuejinë, nenit 3 të Udhëzimit Administrativ nr.06/2009 për Dhënie në Menaxhim të Vendgjuetive të Përbashkëta dhe nenin 40, paragrafi 2, pika "k" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë 27 shkurt 2020 mori këtë:

**VENDIM  
PËR KORRIGJIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË  
VUSHTRRISË ME NR.01. 84/18, I DATËS 29.3.2018**

1.Me këtë vendim korrigohet pika 1.1 dhe 1.2 e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr.01. 84/18 i datës 29.3.2018 për dhënie në shfrytëzim me kompensim të vendgjuetive të përbashkëta, ashtu që të bëhet korrigjimi i sipërfaqes si në vijim:

1.1. Shalë.....194.85,00 ha  
(Njëqind e nëntëdhjetë e katër hektarë e tetëdhjetë e pesë ari)

1.2. Çyqavica.....128.78,67 ha  
(Njëqind e njëzet e tetë hektarë e shtatëdhjetë e tetë ari e gjashtëdhjetë e shtatë metra katror)

2. Pjesët tjera të vendimit me numër të protokollit Nr.01. 84/18 i datës 29.3.2018 mbesin të pandryshuara.

3. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë: harta për Zonën e Shalës dhe Zonën e Çyqavicës.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Prokurimit dhe Drejtorja për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit





REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA VUSHTRRI

<b>DATË/A:</b>	15.03.2023
<b>PËR/ZA/TO:</b>	KPF dhe Kuvendin e Komunës
<b>PËRMES</b>	Ferit Idrizit, Kryetar i Komunës <i>[Signature]</i>
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Isuf Jashari Drejtor për Buxhet dhe Financa <i>[Signature]</i>
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Bartja e të hyrave Vatanake nga viti 2022 në vitin 2023 në shumë totale 2,733,627.37€

Të nderuar anëtarë të KPF-së dhe KK-së. Drejtorja për Buxhet dhe Financa ka përgatitur propozim vendimin dhe planin e bartjes e të hyrave vetanake të bartura nga viti 2022 në vitin 2023 duke u bazuar në Ligji Nr.08/L193 Nenit 9 Mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023.

Bartja e të hyrave vetanake të viti 2022 në vitin 2023 në shumë totale 2,733,627.37€, në :

Kategoritë ekonomike:

Paga dhe mëditje.....	10,000.00€
Mallra&shërbime.....	1,006,430.81 €
Shpenzime komunale.....	10,000.00€
Subvencione dhe Transfere.....	170,100.00€
Investime kapitale.....	1,537,096.56€
<b>Totali.....</b>	<b>2,733,627.37€</b>



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Për: Kuvendin e Komunës

Propozues: Kryetari i Komunës z.Ferit Idrizi

Hartues: Zyrtari Kryesor Financiar, z.Abit Abiti

Çështja për trajtim: Propozim-vendim

Bazuar në nenin 6, pika 2 të Ligjit Nr. 08/l-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 19, paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe duke ju përgjigjur kërkesës së MAPL-së për rishqyrtimin e vendimit Nr.95/22, për trajtimin e kësaj çështjeje në Komitetin për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_ 2023, merr këtë:

#### VENDIM

#### PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE NGA VITI 2022 NË VITIN 2023

1. Me këtë vendim bëhet bartja e të hyrave vetanake për vitin 2022 në vitin 2023 në kategoritë si në vijim:

1.1 Paga dhe Mëditje .....	10,000.00 €
1.2 Mallra dhe shërbime .....	1,006,430.81 €
1.3 Shpenzime komunale.....	10,000.00 €
1.4 Subvencione dhe transfere.....	170,100.00 €
1.5 Investime kapitale.....	1,537,096.56 €

**Totali i mjeteve të bartura.....2,733,627.37 €**

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operacionale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

---

**Kryesuese e Kuvendit**

## **Arsyetim**

Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka përgatitur planin e bartjes e të hyrave vetanake të bartura nga viti 2022 në vitin 2023, bazuar në kërkesat e menaxhmentit duke bërë shpërndarjen në kategoritë ekonomike të Pagave, Mallra&Shërbime, Shpenzime Komunale, Subvencione dhe transfere, si dhe Investime Kapitale, duke u bazuar në Ligjin Nr.08/L193 Nenet 9 Mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023.

Analitika e mjeteve për bartje është e specifikuar më lart sipas kategorive ekonomike, programe dhe projekte.

  
Abit Abiti  
Zyrtar Kryesor Financiar



## Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023

### Komuna e Vushtrrisë


Nën/Programi	Kodi i nën-programit	Kodi FunkSIONAL	Fondi Burimor	Kategoria ekonomike	Nën kategorit ekonomike (zërat)	Kategoria	SHUMA PËR BARTJE
Zyra e Kuvendit Komunal	16924	0111	22	11		Paga dhe meditime	10,000.00
<b>Paga dhe meditime</b>							<b>10,000.00</b>
Zyra e kryetarit	16024	0111	22	13		Mallra dhe shërbime	66,508.00
Administrata -Vuishtri	16324	0133	22	13		Mallra dhe shërbime	22,000.00
Inspeksioni	16647	0411	22	13		Mallra dhe shërbime	3,000.00
Prokuroimi	16820	0133	22	13		Mallra dhe shërbime	842.43
Zyra e Kuvendit Komunal	16924	0111	22	13		Mallra dhe shërbime	1,000.00
Buxhetimi	17524	0112	22	13		Mallra dhe shërbime	2,000.00
Infrastruktura publike	18184	0451	22	13		Mallra dhe shërbime	215,000.00
Menaxhimi i fatkeqsive natyrore	18468	0320	22	13		Mallra dhe shërbime	75,000.00
Planifikimi Urban Inspeksioni-Vushtri	66425	0620	22	13		Mallra dhe shërbime	90,000.00
Administrata shëndetësi	73033	0760	22	13		Mallra dhe shërbime	1,300.00
Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	13		Mallra dhe shërbime	105,983.00
Shërbimet sociale	75616	1040	22	13		Mallra dhe shërbime	950.38
Shërbimet Kulturore	85024	0820	22	13		Mallra dhe shërbime	6,000.00
Administrat-Arsimi	92120	0980	22	13		Mallra dhe shërbime	328,915.00
Arsimi parafillor - Qerdhja	92670	0911	22	13		Mallra dhe shërbime	63,750.00
Arsimi I Mesëm	94890	0922	22	13		Mallra dhe shërbime	24,182.00
<b>Mallra dhe shërbime</b>							<b>1,006,430.81</b>
Infrastruktura publike	18184	0451	22	14		Shpenzimet komunale	10,000.00
<b>Shpenzime komunale</b>							<b>10,000.00</b>
Zyra e kryetarit	16024	0111	22	20		Subvencione dhe transferet	70,000.00
Infrastruktura publike	18184	0451	22	20		Subvencione dhe transferet	10,000.00
Bujqësia	47024	0421	22	20		Subvencione dhe transferet	65,000.00
Administrata	73033	0760	22	20		Subvencione dhe transferet	10,000.00
Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	20		Subvencione dhe transferet	100.00
Administrata	92120	0980	22	20		Subvencione dhe transferet	5,000.00
Shërbimet kulturore	85024	0820	22	20		Subvencione dhe transferet	10,000.00
<b>Subvencione</b>							<b>170,100.00</b>
<b>Kapitale</b>							<b>1,537,096.56</b>
<b>TOTALI</b>							<b>2,733,627.37</b>

Ferit Idrizi



Kryetar i Komunës

Abit Abiti



Zyrtar Kryesor Financiar

**Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023**

Komuna: Komuna e Vushtrrisë								
	Programi	Kodi i nën-programit	Kodi funksional	Fondi Burimor	Kategoria ekonomike	Kodi i projektit	Projektet	BARTJA 2023
1	Administrata - Vushtri	16324	0133	22	30	51814	Ngrohja qendrore për administratën Komunale	15,000.00
2	Administrata - Vushtri	16324	0133	22	30	52186	Ndërtimi i sallës në objektin e Komunës	17,000.00
3	Administrata - Vushtri	16324	0133	22	30	51817	Ndarja fizike e objektit në administratën Komunale	10,000.00
4	Infrastruktura Publike	18184	0451	22	30	51827	Ndërtimi i vigave mbi lumin Silnica, Tërstena dhe Stanoc	40,000.00
5	Infrastruktura Publike	18184	0451	22	30		Ndërtimi i rruges Vesekoc-Baçkë (me zhavorr)	25,000.00
6	Infrastruktura Publike	18184	0451	22	30	53347	Ndërtimi i shesheve dhe parqeve (mobileria urbane) në V	40,000.00
7	Infrastruktura Publike	18184	0451	22	30		Ndërtimi i trotuarit në rr. "Isak Halili" dhe "Lidhja e Lezh	34,000.00
8	Infrastruktura Publike	18184	0451	22	30		Ndërtimi i rrugës deri te Antena	36,000.00
9	Infrastruktura Publike	18184	0451	22	30	51822	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal rr. "Dëshmorë e Komb	19,821.00
10	Infrastruktura Publike	18184	0451	22	30	51828	Rikonstruktimi i rrugëve të asfaltuara "2 Maji", "Flamit Hy	20,000.00
11	Infrastruktura Publike	18184	0451	22	30	51831	Ndërtimi publik në Vushtri, Doberrlukë, Maxhunaj, Stan	584.00
12	Infrastruktura Publike	18184	0451	22	30	51821	Ndërtimi i trotuareve në Vushtri, Stanoc, Smrekonicë	1,070.00
13	Infrastruktura Publike	18184	0451	22	30		Ndërtimi i rr. Me kubeza betoni fsh Reznik (lagja Halili)	14,000.00
14	Infrastruktura Publike	18184	0451	22	30		Segment I rr. "Albania" Sfarraqak	9,000.00
15	Infrastruktura Publike	18184	0451	22	30	51851	Ndërtimi pllakave përkujtimore në Pasomë	20,000.00
16	Sherbimet kulturore	85024	0820	22	30	51007	RENOVIMI I PALESTRËS „JETON TERRSTENA"	29,901.00
17	Sherbimet kulturore	85024	0820	22	30	51847	Ndërtimi i objektit ndihmës në stadiumin „Ferki Aliu"	11,708.00
18	Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural	47024	0421	22	30	52290	Rregullimi dhe pastrimi i lumit Llap- Silnica	210,000.00
19	Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural	47024	0421	22	30	49561	PROJEKTET NË BASHKËFINANCIM ME DONATOR	165,076.00
20	Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30	53358	Ndërtimi i parkut të shkollës "Ali Kelmendi"	45,000.00
21	Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30	52188	Asfaltimi i rr. Vesekoc Sllakoc	80,000.00
22	Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30	51830	Rregullimi i shtratit të lumit "Silnica"	110,000.00
23	Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30	41424	Ndërtimi i rrugëve lokale në fsahtra	166,623.00
24	Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30		Ndërtimi i parkut në Stanoc	50,185.00
25	Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30	49588	Mbjellja e drunjëve dekorativ	10,000.00
26	Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30		Rregullimi i kabllave "Adem Jashari"	25,000.00
27	Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	30	50059	Automjet tereni për shëndetësi	8,500.00
28	Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	30	51845	Rregullimi i oborrit i QKMF-se Vushtri	5,000.00
29	Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	30	52190	Ndërtimi i zyrave administrative në QKMF	69,934.00
30	Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	30		Furnizimi dhe montimi i kaldase në QKMF	39,000.00
31	Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	30		LABORATORI NE LUMADH	3,042.00
32	Shërbimet Rezidenciale	75617	1060	22	30	53625	Blerja e veturës për Shërbimet rezidenciale	5,000.00
33	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51869	Meremetimi i SHFMU "Mihaliq"	550.00
34	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	53060	Renovimi i SHFMU "Adem Voca " Pasomë	1,550.00
35	Arsimi fillorë	93690	0912	22	30	53010	Rrethoja dhe muri mbrojtës SHFMU "Bajram Curri" Dum	5,900.00
36	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51870	Meremetimi i SHFMU "Rexhep Musa"	3,833.00
37	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51866	Meremetimi i SHMU "Enver Hadri"	950.00
38	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	53055	Renovimi i shf "Ali Kelmendi"	6,355.00
39	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51853	Ndërtimi i fushës sportive dhe rrethojës në SHFMU-Smr	10,270.00
40	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51862	Ndërtimi i rrethojës në Oshlan	1,564.00
41	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51854	Ndërtimi i toaleteve në SHMU "Emin Duraku"	44,319.56
42	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51863	Ndërtimi i rrethojës në Vilanc	1,346.00
43	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	49561	Meremetimi i SHMU-I	21,919.00
44	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	49561	Renovimi i shkolles "Hajrullah Shala" në Akrahtice	6,157.00
45	Arsimi i mesëm i lartë	94890	0922	22	30	51877	Renovimi i ngrohjes qendrore SHMP "Bahri Haxha"	19,000.00
46	Arsimi i mesëm i lartë	94890	0912	22	30	51874	Paisje për praktike profesionale SHMP "Bahri Haxha"	48,008.00
47	Arsimi i mesëm i lartë	94890	0912	22	30	51875	Kaldaja për ngrohje qendrore "Lutfi Musiqi" SHMU II	12,939.00
48	Arsimi i mesëm i lartë	94890	0912	22	30	48561	Ndërtimi i punetorisë dhe kabinetëve në SHMT "Lutfi Mu	16,992.00
							TOTAL KAPITALE	1,537,096.56

Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Abit Abli



Zyrtar Kryesor Financiar



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

<b>DATË/A:</b>	15.03.2023
<b>PËR/ZA/TO:</b>	KPF dhe Kuvendin e Komunës
<b>PËRMES</b>	Ferit Idrizit, Kryetar i Komunës 
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Isuf Jashari Drejtor për Buxhet dhe Financa 
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Bartja e të hyrave Vatanake nga Fondi(21) nga viti 2022 në vitin 2023 në shumë totale 1,585,616.94€

Të nderuar anëtarë të KPF-së dhe KK-së. Drejtorja për Buxhet dhe Financa ka përgatitur propozim vendimin dhe planin e bartjes e të hyrave vetanake të bartura nga viti 2022 në vitin 2023 duke u bazuar në Ligji Nr.08/L193 Nenit 9 Mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023.

Bartja e të hyrave vetanake të viti 2022 nga Fondi (21) në vitin 2023 në shumë totale 1,585,616.94€, në :

Kategoritë ekonomike:

Paga dhe mëditje.....	10,000.00€
Mallra&shërbime.....	619,076.38€
Shpenzime komunale.....	5000.00€
Subvencione dhe Transfere.....	55,100.00€
Investime kapitale.....	896,440.56€
<b>Totali.....</b>	<b>1,585,616.94€</b>



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Për: Kuvendin e Komunës

Propozues: Kryetari i Komunës z.Ferit Idrizi

Hartues: Zyrtari Kryesor Financiar, z.Abit Abiti

Çështja për trajtim: Propozim-vendim

Bazuar në nenin 6, pika 2 të Ligjit Nr. 08/l-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 19, paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe duke ju përgjigjur kërkesës së MAPL-së për rishqyrtimin e vendimit Nr.95/22, për trajtimin e kësaj çështjeje në Komitetin për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_ 2023, merr këtë:

#### VENDIM

#### PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE NGA VITI 2022 NË VITIN 2023

1. Me këtë vendim bëhet bartja e të hyrave vetanake nga Fondi (21) për vitin 2022 në vitin 2023 në kategoritë si në vijim:

1.1 Paga dhe Mëditje .....	10,000.00 €
1.2 Mallra dhe shërbime .....	619,076.38 €
1.3 Shpenzime komunale.....	5000.00 €
1.4 Subvencione dhe transfere.....	55,100.00 €
1.5 Investime kapitale.....	896,440.56 €

**Totali i mjeteve të bartura.....1,585,616.94 €**

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operacionale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

---

**Kryesuese e Kuvendit**

## Arsyetim

Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka përgatitur planin e bartjes e të hyrave vetanake nga Fondi (21) të bartura nga viti 2022 në vitin 2023, në kategoritë ekonomike të Pagave, Mallra&Shërbime, Shpenzime Komunale, Subvencione dhe transfere, si dhe Investime Kapitale, duke u bazuar në Ligjin Nr.08/L193 Nenet 9 Mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023.

Analitika e mjeteve për bartje është e specifikuar më lart sipas kategorive ekonomike, programe dhe projekte.



Abit Abiti

**Zyrtar Kryesor Financiar**

## Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023

### Komuna e Vushtrrisë


Nën/Programi	Kodi i nën-programit	Kodi Funkcional	Fondi Burimor	Kategoria ekonomike	Nën kategorit ekonomike (zërat)	Kategoria	SHUMA PËR BARTJE
Zyra e Kuvendit Komunal	16924	0111	22	11		Paga dhe meditje	10,000.00
<b>Paga dhe meditje</b>							<b>10,000.00</b>
Zyra e kryetarit	16024	0111	22	13		Mallra dhe shërbime	30,000.00
Administrata -Vushtrri	16324	0133	22	13		Mallra dhe shërbime	10,000.00
Inspeksioni	16647	0411	22	13		Mallra dhe shërbime	3,000.00
Zyra e Kuvendit Komunal	16924	0111	22	13		Mallra dhe shërbime	1,000.00
Buxhetimi	17524	0112	22	13		Mallra dhe shërbime	2,000.00
Infrastruktura publike	18184	0451	22	13		Mallra dhe shërbime	150,000.00
Menaxhimi i fatkeqsive natyrore	18468	0320	22	13		Mallra dhe shërbime	50,000.00
Planifikimi Urban Inspeksioni-Vushtrri	66425	0620	22	13		Mallra dhe shërbime	75,000.00
Administrata shëndetësi	73033	0760	22	13		Mallra dhe shërbime	1,300.00
Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	13		Mallra dhe shërbime	40,000.00
Shërbimet sociale	75616	1040	22	13		Mallra dhe shërbime	950.38
Shërbimet Kulturore	85024	0820	22	13		Mallra dhe shërbime	6,000.00
Administrat-Arsimi	92120	0980	22	13		Mallra dhe shërbime	208,915.00
Arsimi parafillor - Qerdhja	92670	0911	22	13		Mallra dhe shërbime	34,329.00
Arsimi I Mesëm	94890	0922	22	13		Mallra dhe shërbime	6,582.00
<b>Mallra dhe shërbime</b>							<b>619,076.38</b>
Infrastruktura publike	18184	0451	22	14		Shpenzimet komunale	5,000.00
Administrata	92120	0980	22	14		Shpenzimet komunale	
<b>Shpenzime komunale</b>							<b>5,000.00</b>
Zyra e kryetarit	16024	0111	22	20		Subvencione dhe transferet	40,000.00
Infrastruktura publike	18184	0451	22	20		Subvencione dhe transferet	
Bujqësia	47024	0421	22	20		Subvencione dhe transferet	
Administrata	73033	0760	22	20		Subvencione dhe transferet	10,000.00
Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	20		Subvencione dhe transferet	100.00
Administrata	92120	0980	22	20		Subvencione dhe transferet	5,000.00
Shërbimet kulturore	85024	0820	22	20		Subvencione dhe transferet	
<b>Subvencione</b>							<b>55,100.00</b>
<b>Kapitale</b>							<b>896,440.56</b>
<b>TOTALI</b>							<b>1,585,616.94</b>

Ferit Idrizi



Kryetar I Komunës

Abit Abiti




Zyrtar Kryesor Financiar

**Bartja e mjeteve të pasqyruara nga viti 2022 në vitin 2023**

Komuna: Komuna e Vushtrrisë									
Programi	Kodi i nën-programit	Kodi funksional	Fondi Burimor	Kategoria ekonomike	Kodi i projektit	Projektit	BARTJA 2023		
1 Administrata - Vushtri	16324	0133	22	30	51814	Ngritja qendrore për administratën Komunale	15,000.00		
3 Infrastruktura Publike	18184	0451	22	30	51822	Sinjjalizimi horizontal dhe vertikal rr. "Dëshmorë e Kombit"	19,821.00		
4 Infrastruktura Publike	18184	0451	22	30	51828	Rikonstruktimi i rrugëve të asfaltuara "2 Maji", "Hamit Hyseni"	20,000.00		
5 Infrastruktura Publike	18184	0451	22	30	51831	Ndriçimi publik në Vushtri, Doberrlukë, Maxhunaj, Stanoc	584.00		
6 Infrastruktura Publike	18184	0451	22	30	51821	Ndërtimi i trotuarëve në Vushtri, Stanoc, Smekonicë	1,070.00		
Infrastruktura Publike	18184	0451	22	30	51821	Rregullimi i kablove "Adem Jashari"	25,000.00		
11 Sherbimet kulturore	85024	0820	22	30	51007	Ndërtimi pllakave përkujtimore në Pasomë	20,000.00		
12 Sherbimet kulturore	85024	0820	22	30	51007	RENOVIMI I PALESTRËS „JETON TERRSTENA"	29,901.00		
13 Sherbimet kulturore	85024	0820	22	30	51847	Ndërtimi i objektit ndihmës në stadiumin „Ferki Aliu"	20,000.00		
14 Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural	47024	0421	22	30	49561	PROJEKTI NE BASHKEFINANCIM ME DONATORE	100,000.00		
Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural	47024	0421	22		52290	Rregullimi dhe pastrimi i lumit Llap- Silnica	60,000.00		
16 Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30	53584	Asfaltimi i rr. Vesekec Sllakoc	80,000.00		
17 Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30		ANEKSI I LUMIT SILNICA	110,000.00		
20 Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30	41424	NDERT RRUG LOKALE NE FSHATRA	166,623.00		
21 Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30		Ndërtimi i parkut në Stanoc	50,185.00		
22 Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30		Drunj dekorativ	3,000.00		
26 Sherbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	30	50059	AUTOMJETI TERENIT PER SHENDETESI	8,500.00		
28 Sherbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	30	52190	NDERTIMI I ZYRAVE ADMINISTRATIVE NE OKMF	4,934.00		
30 Sherbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	30		LABORATORI NE LUMADH	3,042.00		
33 Sherbimet Rezidenciale	75617	1060	22	30	53625	Blerja e veturës për Shërbimet rezidenciale	5,000.00		
36 Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51869	Meremetimi i SHFMU "Mihalik"	550.00		
39 Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	53060	Renovimi i SHFMU "Adem Voca " Pasomë	1,550.00		
40 Arsimi i mesëm i lartë	94890	0922	22	30	51874	Paisje për praktike profesionale SHMP "Bahri Haxha"	48,008.00		
41 Arsimi i mesëm i lartë	94890	0922	22	30	51875	Kaldaja për ngrohje qendrore "Lutfi Musiqi" SHMU II	12,939.00		
43 Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51854	Ndërtimi i toaleteve në SHMU "Emin Duraku"	44,319.58		
44 Arsimi fillor, i mesëm i ulët	94890	0922	22	30	46561	Ndërtimi i punetorisë dhe kabinetëve në SHMT "Lutfi Musiqi"	16,992.00		
47 Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51863	Ndërtimi i rethojës në Vilanc	1,346.00		
48 Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	49561	Meremetimi i SHMU-I	21,919.00		
49 Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	49561	Renovimi i shkolles "Hajrullah Shala" në Akrashitice	6,157.00		
<b>TOTAL KAPITALE</b>							<b>896,440.58</b>		

Ferit Idrizi



Kryetar i Komunës

Abit Abiti





Zyrtar Kryesor Financiar





REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA VUSHTRRI

<b>DATË/A:</b>	15.03.2023
<b>PËR/ZA/TO:</b>	KPF dhe Kuvendin e Komunës
<b>PËRMES</b>	Ferit Idrizit, Kryetar i Komunës 
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Isuf Jashari Drejtor për Buxhet dhe Financa 
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Shpërndarja e të Hyrave Vetanake të tejkaluara për Buxhetin e Vitit 2022

Bazuar në Ligjin Nr.08/006 mbi ndarjen Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës të vitit 2022. Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka përgatitur Shpërndarja e të Hyrave Vetanake të tejkaluara për Buxhetin e Vitit 2022 në kategoritë ekonomike të cekur si më poshtë:

1.1 Paga dhe mëditje.....	10,000.00€
1.2 Mallra&shërbime.....	499,095.51 €
1.3 Shpenzime komunale.....	3,511.39 €
1.4 Subvencione dhe Transfere.....	67,199.58.€
1.5 Investime kapitale.....	136,613.46€
Totali.....	716,419.94€



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Për: Kuvendin e Komunës

Propozues: Kryetari i Komunës z.Ferit Idrizi

Hartues: Zyrtari Kryesor Financiar, z.Abit Abiti

Çështja për trajtim: Propozim-vendim

Bazuar në nenin 6, pika 2 të Ligjit Nr. 08/1-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 19, paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe duke ju përgjigjur kërkesës së MAPL-së për rishqyrtimin e vendimit Nr.95/22, për trajtimin e kësaj çështjeje në Komitetin për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_2023, merr këtë:

#### VENDIM

#### PËR SHPËRNDARJEN E TË HYRAVE VETANAKE TË TEJKALUARA PËR BUXHETIN E VITIT 2022

1. Me këtë vendim bëhet shpërndarja e tejkalimit të planit të të hyrave vetanake për vitin 2022 në kategoritë ekonomike si në vijim:

1.1 Paga dhe Mëditje .....	10,000.00 €
1.2 Mallra dhe shërbime .....	499,095.51 €
1.3 Shpenzime komunale.....	3,511.39 €
1.4 Subvencione dhe transfere.....	67,199.58 €
1.5 Investime kapitale.....	136,613.46 €

**Totali i mjeteve të bartura.....716,419.94 €**

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operationale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

---

**Kryesuese e Kuvendit**

## Arsyetim

Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka përgatitur shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për viti 2022, bazuar në planin e shpërndarjes së të hyrave të tejkaluara, shpërndarja bëhet në kategoritë ekonomike të Pagave, Mallra&Shërbime, Shpenzime Komunale, Subvencione dhe transfere, si dhe Investime Kapitale, duke u bazuar në Ligjin Nr.08/006 Mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022.

Analitika e mjeteve për bartje është e specifikuar më lart sipas kategorive ekonomike, programe dhe projekte.

  
Abit Abiti  
Zyrtar Kryesor Financiar

## Bartja e mjeteve të tejkaluara gjatë vitit 2021

### Komuna e Vushtrisë

Nën/Programi	Kodi i nën-programit	Kodi FunkSIONAL	Fondi Burimor	Kategoria ekonomike	Nën-kategoria (zërat)	Kategoria	BARTJA 2022
Zyra e Kuvendit Komunal	16924	0111	22	11		Paga dhe medije	10,000.00
<b>10,000.00</b>							
Zyra e kryetarit	16024	0111	22	13		Mallra dhe shërbime	39,500.00
Planifikimi urban Inspeksioni	66425	0620	22	13		Mallra dhe shërbime	55,515.51
Infrastruktura publike	18184	0451	22	13		Mallra dhe shërbime	120,000.00
Menaxhimi i fatkeqësive natyrore	18468	0320	22	13		Mallra dhe shërbime	74,080.00
Administrat-Arsimi	92120	0980	22	13		Mallra dhe shërbime	190,000.00
<b>Mallra dhe shërbime</b>							<b>499,095.51</b>
Infrastruktura publike	18184	0451	22	14		Shpenzimet komunale	3,511.39
<b>Shpenzime komunale</b>							<b>3,511.39</b>
Zyra e kryetarit	16024	0111	22	20		Subvencione dhe transferet	50,000.00
Administrata	73033	0760	22	20		Subvencione dhe transferet	9,000.00
Shërbimet kulturore	85024	0820	22	20		Subvencione dhe transferet	8,199.58
<b>Subvencione</b>							<b>67,199.58</b>
Infrastruktura publike	18184	0451	22	30		Rregullimi dhe pastrimi i lumit Lap- Silnica	136,613.46
<b>Kapitale</b>							<b>136,613.46</b>
<b>TOTALI</b>							<b>716,419.94</b>

Ferit Idrizi



Kryetar i Komunës

Abit Abiti



Zyrtar Kryesor Financiar

Tabela për bartjen e THV nëpër kategori ekonomike sipas SIMFK - nga viti 2022 në 2023

SHUMA E CILA DUHET TE SHPERNDARHET NE KATEGORI

VUSHTRRI	Buxheti 22 (Plani 2022)	Tejkalimi i planit	Shpenzimi 21	Bartje 21	Ministria e Financave	Vendimi I KK	Diferenca
RROGAT DHE PAGAT	30,000.00	10,000.00	30,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	-
MALLRA DHE SHËRBIME	1,063,940.00	499,095.51	908,959.13	654,076.38	654,076.38	654,076.38	-
SHPENZIMET KOMUNALE	50,000.00	3,511.39	48,511.39	5,000.00	5,000.00	5,000.00	-
SUBVENCIONET	108,712.00	67,199.58	100,811.58	75,100.00	75,100.00	75,100.00	-
KAPITALE	1,009,143.00	136,613.46	304,315.90	841,440.56	841,440.56	841,440.56	-
	2,261,795.00	716,419.94	1,392,598.00	1,585,616.94	1,585,616.94	1,585,616.94	0.00

Pasqyra financiare 2,261,795.00 716,419.94 1,392,598.00 1,585,616.94 1,585,616.94

Ferit Idrizi



Kryetar I Komunës

Abdi Abiti



Zyrtar Kryesor Financiar



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRIË

DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

<b>DATE /A:</b>	08.03.2023
<b>REFERENCË :</b>	05Nr.47/23
<b>PËR:</b>	KPF dhe KK të Komunës
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES:</b>	
<b>NGA:</b>	Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera z.Agim Miftari, Sekretar dhe kryesues i komisionit <i>Agim Miftari</i>
<b>TEMA:</b>	<b>Raport i vlerësimit të dëmeve nga FNFT</b>

Në bazë të nenit 12.2, pika "d", të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 19, pika 1.4. si dhe nenet 4, pika 1,2,3 dhe neni 12, pika 1.5, bazuar në Rregullore (Qrk) Nr. 17/2015, për Metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera ka përgatitur raportin përmbledhës për dëmet e vlerësuara në territorin e komunës, Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajtur më, \_\_\_\_\_ miraton këtë:

**RAPORT I VLERËSIMIT TË DËMEVE NGA FATKEQËIT NATYRORE DHE  
FATKEQËSIT E TJERA NË TERRITORIN E KOMUNËS SË VUSHTRRIË  
NËNTOR- DHJETOR 2022 DHE JANAR- SHKURT –MARS 2023**

**Vërshimet në nëntor dhe dhjetor 2022**

Më datat 20, 21,22 dhe 30 nëntor 2022, territori i Vushtrrisë është përfshi nga një mot i ligë me reshje shiu të shoqëruar me erëra të forta, ku si pasojë kemi pas vërshime të cilat kanë shkaktuar dëme në ekonomi familjare dhe në ara të mbjella me kultura bujqësore.

### **Vërshimet në janar dhe mars 2023**

Më datat 17 dhe 18 janar 2023 dhe me data 10 dhe 11 mars 2023, territori i Vushtrrisë prapë është përfshi nga një mot i ligë me reshje shiu, ku si pasojë kemi pas prapë vërshime në ara të mbjella me kultura bujqësore dhe në ekonomi familjare.

### **Erë e fortë 4 shkurt 2023**

Më datën 4 shkurt 2023, qyteti i Vushtrrisë dhe fshatrat për rreth saj, është përfshi nga një furtunë, ku si pasojë kemi dëmtimin e një kulmi të shtëpisë dhe dëmtimin e një sere.

### **Zjarr në shtëpi dhe në sere**

Më 6 shkurt 2023, një shtëpi në qytet është përfshi nga zjarri i cili ka shkaktuar dëme të konsiderueshme në mobile, teknik të bardhë, dyer, dritare dhe veshmbathje. Po ashtu më datën 27 shkurt 2023, si pasojë e zjarrit është djegur një pjesë e një sere, ku është djegur një pjesë e folisë me dhe 6 leh të mbjella me dredhëz si dhe sistemi pikë-pikë për dredhëza.

Lidhur me dëmet e shkaktuar nga fatkeqësitë e lartpërmendura, qytetarët e dëmtuar kanë shtruar kërkesa për vlerësimin e dëmeve.

- Gjithsej janë bërë- 78(shtatëdhjetë e tetë) kërkesa,
- Janë vlerësuar -61(gjashtëdhjetë e një) kërkesa
- Janë refuzuar -17(shtatëmbëdhjetë) kërkesa të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret.

Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, ka dalë në vendngjarje dhe ka bërë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë.

***Këtij Raporti i bashkëngjisim edhe një pasqyrë tabelare të kërkesave dhe vlerësimit të dëmeve nga ana e komisionit.***



**Tabela 1: Lista e vlerësimit të dëmeve në bujqësi të shkaktuara nga të reshurat atmosferike në muajt Nëntor dhe Dhjetor 2022**

